

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • PRILL 2013

# Liahona

**Jezu Krishti: Shëlbues  
dhe Shembull, f. 18, 26**

**Miqtë Janë Njerëz që . . . , f. 52**

**A Je Kthyer në Besim?  
10 Mënyra për ta Ditur, f. 56**

**Bisedimi me Fëmijët Tuaj  
për Tempujt, f. 62, 64**



*“Drita e Krishtit  
është ajo fuqi  
ose ndikim  
hyjnor që vjen  
nga Perëndia  
nëpërmjet  
Jezu Krishtit.  
Ajo u jep dritë  
dhe jetë të  
gjitha gjërave.”*

Plaku Riçard G. Skot, i  
Kuoromit të Dymbëdhjetë  
Apostujve, “Peace of  
Conscience and Peace  
of Mind”, *Liahona*,  
nëntor 2004, f. 15.



## MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Ai Është Ngritur**  
Nga Presidenti Henri B. Ajring
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Besëlidhjet e Tempullit**

## ARTIKUJT KRYESORË

- 12 Vdekja dhe Jeta: Pikëpamje Pionierësh për Ringjalljen**  
*Pionierë dhe profetë të hershëm dëshmojnë për gjetjen e shpresës te ringjallja.*

## 18 Misioni dhe Shërbesa e Jezu Krishtit

Nga Plaku Rasëll M. Nelson  
*Ne mund t'i imitojmë pesë aspekte të jetës së Shpëtimtarit ndërsa përpiqemi fort ta ndjekim Atë dhe të kuptojmë Shlyerjen e Tij.*

## 26 Java e Pashkës

*Në javën e fundit të jetës së Tij, Shpëtimtari kreu mrekullinë më të madhe prej të gjithave.*

## 30 Të Ndhimuarit e Fëmijëve për t'u Përgatitur për Pagëzim

Nga Xhesika Larsen dhe Marisa Uidison  
*Çfarë mund të bëjnë prindërit që ta bëjnë më kuptimplotë pagëzimin e fëmijës së tyre?*

## 34 Të Tërhequr drejt Tempullit


Nga Plaku Zhairo Mazagardi  
*Mësoni se si tempulli mund të ndihmojë që të ndodhë kthimi në besim.*

## SEKSIONET

- 8 Bllok Shënimesh për Konferencën e Prillit: Studimi së Bashku i Bisedave të Konferencës**  
Nga Greg Beti
- 9 Mësimdhënie nga Për Forcën e Rinisë: Rëndësia e Miqve të Mirë**
- 10 Çfarë Besojmë Ne: Fryma e Shenjtë Ngushëllon, Frymëzon dhe Dëshmon**
- 36 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 74 Lajme të Kishës**
- 80 Kur Prapë të Takohemi: Pirja nga Burimi**  
Nga Aaron L. Uest

### NË KOPERTINË

Përpara: Fotoilustrim nga Tim Taggart © IRI.  
Prapa: Fotoilustrim nga Matthew Reier. Brenda kapakut të përparmë: Fotografi nga Kristine Šumska.



40

#### 40 Zgjedhja e Pjesës më të Mirë

Nga Methju D. Fliton

*Për të qenë plotësisht i zotuar ndaj ungjillit të Jezu Krishtit, Zoltanit iu desh të hiqte dorë nga disa gjëra të mira.*

52



#### 42 Pyetje e Përgjigje

*Si t'ia shpjegoj mikut tim se të thyesh ligjin e dëlirësisë është një ide e gabuar?*

#### 44 Si të Shërbeni në Thirrjet e Priftërisë

Nga Presidenti Tomas S. Monson  
*Mësoni çelësin për të ndikuar, mësuar dhe prekur jetën e atyre të cilëve u shërbeni.*

#### 45 Hapësira Jonë

#### 46 Përse na Nevojitet Libri i Mormonit

*Katër arsye pse Libri i Mormonit është thelbësor.*

#### 48 Rritje në Tokë Pjellore: Të Rinjtë Besnikë në Ugandë

Nga Sindi Smith

*Këta të rinj dhe të reja janë forcuar nga sakrificat që bëjnë për ungjillin.*

#### 52 Për Forcën e Rinisë: Çfarë Është një Mik i Vërtetë?

Nga Elen S. Dalton

#### 54 Nga e Di: Ftesa Ime drejt Shpëtimit

Nga Emerson Hoze de Silva

*Kur së fundi pranova ftesën e mikut tim, e dija se kisha gjetur diçka të rëndësishme.*

#### 56 Dhjetë Mënyra për ta Ditur se Jeni Kthyer në Besim

Nga Tajlër Orton

*Ajo çfarë mësova mbi kthimin në besim, më ndihmon të gjurmoj përparimin tim në ungjill.*

#### 59 Afishe: Ia Vlen të Punosh Fort



61

#### 60 Misionari i Vogël i Gjyshe Denit

Nga Emilia Maria Guimaraes Korrea  
*Dashuria e Vitorit për ungjillin ndezi shkëndijat e kthimit në besim të gjyshes së tij.*

#### 61 Dëshmitar i Veçantë: Pse Kisha Ka një Emër kaq të Gjatë?

Nga Plaku M. Rasëll Ballard

#### 62 Festimi për Tempujt!

Nga Darsi Jensen

*Në mbarë botën, fëmijët festojnë kur kanë një tempull pranë tyre.*

#### 64 Pyetje dhe Përgjigje për Tempullin

*Përgjigje për pyetje të tilla si: Përse i kemi tempujt? Çfarë ndodh brenda tyre?*

#### 65 Muzika: Familjet Mund të Jen' Bashk' Përgjithmon'

Nga Ruth Muir Gardner dhe Vanja Y. Watkins

#### 66 Sjellja e Fillores në Shtëpi: Jezu Krishti e Rivendosi Kishën e Tij në Ditët e Mëvonshme

#### 68 Pas Gjurmëve: Ku u Organizua Kisha

Nga Jan Pinboru

#### 70 Për Fëmijët e Vegjël

#### 81 Portret Profeti: Uillford Udraf



*Shihni nëse mund të gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Përdorni vështrimin tuaj prej superheroi.*

# Ide për Mbrëmje Familjare

*Ky botim përmban artikuj dhe aktivitete që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Në vijim janë disa shembuj.*



FOTILISTRIMINGA CODY BEL © IRI

**"Misioni dhe Shërbesa e Jezu Krishtit",** faqe 18: Plaku Rasëll M. Nelson ndan pesë aspekte të jetës së Jezu Krishtit që ne mund t'i imitojmë. Merrni parasysht të diskutoni për këto aspekte dhe për mënyrën se si t'i zbatoni në jetën tuaj. Ju mund të dëshironi të lexoni një tregim nga shkrimi i shenjtë nga jeta e Shpëtimtarit ose të shihni një video nga Bibla ([biblevideos.lds.org](http://biblevideos.lds.org)) që paraqet një prej këtyre aspekteve. Ju mund të përfundoni duke dhënë dëshmi për jetën e shërbesën e Tij dhe duke kënduar "More Holiness Give Me" ["Më Shumë Shenjtëri më Jep"] (*Hymns*, nr. 131).

**"Çfarë Është një Mik i Vërtetë?"** faqe 52: Ju mund të dëshironi të filloni duke pyetur: Çfarë është një mik i vërtetë? Lexoni

përkufizimin e Plakut Robert D. Hejls dhe diskutoni se çfarë lloj miku duhet të jemi. Merrni parasysht të tregoni një përvojë të një rasti kur dikush veproi si një mik i vërtetë kundrejt jush dhe flisni për tiparet që mund t'i ndihmojnë pjesëtarët e familjes që të jenë miq më të mirë ndaj të tjerëve.

**"Festimi për Tempujt!"** faqe 62: Bashkë me familjen, shihni fotografitë me mënyrat e ndryshme se si fëmijët kanë festuar për tempullin. Merrni parasysht të paraqitni fotografinë e tempullit më të afërt dhe të bisedoni rreth arsyes përse tempujt janë të rëndësishëm. Thëksoni se vetëm në tempull mund të vulosen familjet. Ju mund të dëshironi të përfundoni duke kënduar "Familjet Mund të Jenë Bashkë Përgjithmonë" (faqe 65).

## NË GJUHËN TUAJ

*Liahona* dhe materiale të tjera të Kishës janë të disponueshme në shumë gjuhë në [languages.lds.org](http://languages.lds.org).

## TEMAT NË KËTË BOTIM

*Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.*

**Besëlidhjet,** 7

**Besimi,** 48

**Bindja,** 40, 42, 56

**Dëlirësia,** 42

**Familja,** 30, 65

**Fryma e Shenjtë,** 10, 36

**Frymëzimi,** 36, 38

**Gëzimi,** 37

**Jezu Krishti,** 4, 18, 26

**Këmbëngulja,** 59

**Konferenca e përgjithshme,** 8, 37

**Kthimi në besim,** 34, 54, 56, 60

**Libri i Mormonit,** 46

**Lutja,** 18, 45

**Mësimdhënia,** 8, 9, 30

**Miqësia,** 9, 52, 54

**Ordinancat,** 18

**Organizimi i Kishës,** 61

**Pagëzimi,** 30

**Përparësitë,** 40

**Priftëria,** 44

**Puna misionare,** 34, 39, 48, 52, 54, 60

**Puna në tempull,** 7, 64, 38, 65, 80

**Ringjallja,** 4, 12, 26

**Rivendosja,** 66

**Sakramenti,** 18

**Sakrifica,** 40

**Shembulli,** 48

**Shërbimi,** 44, 70

**Shlyerja,** 18, 26, 45

**Shpresa,** 12

**Smith, Jozef,** 66

**Standardet,** 42, 45

**Tempujt,** 34, 62

**Udrat, Uillford,** 81

**Vdekja,** 4, 12, 39

**Zbulesa,** 10, 46



**Nga Presidenti  
Henri B. Ajring**

Këshilltar i Parë në  
Presidencën e Parë

# Ai Është Ngritur

**N**jë dëshmi e realitetit të Ringjalljes së Jezu Krishtit është një burim si shprese ashtu edhe vendosmërie. Dhe mund të jetë e tillë për çdo fëmijë të Perëndisë. Ishte për mua, në një ditë vere në qershor 1969 kur më vdiq nëna; ka qenë të gjithë vitet që atëherë dhe do të jetë derisa ta shoh atë përsëri.

Trishtimi prej ndarjes së përkohshme u zëvendësua menjëherë me lumturi. Ishte më shumë se shpresë për një ribashkim të lumtur. Sepse Zoti ka zbuluar kaq shumë nëpërmjet profetëve të Tij dhe sepse Fryma e Shenjtë më ka pohuar të vërtetën e Ringjalljes, unë mund ta shoh në mendjen time se si do të jetë ribashkimi me njerëzit tanë të dashur, të shenjtëruar dhe të ringjallur:

“Këta janë ata që do të dalin në ringjalljen e të drejtëve. . . .

. . . Këta janë ata, emrat e të cilëve shkruhen në qiell, ku Perëndia dhe Krishti janë gjykatësi i të gjithëve.

Këta janë ata që janë njerëz të drejtë, të bërë të përsosur nëpërmjet Jezusit, ndër-mjetësit të besëlidhjes së re, i cili e kreu këtë shlyerje të përsosur nëpërmjet derdhjes së vetë gjakut të tij” (DeB 76:65, 68–69).

Sepse Jezu Krishti i theu prangat e vdekjes, të gjithë fëmijët e Atit Qiellor, të lindur në botë, do të ringjallen në një trup që nuk do të vdesë kurrë. Kështu dëshmia ime dhe e juaja për atë të vërtetë të lavdishme, mund të largojë dhembjen e humbjes së një anëtarit të dashur të familjes ose të një mikut dhe e zëvendëson atë me parashikimin e hareshëm dhe vendosmërinë e patundur.

Zoti na ka dhënë të gjithëve dhuratën e ringjalljes, nëpërmjet së cilës shpirtrat tanë vendosen në trupa që nuk kanë papërsosmëri fizike (shih Alma 11:42–44). Nëna ime

do të shfaqet e re dhe rrezatuese, pasojat e moshës dhe të viteve të vuajtjes fizike të hequra. Ajo do t'i vijë asaj dhe do të na vijë ne si dhuratë.

Por ata prej nesh, që dëshirojmë shumë të jemi me të përgjithmonë, duhet të bëjmë zgjedhje që të cilësohemi për atë shoqërim, për të jetuar atje ku Ati dhe Biri i Tij i Dashur, i ringjallur banojnë në lavdi. Atje është i vetmi vend ku jeta familjare mund të vazhdojë përjetësisht. Një dëshmi e asaj të vërtetë e ka rritur vendosmërinë time për ta cilësuar veten time dhe ata që i dua, për shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale, nëpërmjet veprimit të Shlyerjes së Jezu Krishtit në jetën tonë (shih DeB 76:70).

Në këtë kërkim për jetën e përjetshme, Zoti na ofron një udhëzues në lutjet e sakramentit, që më ndihmon mua dhe mund t'ju ndihmojë juve. Ne ftohemi t'i ripërtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit në çdo mbledhje sakramenti.

Ne premtojmë ta kujtojmë gjithmonë Shpëtimtarin. Emblemat e flijimit të Tij na ndihmojnë të çmojmë madhësinë e çmimit që Ai pagoi për të thyer lidhjet e vdekjes, për të na ofruar mëshirë dhe për të na siguruar falje për të gjitha mëkatet tona, në qoftë se zgjedhim të pendohejmë.

Ne premtojmë të mbajmë urdhërimet e Tij. Leximi i shkrimeve të shenjta dhe i fjalëve të profetëve të gjallë, dhe dëgjimi i folësve të frymëzuar në mbledhjet tona të sakramentit, na sjellin ndër mend besëlidhjet tona për të bërë kështu. Fryma e Shenjtë na sjell në mendjet dhe zemrat tona urdhërimet që duhet të mbajmë më shumë atë ditë.

Në lutjet e sakramentit, Perëndia premtonte të dërgojë Frymën e Shenjtë që të jetë me ne (shih Moroni 4:3; 5:2; DeB 20:77, 79). Kam gjetur në atë çast se Perëndia mund të më japë atë që e ndiej si një intervistë vetjake. Ai më





## MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

**N**e duhet t'i "përshta[sim] të gjitha shkrimet e shenjta për ne, që ato të mund të jenë për përfitimin dhe mësimin tonë" (1 Nefi 19:23). Merrni parasysh leximin e lutjeve të sakramentit, që gjenden në Doktrina e Besëlidhje 20:76–79. Pas leximit të mësimave të Presidentit Ajring rreth lutjeve të sakramentit, ju mund të dëshironi t'i ftoni ata, të cilëve po u jepni mësim, të mendojnë për mënyra se si këto lutje mund ta orientojnë jetën e tyre dhe mund t'i ndihmojnë të kthehen për të jetuar përsëri me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin.

sjell në vëmendjen time çfarë kam bërë që e kënaqin Atë, nevojën time për pendim e falje dhe emrat e fytyrat e njerëzve që Ai dëshiron t'u shërbej për Të.

Me kalimin e viteve, ajo përvojë e përsëritur e ka kthyer shpresën në ndjenja të

dashurisë hyjnore dhe ka sjellë një siguri që mëshira u çlirua për mua nëpërmjet Shlyerjes dhe Ringjalljes së Shpëtimtarit.

Unë dëshmoj se Jezusi është Krishti i ringjallur, Shpëtimtari ynë, shembulli dhe udhërrëfyesi ynë i përsosur për te jeta e përjetshme. ■

## Intervista Juaj Vetjake me Perëndinë

**P**residenti Ajring na mëson se kur dëgjojmë lutjet e sakramentit, ne mund të ndiejmë se kemi një intervistë vetjake me Perëndinë. Presidenti Ajring mendon për këto tri fusha që pasojnë. Merrni parasysh t'i shkruani këto pyetje në ditarin tuaj dhe t'i mendoni thellë ato çdo të diel këtë muaj. Ndërsa

mendonit thellë dhe merrni mbresa nga Fryma e Shenjtë, ju gjithashtu mund të shkruani rreth tyre në ditarin tuaj.


- Çfarë kam bërë që e ka kënaqur Perëndinë?
- Për çfarë kam nevojë të pendohem ose të kërkoj falje?
- Cilëve do Perëndia që unë t'u shërbej?

## FËMIJËT

### Kujtojeni Gjithmonë Jezusin

**J**akobi po përpiqet ta "kujtojë gjithmonë" Shpëtimtarin (DeB 20:77). Shih përreth dhomës së tij

të gjumit. Çfarë vini re që mund ta ndihmojë atë ta kujtojë gjithmonë Jezusin?





Studiojeni këtë material plot lutje dhe, si të jetë e përshtatshme, diskutojeni atë me motrat që vizitoni. Përdorini pyetjet për t'ju ndihmuar të forconi motrat tuaja dhe për ta bërë Shoqatën e Ndihmës një pjesë aktive të vetë jetës suaj. Për më tepër informacion, shih te [reliefsociety.lds.org](http://reliefsociety.lds.org).

## Besëlidhjet e Tempullit

“Ordinancat shpëtuese të marra në tempull, që na lejojnë të kthehemi një ditë tek Ati ynë Qiellor në një marrëdhënie familjare të përgjeshme dhe të marrim bekime e fuqi që nga lart, ia vlejnjë çdo sakrificë dhe çdo përpjekje”<sup>1</sup>, tha Presidenti Tomas S. Monson. Nëse nuk keni qenë ende në tempull, ju mund të përgatiteni për të marrë ordinancat e shenjtë të tempullit:

- Duke besuar në Atin Qiellor, Jezu Krishtin dhe Frymën e Shenjtë.
- Duke kultivuar një dëshmi për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe për ungjillin e rivendosur.
- Duke mbështetur dhe ndjekur profetin e gjallë.
- Duke u cilësuar për një rekomandim tempulli nëpërmjet pagimit të së dhjetës, të qenit të pastër moralisht, të qenit të ndershëm, mbajtjes së Fjalës së Urtësisë dhe të jetuarit në harmoni me mësimet e Kishës.
- Duke dhënë kohë, talente dhe mjete për të ndihmuar në ngritjen e mbretërisë së Zotit.
- Duke marrë pjesë në punën për historinë familjare.<sup>2</sup>



Presidenti Monson më tej na mësoi: “Ndërsa i kujtojmë besëlidhjet që bëjmë brenda [tempullit], ne do të jemi më të aftë për të duruar çdo provë dhe për të kapërcyer çdo tundim”<sup>3</sup>.

### Nga Shkrimet e Shenjta

Doktrina e Besëlidhje 14:7; 25:13; 109:22

#### SHËNIME

1. Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 92.
2. Shih *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 21.
3. Tomas S. Monson, *Liahona*, maj 2011, f. 93.
4. *Daughters in My Kingdom*, f. 29–30.
5. Sarah Rich, në *Daughters in My Kingdom*, f. 30.



## Besim, Familje, Ndihmë

### Nga Historia Jonë

“Më shumë se 5.000 shenjtorë u dyndën në tempullin e Nauvusë pas përkushtimit të tij. . . .

Forca, fuqia dhe bekimet e besëlidhjeve të tempullit [i mbështetën] shenjtorët e ditëve të mëvonshme gjatë udhëtimit të tyre [drejt perëndimit], kur ata [vuajtën] nga të ftohtit, të nxehtit, uria, varfëria, sëmundja, aksidentet dhe vdekja.”<sup>4</sup>

Si shumë motra të Shoqatës së Ndihmës, Sara Riç shërbeu si një punonjëse tempulli. Ajo foli rreth përvojës së saj: “Po të mos kishte qenë për besimin dhe dijen që na u dhuruan në atë tempull nga . . . Shpirti i Zotit, udhëtimi ynë do të kishte qenë sikur të kishim hedhur një hap në errësirë. . . . Por ne kishim besim në Atin tonë Qiellor, . . . duke e ndier se ishim populli i Tij i zgjedhur . . . dhe në vend të hidhërimit, ne ndiem gëzimin se dita e çlirimit tonë kishte ardhur.”<sup>5</sup>

Eksodi nuk ishte një “hap në errësirë” për gratë besnike shenjtorë të ditëve të mëvonshme. Ato u mbështetën nga besëlidhjet e tyre të tempullit.

### Çfarë Mund të Bëj Unë?

1. A po adhuroj në tempull rregullisht?
2. A po i nxit motrat e mia që të marrin bekimet e tempullit?

# STUDIMI I BISEDAVE TË KONFERENCËS SË BASHKU

*Ndryshimi i mënyrës se si e rishikonim konferencën i rriti shumë diskutimet tona për ungjillin si familje.*

**Nga Greg Beti**

Për vite, ne gëzoheshim me leximin e revistës së konferencës si familje, duke i lexuar artikujt një e nga një. Kur filluam, ne thjesht mblidheshim përreth tavolinës dhe secili lexonte me radhë nga një paragraf me zë të lartë. Por vumë re se po e lexonim atë që ta mbaronim, pa ndaluar për ta përvetësuar mesazhin.

Për të marrë më shumë nga ajo që po lexonim, gruaja ime dhe unë blemë një kopje të revistës së konferencës për çdo anëtar të familjes dhe planifikuam se sa biseda duhej të studionim çdo javë, me qëllim që të mund t'i lexonim të gjitha përpara konferencës së përgjithshme të ardhshme. Disa javë lexonim një bisedë dhe javë të tjera lexonim dy, por çdonjëri duhej ta studionte bisedën dhe të nënvizonte pjesët që i pëlqenin. Më pas, për mbrëmjen familjare ne do ta mësonim njëri-tjetrin nga pjesët tona të nënvizuara.

Shpesh fëmijët tanë kishin pyetje që hapnin diskutime, ose gruaja ime dhe unë bënim pyetje nga studimi ynë. Ne e çmonim shumë kur dëgjonim adoleshentët tanë t'i shpjegonin përgjigjet e tyre ndaj atyre pyetjeve, duke treguar gjëra që i mësonin në seminar, në kishë ose gjatë studimit të tyre vetjak.

Kjo u bë një mënyrë shumë e mirë e të dëgjuarit të dëshmimeve të thjeshta të njëri-tjetrit në mënyrë të rregullt, në një atmosferë shumë të rehatshme, të çlirët.

Shpejt mësuam se studimi i shkrimeve të shenjta në mëngjes mori të njëjtin ton. Disa ditë ne do të lexonim vetëm pak vargje, përpara se koha do të shkonte shpejt prej diskutimit rreth atyre vargjeve dhe mënyrës se si zbatoheshin ato te gjërat që po ndodhin përreth nesh.

Mëngjeset tona mbushen tani me bashkëbisedim, të qeshura dhe harmoni, përpara se secili prej nesh të shkojë në aktivitetet përkatëse. Ne kemi dëshmi të forta për këshillën e profetit tonë për të studiuar dhe për t'u lutur së bashku çdo ditë. Familja jonë është ndryshuar në një familje ku ne mësojmë nga njëri-tjetri dhe e forcojmë njëri-tjetrin. E gjithë kjo është pasojë e dëshirës për të fituar diçka më shumë nga konferenca e përgjithshme. ■

*Greg Beti jeton në Jutá, SHBA.*



## STUDIONI DHE ZBATONI MESAZHET E KONFERENCËS

“Mbani mend se mesazhet që kemi dëgjuar gjatë kësaj konference, do të shtypen në numrat e majit të revistave *Ensign* dhe *Liahona*. Unë ju nxis t'i studioni mesazhet, t'i mendoni thellë mësimet e tyre dhe pastaj t'i zbatoni në jetën tuaj.”

**Presidenti Tomas S. Monson, “Një Fjalë në Mbyllje”, *Liahona*, maj 2010, f. 112-113.**



# RËNDËSIA E MIQVE TË MIRË

Miqtë kanë një ndikim të fortë në veprimet tona, veçanërisht kur jemi të rinj. “Ata do të ndikojnë në mënyrën se si mendoni e veproni dhe madje do të ndihmojnë për të përcaktuar se çfarë njeriu do të bëheni.”<sup>1</sup> Dhe kur zgjidhni miq të mirë, “ata do të jenë një forcë dhe bekim i madh për ju. . . . Do t’ju ndihmojnë të bëheni një njeri më i mirë dhe do t’ju bëjnë më të lehtë që të jetoni ungjillin e Jezu Krishtit.”<sup>2</sup>

Në faqet 52-53 të këtij numri, Elen S. Dalton, presidente e përgjithshme e Të Rejave, na mëson rreth rëndësisë së kërkimit dhe bërjes së një mikut të mirë. “Të kërkuarit e së mirës më të madhe për një njeri tjetër, është thelbi i miqësisë së vërtetë”, thotë ajo.

Ngritja e miqësive mbi këto parime do ta ndihmojë rininë të formojë marrëdhënie jetëgjata dhe aftësi shoqërore, të cilat shkojnë përtej thjeshtë të bërit “miq” në faqet shoqërore të internetit. Si prind, ju mund t’i ndihmoni fëmijët tuaj të kuptojnë rëndësinë e të qenit një mik i mirë dhe të zgjedhjes së miqve që do t’i nxisin ata ta jetojnë ungjillin. Sugjerimet vijuese mund të jenë të dobishme.

## Sugjerime për të Mësuar Rininë

- Si familje, hetoni shkrimet e shenjta për shembuj të miqve të mirë. Diskutoni se cilat cilësi i bënë ato miqësi të forta. Merrni

parasysh Davidin dhe Jonathanin (shih 1 Samuelit 18–23), Ruthin dhe Naomin (shih Ruthi 1–2) dhe Almën dhe bijtë e Mosias (shih Mosia 27–28; Alma 17–20).<sup>3</sup>

- Rishikoni seksionin për miqtë në broshurën *Për Forcën e Rinisë*. Tregojuni adoleshentëve tuaj se si ndikuan miqësitë në jetën tuaj. I ftoni të tregojnë se si kanë ndikuar ata te miqtë e tyre dhe se si janë ndikuar prej miqve të tyre.
- Lexoni artikullin e motrës Dalton në këtë numër. Flisni rreth qëllimit të bijës së saj, Emit, për të kërkuar miq të mirë. I ndihmoni fëmijët tuaj të caktojnë qëllime lidhur me llojin e miqve që dëshirojnë të kërkojnë dhe të jenë.
- Merrni në shqyrtim mbajtjen e një mbrëmjeje familjare për të ndarë ide për krijimin e miqësive, të tilla si: “Që të keni miq të mirë, jini mik i mirë. Tregoni interesim të sinqertë për të tjerët; buzëqeshni dhe bëjuani të ditur se kujdeseni për ta. Trajtojini të gjithë me mirësi e respekt dhe përmbahuni nga gjykimet dhe kritikët për ata që ju rrethojnë.”<sup>4</sup>

## Sugjerime për të Mësuar Fëmijët

- Të qenit mik përfshin të ndihmuarin e të tjerëve. Lexoni “Standing Up for Caleb” në *Liahonën*



## SHKRIME TË SHENJTA PËR MIQËSINË

Fjalët e Urta 17:17; 18:24

Predikuesit 4:9–10

Mateu 25:34–40

Lluka 22:32

Mosia 18:8–9

e marsit 2009 dhe flisni me fëmijët tuaj rreth mënyrave se si mund të jenë të mirë me këdo që takojnë.

- Në të gjitha situatat, ne duhet të vendosim se çfarë lloj mikut do të jemi. Këndoni së bashku “Përpiqem t’Jem si Jezusi”<sup>5</sup> dhe më pas flisni me fëmijët tuaj rreth mënyrave se si mund të zgjedhin të jenë një mik i mirë, si Shpëtimtari, në mjedise të ndryshme. ■

## SHËNIME

1. *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 16.
2. *Për Forcën e Rinisë*, f. 16.
3. Shih Jeffrey R. Holland, “Real Friendship”, *New Era*, qershor 1998, f. 62–66.
4. *Për Forcën e Rinisë*, f. 16.
5. “Përpiqem t’Jem si Jezusi”, *Liahona*, prill 2012, f. 64–65.

# FRYMA E SHENJTË NGUSHËLLON, FRYMËZON DHE DËSHMON

Dhurata e Frymës së Shenjtë është një nga bekimet më të mëdha që mund të marrim në këtë jetë, sepse Fryma e Shenjtë na ngushëllon, frymëzon, paralajmëron, pastron dhe udhëzon. Ai mund të na mbushë “me shpresë dhe dashuri të pastër” (Moroni 8:26). Ai na mëson “të vërtetën e të gjitha gjërave” (Moroni 10:5). Ne marrim zbulesë dhe dhurata shpirtërore nga Perëndia nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Më e rëndësishmja, ne marrim dëshmitë tona për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Përpara se të pagëzoheshit, ju mund ta ndienit Frymën e Shenjtë herë pas here. Por vetëm nëpërmjet marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë pas pagëzimit tuaj, ju mund të gëzoni shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, me kusht që të jeni të denjë.

## NE NUK DUHET TA QUAJMË KËTË DHURATË SI TË MIRËQENË

“Si me të gjitha dhuratat, kjo dhuratë duhet të merret dhe të pranohet që të shijohet. Kur duart e priftërisë u vendosën mbi kokën tënde për të të konfirmuar si anëtar të Kishës, dëgjove fjalët: ‘Merr Frymën e Shenjtë’. Kjo nuk do të thoshte se Fryma e Shenjtë u bë pa kushte shoqëruesi yt i vazhdueshëm. Shkrimet e shenjta na paralajmërojnë se Shpirti i Zotit ‘nuk do të hahet gjithnjë me njeriun’ (Zanafilla 6:3). Kur konfirmohemi, na jepet e drejta për shoqërimin e Frymës së Shenjtë, por ajo është një e drejtë që duhet të vazhdojmë ta fitojmë nëpërmjet bindjes dhe denjësisë.”


Plaku Jozef B. Uirthlin (1917–2008), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: “The Unspeakable Gift”, *Liahona*, maj 2003, f. 28.

Kjo dhuratë u dha nga një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke me anë të vendosjes së duarve (shih Veprat e Apostujve 19:6; DeB 33:15). Çdo ditë Shabati që nga ajo kohë, ju mund t’i ripërtërin besëlidhjet tuaja të pagëzimit ndërsa merrni sakramentin dhe në këtë mënyrë merrni bekimin e Zotit që ju të mund të “ken[il] gjithmonë Shpirtin e Tij” të jetë me ju (DeB 20:77).

Fryma e Shenjtë, të cilin shpesh e quajmë Shpirti, është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi. Profeti Jozef Smith dha mësim: “Ati ka një trup prej mishi e kockash, po aq të prekshëm sa edhe të një njeriu; Biri gjithashtu; por Fryma e Shenjtë nuk ka një trup prej mishi e kockash, por është një personazh i Shpirtit. Po të mos ishte kështu, Fryma e Shenjtë nuk mund të banonte në ne” (DeB 130:22).


“Pasi Shpirti i Zotit nuk banon në tempuj jo të shenjtë” (Helamani 4:24), ne duhet të jemi të denjë për shoqërimin e Tij. Ne e bëjmë këtë, ndërmjet të tjerash, duke pasur mendime të virtytshme, duke jetuar me integritet dhe duke u përpjekur të mbajmë urdhërimet. ■

Për më shumë informacion, shih 2 Nefi 31:13, 17; 32:5; 3 Nefi 27:20; Moroni 10:5–8; Joseph Smith – Historia 1:70.



**Pas marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë, ne mund të bëjmë shumë gjëra për ta ftuar ndikimin e Tij në jetën tonë:**


*Lutemi.*



*Studiojmë shkrimet e shenjta.*



*Marrim me denjësi sakramentin.*



FOTOLIISTRIME NGA CHRISTINA SMITH, EVE TUFT, CODY BELL DHE MATTHEW REER.



*Adhurojmë në tempull.*



*Shikojmë media të shëndetshme, përdorim gjuhë të pastër dhe kemi mendime të virtetshme.*

# Vdekja DHE Jeta

VDEKJA DHE JETA: PIKËPAMJE  
PIONIERËSH PËR RINGJALLJEN

*Ndërkohë që të kthyerit e hershëm në besim të Kishës udhëtuan drejt Shteteve të Bashkuara perëndimore për t'u bashkuar me shenjtoret, ata gjetën vdekjen, por morën përkrahje nga besimi i tyre i ri në ungjillin e rivendosur. Më poshtë janë pjesë të shkëputura nga rrëfime të pionierëve, të cilat tregojnë shpresën e shenjtoreve të Ringjallja, së bashku me mësimet ngushëlluese nga pesë presidentët e parë të Kishës.*

*Historia e një babai shenjtori i ditëve të mëvonshme skandinav të papërmendur me emër, djali i të cilit vdiq gjatë udhëtimit nga Nju-Jorku për në Jutë në 1866-ën:*

“Me ndihmën e një mikut, varri i vogël u gërmua dhe trupi u vendos brenda. Fëmija, i vdekur nga një sëmundje ngjitëse, nuk pati njerëz të mbledhur për të mbajtur zi, as ceremoni zyrtare, as kurora lulesh, as këngë shpirtërore, as fjalë lavdërimi. Por përpara se babai vajtues të largohej, ai shqiptoi një lutje të shkurtër dedikuese në gjuhën e tij mëmë (daneze), që vijon: . . .

‘Ati Qiellor: Ti ma dhe këtë thesar të vogël – këtë djalë të dashur dhe tani Ti e ke thirrur atë larg. A mund të bësh që eshtrat e tij të mund të qëndrojnë këtu të pashqetësuar

deri në mëngjesin e ringjalljes. U bëftë vullneti Yt. Amen.’

Dhe duke u ngritur nga toka, fjalët e tij të lamtumirës ishin:

‘Lamtumirë, Hansi im i dashur, i vogël – biri im i bukur.’ Më pas, me kokën të varur dhe zemrën plot dhembje, ai me vendosmëri vazhdoi rrugën për në vendin e fushimit.”<sup>1</sup>

*Presidenti Jozef Smith (1805–1844):*

“Sa ngushëlluese është për ata që vajojnë, kur ndahen nga një bashkëshort, bashkëshorte, atë, nënë, fëmijë, apo një i afërm i dashur, të dinë se ndonëse vendbanimi tokësor varroset dhe tretet, ata do të ngrihen përsëri që të banojnë në flakët e përjetshme në lavdinë e pavdekshme, që të mos hidhërohen, vuajnë apo





vdesin më, por do të jenë trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë me Jezu Krishtin.”<sup>2</sup>

*Jozef Uatson Jang (1828–1873), nipi i Brigam Jangut, i cili udhëtoi nga Anglia për në Shtetet e Bashkuara në 1853:*

“Ishte një skenë e vajtueshme t’ia dorëzoje një krijesë njerëzore thellësisë së heshtur në orën e vdekur të natës, me vetëm pak dëshmitarë të vetmuar. . . . Ai nuk kishte të afërm në anije ose dikë në veçanti që të vajtonte për të, me përjashtim të një shërbëtori si ai. Këto janë shpresat më të dashura të natyrës njerëzore, të shuara në një çast. Ky i ri kishte braktisur gjithçka për të shkuar në Sion dhe zemra i digjte me parashikime të gjalla për të ardhmen, pa menduar aspak se ai do t’ia dorëzonte trupin e tij tokësor valëve të uritura. Megjithatë, ai vdiq, jo si ata që nuk kanë shpresë, sepse paqja e tij ishte



**Majtas:**  
**Presidenti**  
**Brigam Jang.**  
**Lart:** **Jozef**  
**Uatson Jang.**

vendosur me Perëndinë e tij dhe ai pati sigurinë e plotë të një ringjalljeje të lavdishme në mëngjesin e të drejtëve.”<sup>3</sup>

*Presidenti Brigam Jang (1801–1877):*

“Ç’luginë dhe ç’hije e errët është ajo që ne e quajmë vdekje! Të kalosh nga kjo gjendje e të jetuarit, përsa i përket trupit të vdekshëm, në një gjendje zbrazëtie, sa e habitshme është! Sa e errët është kjo luginë ! Sa e mistershme është kjo udhë dhe neve na duhet ta bëjmë të vetëm. Do të doja t’ju thoja, miqtë dhe vëllezërit e mi, nëse mund t’i shihnim gjërat siç janë, dhe ndërsa do t’i shohim dhe kuptojmë ato, kjo hije dhe luginë e zymtë është kaq e papërfillshme sa ne do të kthehemi dhe do ta hedhim vështrimin mbi të dhe do të mendojmë, kur ta kemi kaluar atë, përse kjo është përparësia më e madhe e tërë ekzistencës sonë, sepse ne kemi kaluar







nga një gjendje hidhërimi, pikëllimi, vajtimi, fatkeqësie, mjerimi, dhembjeje dhe zhgënjimi në një gjendje ekzistence, ku unë mund ta gëzoj jetën në shtrirjen më të madhe, për aq sa ajo mund të bëhet pa një trup.”<sup>4</sup>

*Den Xhons (1811–1862), i kthyer në besim nga Uellsi që, me zj. Uilliams dhe anëtarë të tjerë të Kishës, lundroi për në Shtetet e Bashkuara në 1849:*

“Zj. Uilliams, nga Ynysybont pranë Tregaronit [Uells], po keqësohet shpejt dhe shenjat janë që nuk do të jetojë gjatë. . . . Ajo tha se nderi më i madh që kishte marrë, ishte që mundi të bëhej anëtare e kishës së vërtetë të Birit të Perëndisë, se nuk kishte frikë në kraharorin e saj lidhur me jetën tjetër dhe se feja e saj tashmë e vërtetoi forcën e saj më shumë se ndonjëherë më parë. . . . Ajo me solemnitet i



**Djathtas:**  
**Presidenti**  
**Xhon Tejlor.**  
**Lart: Den**  
**Xhons.**



këshilloi bijtë e saj të vazhdonin plot besim deri në vdekje, me qëllim që ata të merrnin me të një ringjallje më të mirë. . . . Ajo vazhdoi me kthjelltësi gjatë natës dhe në katër e një çerek të mëngjesit pasues shpirti i saj u largua në paqe, duke lënë një buzëqeshje mbi buzët e saj.”<sup>5</sup>

*Presidenti Xhon Tejlor (1808–1887):*

“Sa ngushëlluese është për ata që thirren të vajtojnë humbjen e miqve të tyre të dashur në vdekje, të dinë se ne do të shoqërohemi me ta përsëri! Sa kurajë u jep të gjithëve që jetojnë sipas parimeve të zbuluara të së vërtetës, ndoshta më veçanërisht atyre, jeta e të cilëve pothuajse po mbaron, që e kanë duruar nxehtësinë dhe barrën e ditës, të dinë se pa kaluar shumë kohë ne do të shpërthejmë pengesat e varrit dhe do të vijmë si qenie të gjalla dhe të pavdekshme, për të gëzuar



shoqërinë e miqve tanë të sprovuar dhe të besuar, për të mos vuajtur më me farat e vdekjes dhe për të mbaruar veprën që Ati na ka dhënë për të bërë!”<sup>6</sup>

*Endrju Xhenson (1850–1941), një emigrant danez që udhëtoi me kompaninë e karrocave Endrju H. Skot nga Nebraska, SHBA, deri në Juta më 1866:*

“Kur dëshmuam kufomat tokësore të [bashkudhëtarëve tanë] të vendosura në tokën mëmë, në vendin e shkretët, ne të gjithë vajtuam ose u ndiem gati për të vajtuar; sepse mendimi i varrosjes së të dashurve në këtë mënyrë, kur miqtë dhe të afërmit duhej menjëherë të largoheshin me të shpejtë, pa shpresën se ndonjëherë do t'i vizitonin vendet e prehjes së të vdekurve të tyre përsëri, ishim me të vërtetë i trishtuar dhe sprovues. . . . Por varret e tyre do të gjenden kur Gabrieli t'i bjerë borisë së tij në mëngjesin e ringjalljes së parë. Këta të larguar, pra, i shtrinë trupat e tyre, ndërsa marshonin drejt Sionit. Zoti i thirri në shtëpi përpara

se të arrinin vendmbërritjen e tyre; ata nuk u lejuan ta shihnin Sionin sa ishin gjallë; por do të marrin lavdi dhe do të gëzohen më pas; ata vdiqën ndërsa përpiqeshin t'i bindeshin Perëndisë dhe t'i mbanin urdhërimet e tij, dhe të bekuar janë ata që vdesin në [Zotin].”<sup>7</sup>


*Presidenti Uillford Udraf (1807–1898):*

“Pa ungjillin e Krishtit ndarja nga vdekja është një nga temat më të zymta që është e mundur të mendohet; por sapo marrim ungjillin dhe mësojmë parimin e ringjalljes, zymtia, hidhërimi dhe vuajtja që shkaktohen nga vdekja, largohen në një shkallë të madhe. . . . Ringjallja e të vdekurve paraqitet përpara mendjes së ndriçuar të njeriut dhe

ai ka një themel mbi të cilin të prehet shpirti i tij. Ky është qëndrimi i shenjtorëve të ditëve të mëvonshme sot. Ne vetë e dimë, ne nuk jemi në errësi lidhur me këtë çështje; Perëndia na e ka zbuluar dhe ne e kuptojmë parimin e ringjalljes së të vdekurve dhe se ungjilli nxjerr në pah jetën dhe pavdekësinë.”<sup>8</sup>



**Majtas:**  
**Presidenti**  
**Uillford Udraf.**  
**Lart:** **Endriu**  
**Xhenson.**



*Atje ku ka qenë e nevojshme, është standardizuar drejtshkrimi, përdorimi i shenjave të pikësimit, përdorimi i germës së madhe dhe gramatika për të përmirësuar lexueshmërinë.*

#### SHËNIME

1. Robert Aveson, “Leaves from the Journal of a Boy Emigrant”, *Deseret News*, mars 12, 1921, 4:7; në dispozicion në [lds.org/churchhistory/library/pioneercompanysearch](https://lds.org/churchhistory/library/pioneercompanysearch).

2. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 55.

3. Joseph W. Young, *Journal*, 6 mars 1853, Church History Library, Salt Lake City, Utah; në dispozicion në internet tek



*Uilliam Drajvër (1837–1920), pionier që udhëtoi nga Anglia për në Nju-Jork, ShBA, më 1866:*

“Uilli, fëmija im më i dashur, ishte shumë i sëmurë gjithë natën deri në 7:30 të mëngjesit, kur ai u çlirua nga vuajtjet e tij. Perëndia e bekoftë shpirtin e tij të dashur. Sa shumë vuajtje. Ai e provoi vdekjen për shkak të thyerjes së karrocës së zj. Poulltër në kodrën e Shën-Anës, Uondsuërth, Suri, Angli. O, sa e vajtoj këtë fatkeqësi të madhe. O Zot, ndihmomë nëpërmjet fuqisë Tënde për ta duruar atë, sepse është vullneti Yt, dhe më nxit për të të shërbyer



**Djathtas:  
Presidenti  
Lorenzo Snou.  
Lart: Uilliam  
Drajvër.**

Ty më me fisnikëri dhe me më shumë besim, dhe le të jetoj për t’u takuar me të në një botë më të lumtur dhe më të mirë me motrën e tij të dashur, Elizabet Marianën, dhe në ringjalljen e të drejtëve, qofsha atje për t’i takuar ata.”<sup>9</sup>

*Presidenti Lorenzo Snou (1814–1901):*

“Në jetën që vjen, ne do t’i kemi trupat tanë të përlëvdur dhe të lirë nga sëmundja dhe vdekja. Asgjë nuk është aq e bukur sa një njeri në gjendjen e tij të ringjallur dhe të përlëvdur. Nuk ka asgjë më të dashur se të jemi në këtë gjendje dhe t’i kemi bashkëshortet e fëmijët dhe miqtë tanë me vete.”<sup>10</sup> ■

mormonmigration.lib.byu.edu.

4. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 273.

5. “A Letter from Capt. D. Jones to the Editor of *Udgorn Seion*”, në Ronald D. Dennis, *The Call of Zion: The Story of the First Welsh Mormon Emigration*, vëll. 2 (1987), f. 164–165; në dispozicion tek mormonmigration.lib.byu.edu.

6. *Teachings of Presidents of the Church: John Taylor* (2001), f. 50–51.

7. Andrew Jenson, *Journal*, 20 gusht 1866, në *Journal History of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 8 tetor 1866, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk Siti, Juta, f. 6; në dispozicion tek lds.org/churchhistory/library/pioneercompanysearch.

8. *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 82–83.

9. Frank Driver Reeve, red., *London to Salt Lake City in 1866: The Diary of William Driver* (1942), f. 42; në dispozicion tek mormonmigration.lib.byu.edu.

10. Lorenzo Snow, në *Conference Report*, tetor 1900, f. 63.



**Nga Plaku**  
**Rasëll M. Nelson**

I Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

# Misioni dhe Shërbesa e **JEZU KRISHTIT**

*Prova më e mirë e adhurimit tonë për  
Jezusin është përngjasimi ynë me Të.*

**S**i njëri nga “dëshmitarët e veçantë të emrit të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23), unë besoj se shërbej më mirë nëse i mësoj njerëzit dhe dëshmoj për Të. Së pari, unë mund të bëj të njëjtat pyetje që Ai u bëri dikur farisejve: “Ç’u duket juve për Krishtin? Biri i kujt është?” Mateu 22:42.

Këto pyetje më vijnë në mendje shpesh, kur takohem me udhëheqës të qeverive dhe të grupeve të ndryshme fetare. Disa e pranojnë se “Jezusi ishte një mësues i madh”. Të tjerë thonë: “Ishte një profet”. Të tjerët thjesht nuk e njohin Atë aspak. Ne nuk duhet të habitemi shumë. Në fund të fundit, krahasimisht pak njerëz i kanë të vërtetat e rivendosura të ungjillit që kemi ne. Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë veç një pakicë e vogël mes atyre që shpallin se janë të krishterë.

Rrethanat tona të sotme u parashikuan shekuj më parë nga Nefi:

“Dhe ndodhi që unë vura re kishën e Qengjit të Perëndisë dhe numrat e saj ishin të pakta . . . ; megjithatë unë vura re se kisha e Qengjit, që ishin shenjtorët e Perëndisë, ishte gjithashtu mbi të gjithë faqen e tokës; dhe sundimet e saj mbi faqen e tokës ishin të vogla. . . .

Dhe ndodhi që unë, Nefi, vura re fuqinë e Qengjit të Perëndisë e cila zbriti mbi shenjtorët e kishës së Qengjit dhe mbi njerëzit e besëlidhjes së Zotit që ishin shpërndarë mbi të gjithë faqen e tokës; dhe ata ishin armatosur me drejtësi dhe me fuqinë e Perëndisë në lavdi të madhe” (1 Nefi 14:12, 14).

Ajo drejtësi, ajo fuqi dhe ajo lavdi – në të vërtetë, të gjitha bekimet tona të shumta – rrjedhin nga dituria jonë për Zotin Jezu Krisht, nga bindja jonë ndaj Tij dhe nga mirënjohja dhe dashuria jonë për Të.



Gjatë qëndrimit të Tij krahasimisht të shkurtër në vdekshmëri, Shpëtimtari plotësoi dy objektiva mbizotërues. Njëri ishte “vepra dhe lavdia [e Tij] – të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Tjetrin Ai e përcaktoi thjesht: “Unë, ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju” (Gjoni 13:15).

Objektivin e Tij të parë ne e njohim si Shlyerja. Ky ishte misioni i Tij i madhërisëm në vdekshmëri. Njerëzve të Amerikës së lashtë, Zoti i ringjallur u dha deklaratën e misionit të Tij:

“Unë erdha në botë për të bërë vullnetin e Atit tim, sepse Ati im më dërgoi.

Dhe, Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita në kryq, që t’i tërheq të gjithë njerëzit tek unë” (3 Nefi 27:13–14).

Në vazhdimin e predikimit të Tij, Ai zbuloi objektivin e Tij të dytë – të jetë shëmbulli ynë: “Ju i dini gjërat që duhet të bëni . . . ; pasi veprat që më keni parë të bëj, duhet t’i bëni edhe ju” (3 Nefi 27:21).

Objektivin e Tij të parë e kam përkufizuar si *misioni i Tij*. Objektivin e Tij të dytë do të doja ta përcaktoja si *shërbesa e Tij*. Le t’i rishikojmë këto dy pjesë përbërëse të jetës së Tij – misionin e Tij dhe shërbesën e Tij.

### Misioni i Jezu Krishtit – Shlyerja

Misioni i Tij ishte Shlyerja. Ai mision ishte vetëm dhe vetëm i Tij. I lindur nga një nënë e vdekshme dhe nga një Atë i pavdekshëm, Ai i vetmi që vullnetarisht mund ta linte jetën e Tij dhe ta merrte atë përsëri (shih Gjoni 10:14–18). Pasojat e lavdishme të Shlyerjes së Tij ishin të pafundme dhe të përjetshme. Ai i hoqi thumbin vdekjes dhe e bëri të përkohshëm hidhërimin e varrit (shih 1 Korintasve 15:54–55). Përgjegjësia e Tij për Shlyerjen dihej edhe përpara Krijimit dhe Rënies. Jo vetëm që


do të siguronte ringjalljen dhe pavdekësinë e gjithë njerëzimit, por do të na jepte gjithashtu mundësinë që të faleshim për mëkatet tona – sipas kushteve të përcaktuara prej Tij. Kështu Shlyerja e Tij hapi udhën nëpërmjet së cilës ne mund të bashkoheshim me Të dhe me familjet tona përjetësisht. Këtë mundësi ne e vlerësojmë si jetë të përjetshme – më e madhja dhuratë e Perëndisë për njeriun (shih DeB 14:7).

Askush tjetër nuk mund ta kryente Shlyerjen. Askush tjetër, madje me pasurinë dhe fuqinë më të madhe, nuk mund të shpëtojë një shpirt – as vetë shpirtin e tij (shih Mateu 19:24–26). Dhe asnjë njeriu tjetër nuk i kërkohet apo i lejohet të derdhë gjak për shpëtimin e përjetshëm të një qenieje tjetër njerëzore. Jezusi e bëri “një herë për të gjithë” (Hebrenjve 10:10).

Edhe pse Shlyerja ndodhi gjatë kohës së Dhiatës së Re, ngjarje të kohës së Dhiatës së Vjetër shpesh e parathanë rëndësinë e saj. Adami dhe Eva u urdhëruan të ofronin flijime “në ngjashmëri me flijimin e të Vetëmlindurit të Atit” (Moisiu 5:7). Në ç’mënyrë? Me anë të derdhjes së gjakut. Nga vetë përvoja e tyre ata vërtetuan shkrimin e shenjtë që “jeta e mishit është në gjak” (Levitiku 17:11).

Mjekët e dinë se kur në një organ gjaku ndalon së rrjedhuri, fillojnë probleme. Nëse nuk shkon më gjak në një këmbë, mund të fillojë gangrena. Nëse ndalohet rrjedhja në tru, mund të ndodhë një goditje. Nëse gjaku nuk ia del të kalojë normalisht nëpër një arterie të zemrës, mund të zhvillohet një infarkt. Dhe nëse hemorragjia nuk mbahet nën kontroll, më pas vjen vdekja.

Adami, Eva dhe brezat që pasuan, mësuan se, sa herë që derdhnin gjak nga një kafshë, jeta e saj ndërpritej. Për ritin e tyre flijues, nuk mund të përdorej thjesht një kafshë *çfarëdo*. Duhej të ishte një i parëlindur i tufës dhe pa të meta (shih, për shëmbull, Eksodi 12:5).



GRUA, SHIH BRIN TËND (STABAT MATER), NGA JAMES TISSOT © MUZEUMI I BRUKLIN, BRUKLIN, NJUJORK; SHTO, DETAJ NGA NË KOPSHIN E GJETSEMANIT, NGA CARL HEINRICH BLOCH

**S**hpëtimtari filloi të derdhte gjakun e Tij për gjithë njerëzimin jo në kryq, ku u përfundua agonia e Shlyerjes, por në Kopshtin e Gjetsemanit.



Këto kërkesa të nevojshme ishin gjithashtu simbolike për flijimin përfundimtar të Qengjit të panjollë të Perëndisë.

Adamit dhe Evës iu dha një urdhërim: “Si rrjedhim, ti do të bësh gjithçka që bën, në emër të Birit dhe do të pendohesh e do t’i thërrasësh Perëndisë në emër të Birit përgjithmonë” (Moisiu 5:8). Nga ajo ditë deri në meridianin e kohës, flijimi i kafshëve vazhdoi të ishte një lloj dhe një hije e Shlyerjes përfundimtare të Birit të Perëndisë.

Kur Shlyerja u plotësua, ai flijim i madh dhe i fundit përmbushi ligjin e Moisiut (shih Alma 34:13–14) dhe i dha fund praktikës së flijimit të kafshëve, që i kishte mësuar se “jeta e mishit [ishte] në gjak” (Levitiku 17:11). Jezusi shpjegoi se si pjesët përbërëse të flijimit të lashtë u përfshinë nga Shlyerja dhe përkujtohen në mënyrë simbolike nga sakramenti. Vërinë re përsëri përmendjet e jetës, mishit dhe gjakut:

“Prandaj Jezusi u tha atyre: ‘Në të vërtetë, në të vërtetë, po ju them se, po të mos hani mishin e Birit të njeriut dhe të mos pini gjakun e tij, nuk keni jetën në veten tuaj.

Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, ka jetë të përjetshme, dhe unë do ta ringjall atë në ditën e fundit’” (Gjoni 6:53–54).

Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, i gjithë njerëzimi – të gjithë ata që dëshirojnë – do të shëlbhen. Shpëtimtari e filloi derdhjen e gjakut të Tij për gjithë njerëzimin jo në kryq, por në Kopshtin e Gjetsemanit. Atje Ai mori mbi Vete peshën e mëkateve të të gjithë atyre që do të vinin në jetë. Nën atë barrë të rëndë, Atij i doli gjak nga çdo por (shih DeB 19:18). Agonia e Shlyerjes u plotësua në kryq në Kalvari.

Rëndësia e Shlyerjes u përmbloodh nga Profeti Jozef Smith. Ai tha: “Parimet themelore të fesë sonë janë dëshmia e apostujve dhe e profetëve lidhur me Jezu Krishtin, që Ai vdiq, u varros dhe u ngrit përsëri në ditën e tretë, dhe u ngjiti në qiell; dhe të gjitha gjërat e tjera që lidhen me fenë tonë janë vetëm shtesa të kësaj”<sup>1</sup>.

Me atë autoritet dhe me mirënjohjen më të thellë, unë ju mësoj dhe dëshmoj për Të.

### **Shërbesa e Jezu Krishtit – Shembulli**

Objektivi i dytë i Zotit, me rëndësi të madhe në vdekshmëri, ishte të shërbente si shembull për ne. Jeta e Tij shembullore përbënte shërbesën e Tij të vdekshme. Ajo

përfshiu mësimet, shëmbëlltyrat dhe predikimet e Tij. Përfshiu mrekullitë, dashurinë e përzemërt dhe shpirtmirësinë e Tij ndaj fëmijëve të njerëzve (shih 1 Nefi 19:9). Përfshiu përdorimin e Tij plot dhembshuri të autoritetit të priftërisë. Përfshiu zemërimin e Tij të drejtë, kur Ai dënoi mëkatin (shih Romakëve 8:3) dhe kur përmbysi tryezat e këmbyesve të parave (shih Mateu 21:12). Gjithashtu përfshiu pikëllimet e Tij. Ai u përqesh, u fshikullua dhe u mohua nga vetë populli i Tij (shih Mosia 15:5) – madje u tradhtua nga një dishepull dhe u mohua nga një tjetër (shih Gjoni 18:2–3, 25–27).

Edhe pse ishin të mrekullueshme veprat e Tij shërbestare, ato nuk ishin dhe ende nuk janë vetëm të Tijat. Nuk ka kufi të numrit të njerëzve që mund ta ndjekin shembullin e Jezusit. Vepra të ngjashme janë bërë nga profetët dhe apostujt e Tij dhe të tjerë mes shërbëtorëve të autorizuar të Tij. Shumë kanë duruar përndjekje për hir të Tij (shih Mateu 5:10; 3 Nefi 12:10). Në vetë kohën tonë, ju njihni vëllezër dhe motra që me zell janë përpjekur – madje edhe me një çmim të tmerrshëm – për të përngjasuar shembullin e Zotit.

Ajo është ashtu siç duhet të jetë. Ajo është shpresa e Tij për ne. Zoti na ka kërkuar të ndjekim shembullin e Tij. Kërkesat e Tij janë krejtësisht të qarta:

- “Çfarë lloj njerëzish duhet të jeni? . . . Madje siç jam unë” (3 Nefi 27:27; shih gjithashtu 3 Nefi 12:48).
- “Ndiqmëni dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish” (Mateu 4:19).
- “Ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju” (Gjoni 13:15; shih gjithashtu Gjoni 14:6).

Këto dhe shkrime të tjera të shenjta, të ngjashme, nuk u shkruan si sugjerime. Ato

janë porosi hyjnore! Ne duhet të ndjekim shembullin e Tij!

Që ta bëjmë më të lehtë dëshirën tonë për ta ndjekur Atë, ndoshta ne mund të marrim parasysh pesë aspekte të jetës së Tij, të cilave mund t’i përngjasojmë.


### **Dashuria**

Nëse do të pyesja cilën karakteristikë të jetës së Tij do të përcaktoni fillimisht, mendoj se ju mund të thoni cilësinë e Tij të dashurisë. Ajo do të përfshinte dhembshurinë, mirësinë, dashurinë hyjnore, përkushtimin, faljen, mëshirën, drejtësinë dhe të tjera. Jezusi e deshi Atin e Tij dhe nënën e Tij (shih Gjoni 19:25–27). Ai i deshi familjen e Tij dhe shenjtorët (shih Gjoni 13:1; 2 Thesalonikasve 2:16). Ai e deshi mëkatarin pa e justifikuar mëkatin (shih Mateu 9:2; DeB 24:2). Dhe Ai na mësoi se si mund ta tregojmë dashurinë tonë për Të. Ai tha: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia” (Gjoni 14:15). Më pas, për të nënvizuar se dashuria e Tij nuk ishte *pa kushte*, Ai shtoi: “Po të zbatoni urdhërimet e mia, do të qëndroni në dashurinë time, sikurse unë i zbatova urdhërimet e Atit tim dhe qëndroj në dashurinë e tij” (Gjoni 15:10; shih gjithashtu DeB 95:12; 124:87).

Një shprehje tjetër e dashurisë së Shpëtimtarit tonë ishte shërbimi i Tij. Ai i shërbeu Atit të Tij dhe u shërbeu njerëzve me të cilët jetoi dhe punoi. Në të dyja mënyrat, ne duhet ta ndjekim shembullin e Tij. Ne duhet t’i shërbejmë Perëndisë, “të ecim në tërë rrugët e tij dhe ta duam” (Ligji i Përtërirë 10:12; shih gjithashtu 11:13; Jozueu 22:5; DeB 20:31; 59:5). Dhe ne duhet t’i duam fqinjët tanë nëpërmjet shërbimit ndaj tyre (shih Galatasve 5:13; Mosia 4:15–16). Ne fillojmë me familjet tona. Dashuria e thellë që i lidh prindërit me fëmijët e tyre, farkëtohet me anë të shërbimit ndaj tyre gjatë gjithë kohës së varësisë së plotë të tyre. Më vonë gjatë jetës, fëmijët, të



**T**ipari që e dalloi mësimdhënien e Shpëtimtarit mbi atë të gjithë mësuesve të tjerë, ishte se Ai na mësoi të vërteta të rëndësishme të përjetshme. Vetëm Ai mund ta kishte zbuluar qëllimin tonë në jetë.







cilët e kanë ndjenjën e detyrës, mund të kenë mundësi për t'ua kthyer atë dashuri, kur u shërbejnë prindërve të tyre të moshuar.

### **Ordinancat**

Një aspekt i dytë i jetës shembullore të Shpëtimtarit ishte theksimi i Tij lidhur me ordinancat e shenjta. Gjatë shërbesës së Tij të vdekshme, Ai tregoi rëndësinë e ordinancave të shpëtimit. Jezusi u pagëzua nga Gjoni në lumin Jordan. Edhe Gjoni pyeti: “Pse?”

Jezusi shpjegoi: “Sepse në këtë mënyrë *ne* përmbushim çdo drejtësi” (Mateu 3:15; theksimi i shtuar). Jo vetëm që ishte ordinanca thelbësore, por edhe shembulli i caktuar nga Jezusi dhe Gjoni ishte gjithashtu thelbësor.

Më vonë Zoti krijoi ordinancën e sakramentit. Ai shpjegoi simbolikën e sakramentit dhe ua administroi emblemat e tij të shenjta dishepujve të Tij (shih Mateu 26:26–28; Marku 14:22–24; Lluca 24:30).

Ati ynë Qiellor gjithashtu dha udhëzime lidhur me ordinancat. Ai tha: “Ju do të linden përsëri në mbretërinë e qiellit, prej ujit dhe prej Shpirtit, dhe të pastroheni me anë të gjakut, madje gjakut të të Vetëmlindurit tim; që ju të mund të shenjtëroheni nga gjithë mëkati dhe të gëzoni fjalët e jetës së përjetshme në këtë botë dhe jetën e përjetshme në botën që vjen, madje lavdi të pavdekshme” (Moisiu 6:59).

Gjatë shërbesës së Zotit pas vdekjes, ordinancat më të larta të ekzaltimit u zbuluan (DeB 124:40–42). Ai i ka siguruar këto ordinanca në tempujt e Tij të shenjtë. Në kohën tonë, larjet, vajosjet dhe indaumentet u jepen individëve që përgatiten siç duhet (shih DeB 105:12, 18, 33; 110:9; 124:39). Në tempull, një individ mund të vluoset me bashkëshortin ose bashkëshorten, me paraardhësit dhe me pasardhësit (shih DeB 132:19). Zoti ynë është një Perëndi i ligjit dhe i rregullit (shih DeB 132:18). Përqendrimi i Tij te ordinancat është një pjesë e fuqishme e shembullit të Tij për ne.

### **Lutja**

Një aspekt i tretë i shërbesës shembullore të Zotit është lutja. Jezusi iu lut Atit të Tij në Qiell dhe gjithashtu na mësoi se si të lutemi. Ne duhet t'i lutemi Perëndisë, Atit të Përjetshëm, në emër të Birit të Tij, Jezu Krishtit, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë (shih Mateu 6:9–13; 3 Nefi 13:9–13; Përkthimi prej Joseph Smith-it, Mateu 6:9–15). Më pëlqen

shumë Lutja e madhe Ndërmjetësuese e bërë nga Zoti, e shënuar te Gjoni, kapitulli 17. Në të Biri komunikon lirisht me Atin e Tij në emër të dishepujve të Tij, të cilët Ai i do. Ajo është model i lutjes së efektshme dhe plot dhembshuri.

### **Dituria**

Një aspekti i katërt i shembullit të Zotit është përdorimi i diturisë së Tij hyjnore. Siç u përmend më parë, shumë njerëz jo të krishterë e pranojnë se Jezusi ishte një mësues i madh. Me të vërtetë, Ai ishte. Por çfarë i dallonte me të vërtetë mësimit e Tij? A ishte Ai një instruktor i aftë në inxhinieri, matematikë apo shkencë? Si Krijuesi i kësaj bote dhe i botëve të tjera (shih Moisiu 1:33), Ai me siguri mund të kishte qenë. Ose, si Autori i shkrimit të shenjtë, Ai mund të kishte dhënë shumë mirë mësim për krijimtarinë letrare.

Tipari që e dalloi mësimit të Tij mbi atë të gjithë mësuesve të tjerë, ishte se ai na mësoi të vërteta me rëndësi të *së përjetshme*. Vetëm Ai mund ta kishte zbuluar qëllimin tonë në jetë. Vetëm nëpërmjet Tij ne mund të mësojmë për ekzistencën tonë *para vdekjes* dhe për mundësinë tonë *pas vdekjes*.

Në një rast, Mësuesi Mjeshtër u tha dëgjuesve të Tij mosbesues se ata kishin tre dëshmitarë të Tij:

- Gjon Pagëzorin.
- Veprat që Jezusi kishte kryer.
- Fjalën e Perëndisë, Atit të Përjetshëm (shih Gjoni 5:33–37).

Ai më pas ofroi një dëshmitar të katër: “Ju hetoni Shkrimet sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua” (Gjoni 5:39).

Fjala *mendoni* në atë frazë në fillim mund të duket se nuk është në vendin e duhur. Por kjo është jetësore për kuptimin që Jezusi po përpiquej të përçonte. Ai e dinte se shumë prej dëgjuesve të Tij në të vërtetë *mendonin* vërtet se jeta e përjetshme ishte në shkrimet e shenjta. Por ata e kishin gabim. Vetëm shkrimet e shenjta *nuk mund* të japin jetë të përjetshme. Sigurisht ka fuqi në shkrimin e shenjtë, por ajo fuqi vjen nga Jezusi Vetë. Ai *është* Fjala: *Shenja dalluese*. Fuqia e jetës së përjetshme është në Të, i cili “në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi” (Gjoni 1:1; shih gjithashtu 2 Nefi

31:20; 32:3). Më pas, për shkak të qëndrimit kokëfortë të skeptikëve të Tij, Jezusi vazhdoi t'i qortonte ata: “Ju nuk doni që të vini tek unë që të keni jetën [e përjetshme]” (Gjoni 5:40).

Mësuesi mund të na kishte mbizotëruar me diturinë e Tij hyjnore, por Ai s'e bën këtë. Ai e respekton lirinë tonë të zgjedhjes. Ai na lejon gëzimin e zbulimit. Ai na nxit të pëndohe mi për mëkatet tona. Ai na lejon ta përjetojmë lirinë që vjen nga bindja e vullnetshme ndaj ligjit të Tij hyjnor. Po, mënyra se si Ai e përdor diturinë e Tij, jep një shembull të madh për ne.

### **Durimi**

Një aspekt i pestë i shërbesës së Zotit është zotimi i Tij për të duruar deri në fund. Ai nuk u tërhoq kurrë nga detyra e Tij. Edhe pse përjeto i vuajtje përtej të kuptuarit tonë, Ai nuk u dorëzua. Përmes sprovave gjithnjë e më të mëdha, Ai duroi deri në fund të detyrës së Tij: që të shlyente për mëkatet e gjithë njerëzimit. Fjalët e Tij përfundimtare, ndërrsa ishte i varur në kryq, ishin: “U krye” (Gjoni 19:30).

### **Zbatimi në Jetën Tonë**


Këto pesë aspekte të shërbesës së Tij mund të zbatohen në vetë jetën tonë. Sigurisht prova më e mirë e adhurimit tonë për Jezusin është përngjasimi ynë me Të.

Kur fillojmë ta kuptojmë se kush është Jezusi dhe se çfarë ka bërë për ne, ne mund të kuptojmë, në një farë shkalle, logjikën e urdhërimit të parë dhe të madh: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde” (Marku 12:30). Me fjalë të tjera, gjithçka që ne mendojmë, bëjmë dhe themi do të zhytet në dashurinë tonë për Të dhe Atin e Tij.

Bëjini vetes pyetjen: “A ka ndonjë që e dua më shumë se Zotin?” Më pas krahasojeni përgjigjen tuaj me këto standarde të caktuara nga Zoti:

- “Ai që e do të atin ose nënën më shumë se [mua], nuk është i denjë për mua.”
- “Ai që e do birin ose bijën më shumë se [mua], nuk është i denjë për mua” (Mateu 10:37).

*Dashuria* për familjen dhe miqtë, edhe pse mund të jetë e madhe, është shumë më e thellë kur bazohet në



**J**eta shembullore e Zotit përbënte shërbesën e Tij të vdekshme. Ajo përfshiu mësimet, shëmbëlltyrat dhe predikimet e Tij. Përfshiu përdorimin e Tij plot dhembshuri të autoritetit të priftërisë.

dashurinë e Jezu Krishtit. Dashuria prindërore për fëmijët ka më shumë kuptim këtu dhe në jetën më pas për shkak të Tij. Të gjitha marrëdhëniet e dashurisë lartësohen në Të. Dashuria e Atit tonë Qiellor dhe Jezu Krishtit siguron ndriçim, frymëzim dhe arsye për t'i dashur të tjerët në një mënyrë më të mirë.

*Ordinancat* sigurojnë një përqendrim për shërbim me një vlerë të përjetshme. Prindërit duhet të marrin parasysh se cila ordinancë nevojitet më pas për secilin fëmijë. Mësuesit e shtëpisë duhet të mendojnë një ordinancë të përshtatshme, që i nevojitet më pas secilës familje që ata i shërbejnë.

Shembulli i Shpëtimtarit për *lutjen* na kujton se lutja vetjake, lutja familjare dhe ndjekja plot lutje e detyrave tona në Kishë duhet të bëhen pjesë e jetës tonë. Njohja dhe bërja e vullnetit të Atit na sigurojnë forcë dhe vetëbesim të madh shpirtëror (shih DeB 121:45). Vendi ku duam të jemi është në anën e Zotit.

*Dituria* “për gjërat ashtu siç janë në të vërtetë dhe për gjërat ashtu siç do të jenë në të vërtetë” (Jakobi 4:13) na lejon të veprojmë në bazë të parimeve dhe doktrinës së vërtetë. Ajo dituri do ta ngrejë nivelin tonë të sjelljes. Veprime që përndryshe do të nxiteshin nga dëshira dhe emocioni, do të zëvendësohen nga veprime të formuara nga arsyeja dhe e drejta.

Një zotim për të *duruar deri në fund* do të thotë se ne nuk do të kërkojmë lirim nga një thirrje për të shërbyer. Do të thotë se ne do të këmbëngulim në ndjekjen e një qëllimi të denjë. Do të thotë se ne kurrë nuk do ta humbasim shpresën për një njeri të dashur që ka dalë nga udha. Dhe do të thotë se ne gjithmonë do t'i dëshirojmë marrëdhëniet tona të përjetshme familjare, edhe përmes ditëve të vështira të sëmundjes, paaftësisë ose vdekjes.

Me gjithë zemrën time lutem që ndikimi ndryshues i Zotit mund të bëjë një ndryshim të thellë në jetën tonë. Misioni i Tij dhe shërbesa e Tij mund ta bekojnë secilin prej nesh tani dhe përgjithmonë. ■

*Nga një fjalim në një mbledhje shpirtërore dhënë më 18 gusht 1998 në Universitetin “Brigham Jang”. Për tekstin e plotë në anglisht, shkoni te [speeches.byu.edu](http://speeches.byu.edu).*

#### SHËNIM

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith (2009), f. 52.*

# Java e Pashkës

Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, e përmbushi Shlyerjen – që përfshiu vuajtjen e Tij në Gjetsemani, Kryqëzimin e Tij në Golgota dhe Ringjalljen e Tij nga varri – gjatë javës së fundit të jetës së Tij.

Në Këshillin e Qiellit, përpara se të krijohet toka, Ati Qiellor paraqiti planin e Tij për ne, fëmijët e Tij. Ne thirrëm me gëzim kur Ati Qiellor zgjodhi Jezu Krishtin për të zbatuar planin e shpëtimit (shih Jobit 38:7 dhe Abraham 3:27). I lindur nga Maria në Bethlehëm, Jezusi jetoi një jetë pa mëkat. Për shkak të Shlyerjes së Tij, ne mund të kthehemi për të jetuar me Atin tonë Qiellor dhe për të marrë jetë të përjetshme. Jezu Krishti do të vijë përsëri me fuqi dhe lavdi për të banuar në tokë gjatë Mijëvjeçarit dhe Ai do të qëndrojë si Gjykatës i të gjithë njerëzve në ditën e fundit.

Në vijim janë disa fotografi nga videot e Biblës që përshkruajnë javën e fundit të jetës së Shpëtimtarit. Merreni në konsideratë leximin e vargjeve të shkrimeve të shenjta për secilën fotografi. Për një kronologji të plotë të ngjarjeve, drejtojuini harmonizimit të katër Ungjijve në Fjalorin e Biblës ose në Udhëzuesin e Shkrimeve të Shenjta. Videot e Biblës mund t'i gjeni në [biblevideos.lds.org](http://biblevideos.lds.org).

FOTOGRAFIE © IRI



**Në ditën e pestë para Pashkës, Jezusi hyri në Jerusalem mbi një gomare, sikurse u profetizua. Njerëzit e njohën Atë si Mbretin e tyre, duke thirrur "Hosana" dhe i vendosën mantelet e tyre dhe degët e palmave në tokë përpara gomares. (Shih Mateu 21:1-11; Marku 11:1-11; Zakaria 9:9.)**



**Për herë të dytë gjatë shërbesës së Tij të vdekshme, Jezusi pastroi oborret e tempullit. "Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutje, por ju e keni kthyer në një shpellë kusarësh", u tha Ai këmbyesve të parave (Mateu 21:13). Më pas shumë të verbër dhe të çalë erdhën tek Ai në tempull dhe Ai i shëroi. Por kur kryepiftërinjtë dhe skribët panë mrekullitë e Tij, ata u egërsuan dhe kërkuan një mënyrë për ta shkatërruar Atë. (Shih Mateu 21:12-17; Marku 11:15-19.)**

**Jezu Krishti, Biri i Vetëmlindur i Atit, denjoi të vinte në tokë për t'i shëlbuar të gjithë njerëzit nga Rënia. (Shih 1 Nefi 11:16-22, 26-33; Alma 7:10-13.)**




*Gjatë gjithë javës, Shpëtimtari mbajti disa nga predikimet e Tij më të paharrueshme, duke përfshirë mësimet e tij rreth parasë së të vesë. (Shih Marku 12:41–44; Lluka 21:1–4.)*

*Në Kopshtin e Gjetsemanit, Shpëtimtari ra në gjunjë dhe u lut, agonia e Tij për mëkatet e botës duke e bërë Atë “të dridhe[t] për shkak të dhembjes e [t’i] dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj[ë] si në trup e në shpirt” (DeB 19:18). Shpejt Juda Iskarioti dhe një turmë burrash të armatosur arrestuan Jezusin dhe gjithë dishepujt e braktisën Zotin dhe u larguan. (Shih Mateu 26:36–56; Marku 14:32–50; Lluka 22:39–53.)*



*Gjatë darkës së Tij të fundit, Jezusi u premtoi apostujve të Tij se ata do të merrnin Ngushëlluesin, ose Frymën e Shenjtë, kur Ai të ishte larguar. Ai i mësoi ta kujtonin Atë nëpërmjet marrjes së sakramentit. Në fund të mbrëmjes, Jezusi bëri Lutjen Ndërmjetësuese, ku Ai u lut që dishepujt të mund të bëheshin një në unitet. (Shih Mateu 26:17–30; Marku 14:12–26; Lluka 22:14–32; Gjoni 13–17.)*





*Pas një gjyqi të paligjshëm dhe fshikullimit të egër, Jezu Krishti i lejoj ta kryqëzonin, duke përmbushur “flijimin e madh dhe të fundit”, i cili e bëri të mundur shpëtimin për gjithë fëmijët e Perëndisë (shih Alma 34:14–15). Përpara se të binte nata, pasuesit e Jezusit e larguan trupin e Tij nga kryqi, e mbuluan Atë me të linjta dhe erëza dhe e vendosën në një varr. (Shih Mateu 27; Lluca 23; Marku 15; Gjoni 19.)*



*Mëngjesi i së dielës agoi dhe Maria Magdalena dhe gra të tjera besimtare arritën te varri për ta vajosur më shumë trupin e Jezusit. Ato e gjetën gurin e varrit të lëvizur dhe dy engjëj që shpallën lajmet e gëzueshme: “Ai nuk është këtu, sepse u ringjall” (Mateu 28:6). Shpëtimtari i ringjallur e kishte mposhtur vdekjen fizike dhe bëri të mundur që secili nga ne të jetojë përsëri: “Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin” (1 Korintasve 15:22). (Shih Mateu 28; Marku 16; Lluca 24; Gjoni 20). ■*

# Të Ndhimuarit e Fëmijëve

## PËR T'U PËRGATITUR PËR PAGËZIM

Nga Xhesika Larsen dhe Marisa Uidison

Revistat e Kishës

**F**ëmijëria është një kohë për plot herë të para që sjellin gëzim. Ngarja e një biçiklete për herë të parë, vajta në shkollë për herë të parë ose të provuarit e një ushqimi të ri janë disa nga aventurat emocionuese që i japin formë jetës së një fëmije. Si të rritur, ne kemi mundësinë për t'i ndihmuar fëmijët përgjatë atij shtegu të zbulimit. Si të rritur në Kishë, ne gjithashtu kemi mundësinë për t'i ndihmuar ata të rriten në ungjill (shih DeB 68:25). Çfarë mund të bëjmë për t'u siguruar që pagëzimi i një fëmije – besëlidhja e parë që një njeri bën me Atin tonë të dashur Qiellor – të jetë një ngjarje e bukur dhe kuptimplote?

“Ai është parimi bazë i kësaj Kise për ta mësuar rininë: në fillim në shtëpi dhe më pas në kishë”, tha Presidenti Bojd K. Pakër.<sup>1</sup>

Në shembujt e mëposhtëm, prindërit tregojnë se si i kanë përgatitur fëmijët e tyre për ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta të pagëzimit dhe të konfirmimit.

### Ne Fillojmë Herët

“Viti kur çdo fëmijë mbush shtatë vjeç është koha për të festuar”, thotë Lori, një nënë e katër fëmijëve. Ajo dhe bashkëshorti i saj i mësojnë fëmijët rreth pagëzimit që nga dita kur ata linden. Megjithatë, kur çdo fëmijë mbush shtatë vjeç, familja e tyre fillon një përgatitje më të veçantë. Ata mbajnë një mësim çdo muaj në mbrëmjet familjare rreth temave të ndryshme që lidhen me pagëzimin, të tilla si besëlidhjet dhe shembulli i Jezusit.

Lori thotë se mësimet gjatë muajit që fëmijët kanë ditëlindjen e tetë vjetorit, janë veçanërisht prekës. Ajo u tregon fëmijëve rrobat që veshën kur morën një emër e një bekim dhe ajo u flet për ditën kur u krye ajo ordinancë.

“Është koha e përsosur për t'u përqendruar te bekimet e besëlidhjeve të tempullit”, vë në dukje Lori. “Ne gjithmonë i vëmë rëndësi të mësuarit që zgjedhja për t'u pagëzuar është hapi i parë në përgatitjen për bekimet e tempullit.”



### Ne e Bëjmë një Çështje të Familjes

Monika, një nënë me katër fëmijë, rekomandon përfshirjen e fëmijëve më të rritur që të ndihmojnë në përgatitjen e motrave dhe vëllezërve më të vegjël, kurdoherë që është e mundur. “Dëgjimi i vëllait ose motrës së tyre adoleshente duke dëshmuar dhe duke treguar përvojën e tij ose të saj, me të vërtetë shton fuqi”, thotë ajo. Lori thotë se nganjëherë ata u kërkojnë fëmijëve që po përgatiten për pagëzim, që t'u mësojnë atë që ata u kanë mësuar vetë vëllezërve dhe motrave të tyre më të vegjël.





### Ne e Përdorim si Mjet Misionar

Kur vajza e Danielit mbushi tetë vjeç, ai e dinte se ajo do të dëshironte ta ndante ditën e saj të pagëzimit me shoqet dhe shokët që nuk ishin anëtarë të Kishës. Kështu, familja e tyre vendosi t'u bënte ftesa për pagëzimin e Alisonit miqve nga shkolla dhe nga lagjia e banimit. Këtyre miqve iu kërkua të sillnin vargje të preferuara nga Bibla lidhur me pagëzimin. Pas pagëzimit, Alisoni i nënvizoi vargjet në kompletin e saj të shkrimeve të shenjta dhe shkroi emrat e miqve të saj në cep.

“Sigurisht, si familja e saj, ne ishim shumë të përfshirë në atë ditë. Por gjithashtu e lamë atë të ishte me miqtë e saj për një kohë të gjatë më pas dhe për të folur me ta rreth asaj që ndieu”, tha Danieli. “Ishte një çast vërtet prekës ta shihnim fëmijën tonë të bëhej një shembull.”

### Ne Praktikojmë Intervistën me Peshkopin

Kimberli, një nënë me fëmijë që po i afroreshin moshës së pagëzimit, e kujton hyrjen në zyrën e peshkopit për intervistën e saj pagëzimore, kur ishte tetë vjeç. “Isha shumë e shqetësuar!” thotë Kimberli.

Tani ajo përpiqet të sigurohet që fëmijët e saj të mos përballen me ndjenja paniku. Ajo dhe bashkëshorti i saj u flasin fëmijëve të tyre rreth intervistës me peshkopin dhe u bëjnë pyetje rreth pagëzimit në një mjedis të ngjashëm me atë të intervistës. Këto intervista bëjnë më shumë sesa thjesht t'i njohin fëmijët me procesin e intervistës – ato gjithashtu i nxisin fëmijët të mendojnë thellë rreth asaj se çfarë do të thotë për ta besëlidhja e pagëzimit.

### Ne Kemi një Mundësi të Mrekullueshme

Këta prindër vënë shpejt në dukje se nuk kanë bërë ndonjë gjë të stërmadhe në përgatitjen e fëmijëve të tyre për pagëzim dhe konfirmim, për shumë prej tyre përdorën vërtet fjalë të tilla si “tërësor” dhe “të vazhdueshëm” për të përshkruar mësimet që ata dhanë gjatë viteve. “Ne u siguroam që fëmijët tanë ta kuptonin se ky ishte një hap i rëndësishëm në jetën e tyre dhe se ishte diçka e madhe” thotë Kimberli. “Ne gjithmonë u siguroam që të ishim ne ata që po i përgatisnin dhe jo thjesht të shpresonim se mësuesit e tyre të Filllores do t'u jepnin mësim.”

Çfarë mundësie e mrekullueshme që na është dhënë t'i ndihmojmë fëmijët që i duam, të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim! Kur e bëjmë këtë gjë plot lutje, Zoti do të jetë me ne për t'i dhënë kësaj përvojë të parë të bërjes së besëlidhjes formën e një themeli të fuqishëm për rritje shpirtërore në të ardhmen. ■


*Dy faqet pasuese u japin përgjigje disa pyetjeve që kanë fëmijët rreth pagëzimit dhe konfirmimit.*

#### SHËNIM

1. Bojd K. Paker, “Teach the Children”, *Liahona*, maj 2000, f. 16.

## Të Kuptuarit e Pagëzimit

Nga Marisa Uidison  
Revistat e Kishës



### ***Kush do të më pagëzojë mua?***

Kushdo që ju pagëzon, duhet të mbajë priftërinë – fuqinë për të vepruar në emër të Perëndisë. Kur Jezusi donte të pagëzohej, Ai shkoi te Gjon Pagëzori, i cili kishte priftërinë (shih Mateu 3:13).

Personi që ju pagëzon, do të marrë leje nga peshkopi i juaj ose presidenti i degës suaj.



### ***A duhet të futem brenda nën ujë për t'u pagëzuar?***

Jezusi u pagëzua me anë të zhytjes, që do të thotë Ai shkoi tërësisht nën ujë dhe me të shpejtë doli jashtë përsëri (shih Mateu 3:16). Kjo është mënyra se si do të pagëzoheni. Të pagëzuarit në këtë mënyrë na kujton se ne po e lëmë prapa jetën tonë të vjetër dhe po fillojmë një jetë të re, të përkushtuar për t'i shërbyer Perëndisë dhe fëmijëve të Tij.




### ***Çfarë premtimesh bëj unë kur pagëzohem?***

Kur pagëzoheni, ju bëni një besëlidhje, ose një premtim të dyanshëm, me Atin Qiellor. Ju i premtoni Atij se do të bëni gjëra të caktuara dhe Ai premtun se do t'ju bekojë. Kjo besëlidhje përshkruhet në lutjet e sakramentit, të cilat thuhën çdo të diel (shih DeB 20:77–79). Ju premtoni:

- Ta kujtoni Jezu Krishtin.
- Të zbatoni urdhërimet e Tij.
- Të merrni mbi vete emrin e Krishtit, që do të thotë ta vendosni punën e Tij të parën në jetën tuaj dhe të bëni atë që Ai dëshiron, në vend të asaj që bota dëshiron.

Kur e mbani këtë premtim, Ati Qiellor premtun që Fryma e Shenjtë do të jetë me ju dhe që mëkatet tuaja do të falen.



### ***Kush Është Fryma e Shenjtë?***

Dhurata e Frymës së Shenjtë është një nga dhuratat më të çmuara të Atit Qiellor. Pagëzimi juaj me anë të ujit nuk është i plotë, deri sa burra që mbajnë Priftërinë Melkizedeke ju japin një bekim për të marrë Frymën e Shenjtë (shih Gjoni 3:5).

Fryma e Shenjtë është anëtar i Kreut-Perëndi. Ai dëshmon për Atin Qiellor e Jezu Krishtin dhe na ndihmon të dimë çfarë është e vërtetë. Ai na ndihmon të jemi shpirtërisht të fortë. Ai na paralajmëron për rrezikun. Ai na ndihmon të mësojmë. Fryma e Shenjtë mund të na ndihmojë të ndiejmë dashurinë e Perëndisë.

Kur konfirmoheni anëtar i Kishës, Fryma e Shenjtë mund të jetë gjithmonë me ju, në qoftë se zgjidhni të drejtën.



### ***Përse duhet të jem të paktën tetë vjeç për t'u pagëzuar?***

Zoti na mëson se fëmijët nuk duhet të pagëzohen, deri sa ata të jenë rritur mjaftueshëm për të kuptuar ndryshimin midis të drejtës dhe të gabuarës, moshë që shkrimet e shenjta thonë se është tetë vjeç (shih Moroni 8:11–12; DeB 29:46–47; 68:27).



**Nga Plaku  
Zhairo Mazagardi**  
I të Shtatëdhjetëve

# Të Tërhequr drejt Tempullit

*Për shumë njerëz të mirë, tempulli frymëzon ndjenja që mund ta përshkojnë menjëherë zemrën.*

**P**ërpara se të thirresha anëtar i Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve, bashkëshortja ime dhe unë kaluam disa vite duke shërbyer në tempujt e Kampinas dhe San-Paolos, në Brazil. Në të dy tempujt, unë shpesh u mahnita që njerëzit, të cilët udhëtonin pranë tempullit, tërhiqeshin kaq shumë nga ai sa ndalonin, hynin dhe pyesnin rreth tij.

Kur hynin, ne i vinim ata në dijeni se nuk mund të shkonin më tej pa përgatitjen e duhur. Ne atëherë u shpjegonim qëllimin e tempullit, ndanim disa nga doktrinat bazë të ungjillit dhe i ftonim të takoheshin me misionarët. Për shumë njerëz të mirë, tempulli vetë është një misionar i jashtëzakonshëm, sepse frymëzon ndjenja që mund ta përshkojnë menjëherë zemrën.

Gruaja ime, Elisabeta dhe unë e njohim drejtpërdrejt fuqinë e ndjenjave të tilla. Rreth 40 vjet më parë, një mik i mirë dhe koleg, një anëtar i Kishës, filloi të fliste me ne për ungjillin në biseda të rastësishme. Në disa raste, ai dërgoi misionarët të na vizitonin. Neve na pëlqyen misionarët dhe ramë dakord që t'i merrnim diskutimet, por nuk ishim vërtet të interesuar rreth asaj që ata kishin për të na mësuar.

Ajo ndryshoi në tetor 1978, kur kolegu im ftoi disa miq, përfshirë ne, në shtëpinë e hapur të tempullit të San-Paolos,



në Brazil. Ai mori disa autobusa me qira, me shpenzimet e tij, me qëllim që miqtë e tij të mund të takoheshin me të tek tempulli, rreth 80 km larg.

Kur Elisabeta hyri në pagëzore, ajo ndieu diçka që nuk e kishte përjetuar kurrë më parë, diçka që ajo më vonë e njohu si Fryma e Shenjtë. Ndjenja ishte një gëzim i madh në zemrën e saj. Ajo e diti në atë çast se Kisha ishte e vërtetë dhe se ajo ishte Kisha me të cilën donte të bashkohej.

Një ndjenjë e ngjashme më erdhi mua në fund të shtëpisë së hapur, kur ne u shoqëruam për në dhomën e vulosjes dhe mësuam doktrinën e familjeve të përjetshme. Ajo doktrinë më preku. Isha i suksesshëm në profesionin tim, por prej kohësh ndieja zbrazëti në shpirtin tim. Nuk e dija se çfarë mund ta mbushte atë boshllëk, por e ndieja se ishte diçka që kishte të bënte me familjen. Atje, në dhomën e vulosjes, gjërat filluan të vendosen në vendin e duhur në mendjen dhe zemrën time.

Pak ditë më vonë, misionarët u lidhën me ne përsëri. Këtë herë ne ishim shumë të interesuar që ta dëgjonim mesazhin e tyre.

Pleqtë [elderat] na nxitën të luteshim nga thellësia e zemrës për të vërtetën. Vendosa se kjo ishte e vetmja mënyrë se si *mund* të lutesha. E dija se nuk mund të merrja zotim për t'u bashkuar me Kishën pa pasur një dëshmi të vërtetë. Isha i shqetësuar që t'i drejtohesha Atit Qiellor për të kërkuar miratim prej Tij, por në të njëjtën kohë, isha i sigurt se Ai do të më përgjigjej. I tregova Atij dëshirat e thella të zemrës sime dhe i kërkova Atij të më jepte një përgjigje që do të më siguronte se bashkimi me Kishën ishte shtegu i duhur.

Javën që pasoi, në Shkollën e së Dieles, miku ynë, i cili na kishte ftuar për të shkuar

në shtëpinë e hapur të tempullit, u ul pranë meje. Ai u përkul drejt meje dhe filloi të më fliste. Fjalët që ai tha, iu përgjigjën saktësisht asaj për të cilën isha lutur të dija. Nuk pata asnjë dyshim se Ati Qiellor po më fliste nëpërmjet tij. Në atë kohë, unë isha një burrë i rreptë, i ashpër, por zemra ime u tret dhe fillova të qaj. Kur miku im kishte mbaruar, ai e ftoi bashkëshorten time dhe mua të pagëzoheshim. Ne pranuaam.

Më 31 tetor 1978, më pak se një muaj pas përvojës sonë në tempullin e San-Paolos, ne u pagëzuam dhe u konfirmuam. Të nesërmen, ne morëm pjesë në sesionin e dytë përkushtues të tempullit të San-Paolos, Brazil. Një vit më vonë, u kthyem në tempull me dy djemtë tanë për t'u vulosur si familje. Që të tre rastet ishin përvoja të bukura, mbresëlënëse. Ne kemi vazhduar t'i përjetësojmë ato ndjenja me adhurimin e rregullt në tempull gjatë viteve.

Në të njëjtën ditë, njëzet e tetë vjet mbas ditës së pagëzimit tonë, gruaja ime dhe unë qëndruam në tempullin e San-Paolos, Brazil. Sapo isha thirrur si president tempulli. Ishte një përvojë prekëse për ne që të ecnim nëpër korridoret e shtëpisë së Zotit dhe të ndienim përsëri ndjenjat prekëse që kishin qenë katalizatori i kthimit tonë në besim.

Tempulli vazhdon të na sjellë gruas sime dhe mua lumturi të madhe. Kur shohim një çift të ri duke hyrë në tempull për t'u vulosur si familje e përjetshme, ne ndiejmë shpresë të madhe.

Shumë njerëz nëpër botë janë të përgatitur ta dëgjojnë mesazhin e ungjillit. Ata ndiejnë një etje të ngjashme me atë që ndieva unë më shumë se 30 vjet më parë. Tempulli dhe ordinancat e tij janë të fuqishme, aq sa të mjaftojnë për ta shuar atë etje dhe për t'i mbushur zbrazëtite. ■

## DIÇKA NUK SHKONTE ME AVIONIN TIM

Një mbrëmje, ndërsa po e çoja avionin tim plot me pasagjerë për te pista e nisjes, pata një ndjenjë se diçka nuk shkonte me sistemin e drejtimit të avionit. Për ta pohuar përshtypjen time shpirtërore, e nxora avionin nga pista dhe bëra disa kthime 360-gradëshe. Çdo gjë dukej në rregull.

Vrava mendjen: “A duhet të nisem dhe t’i çoj pasagjerët në vendmbërritjen e tyre në kohë, apo duhet të kthehem te porta e nisjes?” E dija se kthimi do të krijonte një vonesë të gjatë. Pistas e nisjes janë me një drejtim. Do të më duhej të prisja që kontrolli në tokë të krijonte një hapësirë për mua që ta lëvizja avionin kundër rrymës së trafikut. Më pas do të na duhej të

prisnim që ekuipazhin i mirëmbajtjes ta kontrollonte aeroplanin. Vonesat mund të shkaktonin probleme për kompaninë ajrore dhe për pasagjerët që kishin njerëz për të takuar dhe linja të tjera avionësh për të marrë. Gjithashtu mendova se si do të reagoje departamenti i mirëmbajtjes ndaj raportit tim se aeroplani kishte një problem, kur s’kisha asgjë për ta vërtetuar përveçse një ndjenje të fortë.

Si kapiten i avionit, unë isha përgjegjës për sigurinë tonë, kështu që vendosa të ndjek ndjenjën që pata dhe të kthehem.

Kur arritëm te porta, i thashë mekanikut që ndieja se diçka nuk shkonte me aeroplanin, por nuk e

dija se cili ishte shqetësimi. Ai nuk besoi se kishte një problem.

“Është ndoshta thjesht pista e lagur”, tha ai. “Mund të kesh shkarë në asfalt.” Ai ra dakord, megjithatë, që t’i hidhte një sy ingranazhit drejtues në timonin e përparmë. Pasi e kontrollloi, më kërkoi t’i zbrisja pasagjerët që të mund ta merrte aeroplanin për një rrugë testimi.

Kur u kthye pas 30 minutash, ishte shumë i shqetësuar. Gjatë rrugës së testimit, ai kishte dëgjuar një tingull të mprehtë me ndërprerje. Kur i përdori frenat, ndërsa po kthehej për të ardhur përsëri te porta, e humbi kontrollin e aeroplanit dhe pothuajse doli jashtë pistës.

Një inspektim i hollësishtëm zbuloi se frenat nuk kishin pasur mirëmbajtjen e duhur një mbrëmje më parë. Po ta kisha ulur aeroplanin pas fluturimit tonë, frenat nuk do të kishin funksionuar dhe do ta kisha humbur kontrollin e aeroplanit.

Unë mora një avion tjetër për ta pilotuar dhe i zbrita pasagjerët të sigurt në vendmbërritjen e tyre tri orë më vonë.

Gëzohem që i dëgjova pëshpërimat e Shpirtit. E di se Shpirti do të na drejtojë, në qoftë se kërkojmë udhëheqjen e Zotit dhe i dëgjojmë nxitjet që vijnë. ■

Kreg Uilli, Juta, SHBA

Mendova se si do të reagoje departamenti i mirëmbajtjes ndaj raportit tim se aeroplani kishte një problem, kur s’kisha asgjë për ta vërtetuar përveç një ndjenje të fortë.



## GJETJA E GËZIMIT NË JETË

Në një rast unë po lexoja një bisedë të një konference të përgjithshme nga Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Edhe pse e kisha dëgjuar dhe lexuar këtë bisedë më përpara, një frazë ma tërhoqi vëmendjen dhe më ngeli në mendje.

Disa orë më vonë biri im, që jetonte në një apartament me shokët e tij, erdhi për vizitë. Ai kishte shërbyer një mision me kohë të plotë dhe kishte ndjekur pak semestra në kolegji. Nuk ishte i sigurt se çfarë drejtimi arsimor duhej të ndërmernte dhe çfarë udhe të karrierës duhej të vazhdonte. Ngaqë kishte qenë i mërzitur dhe ndiente se shkolla, për tani, ishte një humbje kohe dhe parash, ai i vuri studimet mënjanë dhe filloi të punonte me kohë të plotë.

Më tha se një nga shokët e tij kishte sugjeruar që të shkonin në një ishull në Bahamas ose në Karaibet, që të gjenin punë dhe të bënin qejf për pak muaj. Biri im ishte i emocionuar për mundësinë. Mund ta kuptojë lehtësisht se sa joshëse mund të ishte një përvojë e tillë, e shkujdesur për një të ri.

Pikërisht atëherë, më erdhi në mendje mesazhi që më kishte lënë mbresë nga Plaku Skot. Mora revistën *Ensign* dhe i lexova sa vijon birit tim: "Ju jeni këtu në tokë për një qëllim hyjnor. Nuk është që të argëtohem pafundësisht ose të jemi vazhdimisht në kërkim të plotë të kënaqësisë. Ju jeni këtu që të viheni në provë, ta provoni veten me qëllim që të mund të merrni bekimet shtesë që Perëndia ka për ju. Duhet efekti farkëtues i durimit" ("Finding

Joy in Life", *Ensign*, maj 1996, f. 25).

Pa asnjë fjalë, biri im e mori revistën, shkoi më tutje dhe e lexoi të gjithë bisedën. Më vonë, gjithçka që tha, ishte se ai nuk do ta ndërmernte aventurën e tij në ishull.

Me kohë, ai hyri në akademinë e policisë, një shteg që e çoi të takonte bashkëshorten e tij të ardhshme. Ata u martuan të tempullin e Mesës në Arizona dhe sot po rrisin tre fëmijë të mrekullueshëm. Në vitin 2010, biri im mbaroi universitetin dhe me të vërtetë "gjeti gëzim në jetë".

Aventura e propozuar e birit tim mund të kishte qenë një përvojë e

mirë; nga ana tjetër, mund të kishte qenë e rrezikshme shpirtërisht. Sa herë që mendoj për këtë përvojë, Shpirti ma prek zemrën.

Jam mirënjohëse për fjalët e profetëve dhe që u nxitën të kujtoja një bisedë që më ndihmoi të jepja udhërrëfim. Jam gjithashtu mirënjohëse që biri im e dëgjoi një lajmëtar të Zotit dhe e lejoj Shpirtin të ndikonte tek ai. E di se vijnë shumë bekime dhe mëshira të dhembshura, kur ne e dëgjojmë Shpëtimtarin dhe shërbëtorët e Tij dhe i ndjekim mësimet e tyre. ■

Karen Rokud, Ajdaho, SHBA



Kur biri im më tha se një nga shokët e tij kishte sugjeruar që të shkonin në Bahamas ose në Karaibet për të bërë qejf për pak muaj, më erdhi në mendje mesazhi i Plakut Skot.

# TELEFONI U MBYLL

Në mars 1997, ndërsa jetonim në qytetin rus të Rostov-mbi-Donit, bashkëshorti im dhe unë u pagëzuam në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Kur studioja doktrinat e Kishës, shumë prej pyetjeve të mia merrnin përgjigje. Ishte interesante të mësoja rreth planit të shpëtimit, përfshirë praktikën e pagëzimit për të vdekurit. U habita kur mësova se ne mund të pagëzoheshim për paraardhësit tanë në vdekur.

Një vit pas pagëzimit tonë, presidenti i misionit na ftoi të përgatiteshim për të shkuar në tempull. Si pjesë e përgatitjes sonë, ne filluam të bënim kërkim për historinë familjare. Një ditë kur po mendoja rreth bërjes së kësaj pune, ra telefoni. Ishte vjehrra ime. I kërkova nëse mund të më dërgonte një listë të paraardhësve të vdekur të familjes nga ana e bashkëshortit tim. Ajo u mahnit dhe më tha se pagëzimi për të vdekurit nuk ishte doktrinë e Krishtit, por më tepër diçka që e

kishin sajuar mormonët. Nuk isha e sigurt se si t'i përgjigjesha asaj, sepse nuk i dija referencat nga shkrimet e shenjta që e mbështetnin doktrinën.

Ndërsa po mendoja se si t'i përgjigjesha, telefoni u mbyll. Nuk isha e sigurt për një minutë se çfarë kishte ndodhur, por e ula telefonin dhe shkova në dhomën time të gjumit. Mora Dhiatën e Re në duart e mia, u ula në gjuhë për t'u lutur dhe i kërkova Atit Qiellor të më tregonte ku mund ta gjeja përgjigjen.

Në fund të lutjes sime, hapja Biblën. Ndieva sikur dikush të më kishte thënë të lexoja vargun 29-të në po atë faqe që kisha hapur. Isha në kapitullin e 15-ë të 1 Korintasve, që flet për doktrinën e pagëzimit për të vdekurit.

U preka dhe u habita që Ati Qiellor i ishte përgjigjur lutjes sime tamam në atë çast. Ishte një ndjenjë e mrekullueshme.

Po mendoja thellë rreth kësaj përvoje, kur papritur telefoni ra përsëri. Ishte vjehrra ime, duke më pyetur përse ishte mbyllur telefoni. I thashë se nuk e dija, por më pas i kërkova të hapte Biblën e saj dhe të lexonte 1 Korintasve 15:29.

Pak ditë më vonë, një listë të afërmish të vdekur ishte mbi tryezën time. Vjehrra ime e kishte lexuar shkrimin e shenjtë dhe tani besonte se Shpëtimtari, nëpërmjet apostullit Pal, na kishte mësuar doktrinën e pagëzimit për të vdekurit.

Perëndia u ka premtuar bekime të mëdha atyre që bëjnë këtë punë shëlbuese. E di se kjo është e vërtetë. ■

Seda Meliksetian, Armeni



Vjehrra ime më tha se pagëzimi për të vdekurit nuk ishte doktrinë e Krishtit, por më tepër diçka që e kishin sajuar mormonët.



## KU MUND TA GJEJ NJË REVISTË SI KJO?

Gjatë një udhëtimi me familjen time nga Nevada, SHBA, për në Alaska, SHBA, fillova një bisedë me një zonjë të gjatë, tërheqëse dhe miqësore, të ulur në anën tjetër të sediljeve.

Më pyeti se ku po shkoja dhe i thashë se ishim nisur për në Xhuno, Alaska, për të vizituar djalin tonë dhe familjen e tij. Më tha se ishte nga Las Vegas. Më pas, duke u mallëngjyer, ajo shtoi se po shkonte në Xhuno për të vizituar familjen e burrit të saj që të kishin një shërbesë përkujtimore për bashkëshortin e saj, me të cilin kishte qenë e martuar për 20 vjet. Ai kishte vdekur kohët e fundit nga kanceri.

Hodha sytë nga ana tjetër e ulëseve dhe mendova se sa me fat isha që e dija planin e shpëtimit dhe që isha punonjëse tempulli në tempullin e Las Vegasit në Nevada. Mendova se ç'mund të bëja për këtë grua, që t'i ngrija humorin.

Pa pritur, aq qartë sa tingulli i një këmbane, m'u kujtua një citim nga Profeti Jozef Smith që kisha shpërndarë në Shoqatën e Ndihmës. Kur organizoi Shoqatën e Ndihmës, ai vëzhgoi se motrat “do të fluturo[nin] në ndihmë të të huajit; ato do t'ia la[nin] me vaj dhe me verë zemrën e plagosur të pikëlluarit; do të tha[nin] lotët e jetimit dhe do ta bë[nin] të gëzojë zemrën e së vesë” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2007], f. 482).

E hodha edhe një herë vështrimin në anën tjetër të ulëseve. Pashë një të huaj në shqetësim, një të ve me një



Mendova se ç'mund të bëja për t'i ngritur humorin kësaj gruaje, bashkëshorti i së cilës kishte vdekur kohët e fundit.

zemër të plagosur. M'u kujtua se më herët, atë ditë, kisha lexuar *Ensign-in* e korrikut 2011. Përbante disa artikuj frymëzues, që mendova se mund t'i jepnin asaj pak inkurajim dhe ngushëllim.

Mora guxim, e hapa revistën te një artikull dhe i kërkova asaj ta lexonte. Po e vëreja nga afër dhe u habita që ajo i lexoi vargjet një e nga një – plot qëllim. Kur e mbaroi, ajo lexoi një artikull tjetër.

Në mënyrë të dukshme diçka që kishte lexuar, e preku në zemër. E përqafoi fort revistën në kraharor

dhe pastaj fshiu një lot nga syri.

“Ku mund ta gjej një revistë si kjo?” më pyeti ajo. I thashë se mund ta mbante. Atëherë ajo lexoi më shumë.

Kur arritëm në Xhuno, ajo ma kapi dorën, më pa drejt e në sy dhe tha: “Faleminderit”.

Pata një mësim të madh nga ajo përvojë. Ne rretohemi nga të huaj me zemra të plagosura, të cilëve u nevojitet një fjalë e mirë inkurajimi dhe të cilët kanë nevojë të dinë atë që ne, si shenjtore të ditëve të mëvonshme, e dimë. ■

Sherën Rejthër, Nevada, SHBA

*Nganjëherë duhet të heqësh dorë nga diçka e mirë për diçka më të mirë.*

# ZGJEDHJA E PJESËS më të Mirë

**Nga Methju D. Fliton**

Revistat e Kishës

**Z**oltan Syçi nga Seged, Hungari, e habiti trajnerin e tij në sportin e kajakut duke i thënë se nuk do të shkonte në Gjermani për një garë.

“Ishte në të njëjtën ditë me pagëzimin tim, kështu që thashë jo”, tha Zoltani.

Në moshën 17-vjeçare, Zoltani kishte fituar shumë gara në sportin e kajakut. Ai është një sport mjaft i përhapur në Hungari dhe Zoltani ishte i mirë – aq i mirë sa bërja profesionist ishte një mundësi e vërtetë. Përveç vendimit për të mos shkuar në një garë, Zoltani shpejt do të hiqte dorë nga sporti i kajakut tërësisht. Ai kishte diçka më të mirë për të bërë.

Sporti i kajakut kishte qenë diçka e mirë për Zoltanin. Gjatë viteve që kishte punuar me trajnerin e tij, ai kishte mësuar vetëkontroll, bindje dhe të punonte shumë. Zoltani gjithashtu kishte mësuar se si t’i shmangte lëndët dhe zakonet që mund ta dëmtonin arritjen e tij. Nuk ishte një jetë e lehtë; ishte e vetmuar dhe bërja profesionist do të zinte më shumë kohë. Profesionistët praktikojnë 12 orë në ditë dhe duhet të konkurrojnë të dielën.

“Sporti i kajakut më zuri shumicën e kohës time”, tha Zoltani. “Isha shumë i zellshëm. Për shkak të saj, lashë shumë gjëra jashtë jetës sime.”

Kjo ishte arsyeja përse Zoltani vendosi që nuk mund t’ia kushtonte veten si ungjillit, ashtu edhe sportit të kajakut. Në 2004 ai i tha trajnerit të tij se nuk do të shkonte më me kajak.

Në fillim të atij viti, misionarët filluan t’i jepnin mësimet nënës së Zoltanit. Ai nuk mori pjesë në mësimet. E pranoi pa qejf ftesën e nënës së tij për një pagëzimin e saj. Por zemra e tij u prek nga ajo që ndieu, sapo u fut në ndërtesën e kishës. Zoltani ra dakord të takohej me misionarët, pjesërisht sepse mund të krahasohej me ta.

“Misionarët ishin interesantë për mua, sepse ishin njerëz normalë, por jetonin një standard më të lartë”, tha ai.

Për shkak të standardit më të lartë që Zoltani po jetonte tashmë si sportist kajaku, ai i pranoi me gatishmëri si të vlefshme mësimet e ungjillit. Ai u pagëzua dy muaj më vonë.

Në fillim mendoi se mund ta vazhdonte sportin e kajakut, por të mos bënte gara të dielave. Por, ngaqë ai ishte lloji i njeriut që, kur zotohej ndaj një aktiviteti ose kursi,

dëshironte të dilte me sukses në të, ai zgjodhi të hiqte dorë nga sporti tërësisht.

E provoi njëherë të shkonte me kajak si hobi pas pagëzimit. Kur e bëri, trajneri i tij i kërkoi ta ndihmonte atë duke u dhënë mësim të tjerëve dhe duke organizuar udhëtime, meqë ai nuk do të konkurronte. Por ai nuk donte të bënte zotime ndaj sportit të kajakut – ose ndonjë aktiviteti tjetër – që mund t’i dilte pengesë në rrugën e tij të qenies dishepull.

Kështu Zoltani e la sportin e kajakut dhe ia përkushtoi veten shërbimit në Kishë, në një vendim të ngjashëm me atë që bëri Presidentit Huard W. Hanter (1907–1995) kur u martua. Presidenti Hanter ishte një muzikant i përkryer, i cili luante shumë vegla muzikore. Mbrëmjeve kishte luajtur në një orkestër, por mënyra e jetesës së atyre me të cilët shoqërohej, binte ndesh me standardet e ungjillit. Kështu Presidenti Hanter i la mënjandë veglat e tij muzikore dhe i nxirrte vetëm në rastet kur këndonin si familje.<sup>1</sup>

Zoltanin e merr malli për sportin e kajakut, por ai e kuptoi se dashuria e tij për kajakun ishte mjaft e fortë sa të ndeshet me, dhe ndoshta ta mposhte,



*Zoltan Syç nga Seged, Hungari hoqi dorë nga sporti i kajakut për të pasur më shumë kohë për ungjillin.*



dashurinë e tij për Zotin, nëse ai do të qëndronte pranë sportit.

I njëjti parim mund të zbatohet me çdo aktivitet që na largon nga ai njeri që Perëndia na dëshiron të jemi. Për secilin prej nesh mund të jetë më mirë ta kalojmë jetën pa disa gjëra – edhe nëse ato janë gjëra të mira – se sa të rrezikojmë jetën tonë të përjetshme për t'i pasur ato.

“Kisha u bë jeta ime”, thotë Zoltani. “Duke e ditur se sporti i kajakut nuk mund të ishte jetesë, në qoftë se doja të isha aktiv dhe se do të ishte thjesht një hobi, u bë e lehtë të hiqja dorë. Në vend të tij, doja ta bëja Atin Qiellor përqendrimin tim.”

Zoltani filloi ta studionte ungjillin me të njëjtën fuqi që i kushton çdo aktiviteti. Ai caktoi si qëllim të shërbente në një mision. Donte të qëndronte në vendin e tij dhe të mësonte të tjerët.

Ai shërbeu në Hungari dhe tani punon si mësues i gjuhës angleze në një shkollë të mesme. Ai vazhdon t'i vendosë përparësitë e tij duke u bazuar tek ungjilli. “Ka gjëra nga të cilat na duhet të heqim dorë, sepse ato na bëhen pengesë në rrugën e Perëndisë”, thotë ai. “Është e lehtë të heqësh dorë nga e liga, kur e di se duhet. Shpesh nuk e kuptojmë se kur duhet të heqim dorë nga diçka e mirë për diçka më të mirë. Ne mendojmë se, ngaqë nuk është e keqe, ne mund të mbahemi tek ajo dhe prapëseprapë të vazhdojmë të ndjekim planin e Perëndisë.” Por Zoltani e dinte se ne duhet të heqim dorë nga e mira, në qoftë se ajo na mban larg nga ndjekja e planit të Perëndisë për ne. ■

#### SHËNIM

1. Shih Eleanor Knowles, *Howard W. Hunter* (1994), f. 81.

## “Si t’ia shpjegoj mikut tim se të thyesh ligjin e dëlirësisë është një ide e gabuar?”

**A**ti Qiellor na do të jemi të lumtur dhe të denjë për Shpirtin e Shenjtë, prandaj Ai na jep urdhëtime për të na ndihmuar t’i mbajmë mendimet, fjalët dhe veprimet tona brenda kufijve të duhur. Ligji i dëlirësisë na ndihmon ta ruajmë fuqinë e krijimit të jetës brenda lidhjeve të martesës. Një arsye pse Ai urdhëron që fuqia e krijimit të jetës të shprehet vetëm midis bashkëshortit dhe bashkëshortes, është ngaqë “fëmijët kanë të drejtën të lindin brenda lidhjeve të martesës”<sup>1</sup>.

Ju mund të ndani një kopje të broshurës *Për Forcën e Rinisë* me shokun ose shoqen tuaj. Ajo jep disa arsye përse është e mirë të mbahet ligji i dëlirësisë: “Kur jeni seksualisht të pastër, ju e përgatisni veten për të bërë dhe mbajtur besëlidhjet e shenjta në tempull. Ju e përgatisni veten për të ndërtuar një martesë të fortë dhe për të sjellë në botë fëmijë si pjesë e një familjeje të përjetshme dhe të dashur. Ju mbrohni nga dëmet shpirtërore dhe emocionale që vijnë nga ndarja e intimitetit seksual jashtë martesës. Ju gjithashtu e mbron veten nga sëmundjet e dëmshme. Të qëndruarit të pastër seksualisht ju ndihmon të jeni të sigurt e vërtet të lumtur dhe rrit aftësinë tuaj për të marrë vendime të duhura tani dhe në të ardhmen.”<sup>2</sup>

### Tempulli



Ati ynë Qiellor ka qëllim hyjnor për të gjithë ne dhe ai qëllim mund të përmbushet në tempull. Ne duhet të jemi të denjë për të hyrë në tempull, në mënyrë që familjet tona të mund të vulojnë përgjithmonë. Ne do të jetojmë me

Atin tonë Qiellor përsëri dhe, më e rëndësishmja, ne do të kemi një gëzim të pafundëm, të cilin nuk mund ta kenë të padenjë.

*Alofa M., moshë 18 vjeç, Samoa*

### Martesa dhe Familja



Ne nxitemi të jemi të pastër seksualisht, me qëllim që të mund të jemi të denjë për të hyrë në tempull dhe për të

mbajtur besëlidhje të shenjta. Nëse e ndjekim ligjin e dëlirësisë, ne mund të ngremë një martesë dhe familje të fortë në të ardhmen. Satani gjithmonë gjendet që të na tundojë, por nëpërmjet lutjes, shkrimeve të shenjta dhe miqve të mirë, ne mund ta mposhtim atë.

*Resti M., moshë 16 vjeç, Filipinet*

### Pasoja Negative

Ka shumë pasoja negative kur thyhet ligji i dëlirësisë, por ju nuk mësoni për të gjitha ato në klasën e shëndetit. Thyerja e ligjit të dëlirësisë mund ta largojë Shpirtin nga jeta juaj, mund t’i lëndojë ata që ndodhen pranë jush dhe mund t’ju bëjë të ndiheni keq rreth vetes suaj. Ju sugjeroj të shihni një video në Mesazhet Mormone, të quajtur “Dëlirësia: Cilat Janë Kufijtë?” [në [youth.lds.org](http://youth.lds.org) në anglisht, portugalisht dhe spanjisht].

*Methju T., moshë 17 vjeç, Jutë, SHBA*

### Pastërtia dhe Respekti

Duke ndjekur ligjin e dëlirësisë, ne mbetemi të pastër në sytë e Perëndisë, ne e respektojmë veten tonë dhe i ndihmojmë të tjerët të na respektojnë ne gjithashtu. Nëse i bindemi ligjit të dëlirësisë, ne tregojmë se jemi fëmijë të Perëndisë dhe se mbështesim standarde të larta. Ne do t’i shmangim keqardhjet. Kur i bindemi Atit tonë Qiellor, veçanërisht lidhur me këtë ligj, jeta jonë do të jetë më e lumtur këtu në tokë dhe në botën që vjen.

*Aliana G., moshë 19 vjeç, Filipinet*

## Një Dhuratë e Shenjtë

Në qoftë se dhurata e krijimit të jetës merret me shkujdesje, kjo dhuratë e çmuar nga Perëndia do të trajtohej si diçka e zakonshme. Dhënia e një dhurate nuk duket shpërblyese, në qoftë se njeriu të cilit ia dhatë atë, nuk mendon se ajo është e veçantë. Gjithmonë duhet ta trajtojmë krijimin e jetës me shenjtëri; sepse ne të gjithë jemi tempuj të Perëndisë dhe duhet të qëndrojmë të pastër dhe të dëlirë si një tempull.

*Xhejren Z., moshë 15 vjeç, Ajdaho, SHBA*

## Shpirti me Ne



Kur qëndroni të pastër nga mëkati, do të jeni shumë më të lumtur dhe do të bekoheni. Trupat tanë janë si

tempujt dhe Ati Qiellor “nuk jeton në tempuj që nuk janë të shenjtë” (Alma 7:21). Prandaj kur qëndrojmë të pastër nga mëkati, Shpirti mund të banojë me ne.

*Marian P., moshë 14 vjeç, Arkansas, SHBA*

## Pyetje të Rëndësishme

I jepni përgjigje pyetjes së shokut tuaj duke bërë disa pyetje: “Po sikur bashkëshortja jote e ardhshme të të shihte tani?” Të gjithë njerëzve për të cilët kam dëgjuar, që e kanë thyer ligjin e dëlirësisë, iu ka ardhur keq që e bënë atë. “Po sikur fëmija juaj i ardhshëm t’ju pyesë nëse e keni thyer ligjin e dëlirësisë?” Shoku juaj ka nevojë të mësojë se sa i rëndësishëm është tani ligji i dëlirësisë, përpara se një bir ose një bijë ta bëjë atë pyetje. Ju duhet ta mbani veten të pastër dhe të dëlirë që të gëzoni një jetë të lumtur, të shëndetshme, pa ndjenjën e fajit për thyerjen e ligjit të shenjtë.

*Robin K., moshë 13 vjeç, Juta, SHBA*

## Virtyti dhe Dëlirësia



Zoti gëzohet në virtytin dhe dëlirësinë dhe gjithçka duhet të ndodhë në kohën e saj të duhur.

Ligji i dëlirësisë është një urdhërim nga Zoti. Lutja dhe shoqërimi i Shpirtit janë kombinimi i përsosur për të ditur se të jesh i dëlirë është një bekim.

*Selena R., moshë 18 vjeç, Nikaragua*

## Brenda Martesës

Unë do t’i shpjegoja shokut tim se shkelja e ligjit të dëlirësisë është një ide e keqe, sepse fuqia e krijimit të jetës është bërë vetëm për çiftet e martuara ligjërisht. Kur e shkelim ligjin e dëlirësisë, ne e humbasim Frymën e Shenjtë në jetën tonë.

*Agustina A., moshë 15 vjeç, Gana*

### SHËNIME

1. “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
2. *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 35.



## THYERJA E LIGJIT TË DËLIRËSISË SHKAKTON DËM TË RËNDË

“Brenda besëlidhjes së qëndrueshme të martesës, Zoti u lejon bashkëshortit dhe bashkëshortes shprehjen e fuqive të shenjtë të krijimit të jetës, në të gjithë bukurinë dhe kënaqësinë e tyre, brenda kufijve që Ai ka caktuar. . . .

Megjithatë, këto akte intime ndalohen nga Zoti jashtë zotimit të qëndrueshëm të martesës, sepse ato i shkatërrojnë qëllimet e Tij. Brenda besëlidhjes së shenjtë të martesës, të tilla marrëdhënie janë sipas planit të Tij. Kur përjetohen në ndonjë mënyrë tjetër, ato janë kundër vullnetit të Tij. Ato shkaktojnë dëm të rëndë emocional dhe shpirtëror. Edhe pse pjesëmarrësit nuk e kuptojnë atë që po ndodh tani, ata do ta kuptojnë më vonë. Imoraliteti seksual krijon një pengesë ndaj ndikimit të Shpirtit të Shenjtë.”

**Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Making the Right Choices”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 38.**

## PYETJA PASUESE

“Çfarë duhet të bëj kur një temë hapet në shkollë, e cila është në kundërshtim me mësimet e ungjillit, e tillë si aborti?”

Dërgojeni përgjigjen tuaj para 15 majit tek [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org) ose me postë tek:

*Liahona*, Questions & Answers 5/13  
50 E. North Temple St., Rm. 2420  
Salt Lake City, UT 84150-0024, USA

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

Informacioni dhe leja e mëposhtme duhet të përfshihen në postimin elektronik apo letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjia ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.



Nga Presidenti  
Tomas S. Monson

# SI TË SHËRBENI NË THIRRRJET E PRIFTËRISË

**A**keni menduar ndonjëherë thellë për vlerën e një shpirti njerëzor? A e keni vrarë mendjen ndonjëherë lidhur me **potencialin** që ndodhet brenda secilit prej nesh?

Një herë ndodhesha në një konferencë kunji, ku presidenti im i mëparshëm i kunjtit Pol C. Çajlld u kthye tek Doktrina e Besëlidhje 18 dhe filloi të lexonte: “Kujtoni që **vlera e shpirtave** është e madhe në sytë e Perëndisë” (vargu 10).

Presidenti Çajlld atëherë pyeti: “Cila është vlera e një shpirti njerëzor?” Ai shmangu thirrjen e një peshkopi, presidenti kunji apo këshilltari të lartë për një përgjigje. Në vend të saj, ai zgjodhi presidentin e një kuorumi pleqsh.

Burri, i zënë në befasi, qëndroi i heshtur për çka u duk si përjetësi dhe më pas shpalli: “Vlera e një shpirti njerëzor është **aftësia e tij për t’u bërë si Perëndia**”.

Të gjithë të pranishmit e menduan thellë atë përgjigje. Presidenti Çajlld vijoi me mesazhin e tij, por unë

vazhdova të reflektoja rreth asaj përgjigjeje të frymëzuar.

**T’i ndikojmë, t’i mësojmë, t’i prekim** shpirtat e çmuar, të cilët Ati ynë i ka përgatitur për mesazhin e Tij, është një detyrë madhështore. Suksesi rrallëherë është i thjeshtë. Në përgjithësi paraprihet nga **lotë, sprova, besim dhe dëshmi**.

Shërbëtorët e Perëndisë gjejnë ngushëllim nga siguria e Mësuesit: “Unë jam me ju gjithë ditët” (Mateu 28:20). Ky premtim i madhërisëm ju mbështet ju, vëllezër të Priftërisë Aarone, të cilët u thirrët në detyra udhëheqjeje në kuorumet e dhjakëve, mësuesve dhe priftërinjve. Ju nxit në përgatitjet tuaja për të shërbyer në fushën e misionit. Ju ngushëllon gjatë atyre çasteve të humbjes së kurajës, që vijnë tek të gjithë.

“Prandaj, **mos u lodhni së bëri mirë**”, thotë Zoti, “sepse ju po ngrini themelin e një vepre të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe.

Vini re, Zoti kërkon zemrën dhe një mendje të gatshme” (DeB 64:33–34). **Një besim i palëkundur, një mirëbesim i vazhdueshëm dhe një dëshirë e përzemërt** gjithmonë i kanë karakterizuar ata që i shërbejnë Zotit me gjithë zemër.

Nëse ndonjë nga vëllezërit, brenda tingullit të zërit tim, ndihet i papërgatitur, madje i paafte që t’i përgjigjet një thirrjeje për të shërbyer, për të sakrifikuar, për të bekuar jetën e të tjerëve, kujtoni të vërtetën: **“Atë që Perëndia e thërret, Perëndia e kualifikon”**. ■

*Nga një bisedë në konferencën e përgjithshme të prillit 1987*

## SI E KENI ZBATUAR KËTË?

“Dija se Zoti është në anën time më ndihmon të kujtoj përsë po shkoj në mision: për t’i shërbyer Zotit dhe për të sjellë të tjerë te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. Unë e di se Ai nuk do të më bëjë të përjetoj ndonjë gjë që nuk mund t’i bëj ballë, ndërkohë që jam në mision.”

**Dilan M.,  
Juta, SHBA**



FOTOILUSTRIM NGA CODY BELL © IRI

## KËSHILLOHUNI ME ZOTIN

**K**ur isha 15 vjeç, më pëlqente një vajzë në klasën time në shkollë dhe doja të dilja në takime me të. Ajo ishte tërheqëse, por mendova nëse duhej t'i kërkoja të dilnim së bashku përpara se të mbushja 16 vjeç. M'u kujtua Alma 37:37, "Këshillohu me Zotin për të gjitha veprimet e tua dhe ai do të të drejtojë për të mirë". Prandaj kjo ishte ajo çka bëra. U luta dhe prita disa ditë për përgjigjen e Zotit përpara se të merrja një vendim.

Një ditë në kishë, peshkopi im më thirri në një dhomë dhe më ftoi të flisja të dielën e ardhshme. A e gjeni dot se cila ishte tema? Mos dilni në takime derisa të mbushni të paktën 16 vjeç. E ndieva se ajo ishte përgjigja e Zotit për mua dhe ishte jo. Si do të mund t'u mësoja diçka që nuk e praktikojta?


Ngaqë isha këshilluar me Zotin, unë isha në gjendje të mësoja vullnetin e Zotit për jetën time dhe gjithashtu t'i shpëtoja tundimit. E di se, në qoftë se këshillohemi me Zotin, Ai do të na e tregojë vullnetin e Tij dhe ne do të bekohemi shumë.

Eduardo Oliveira, Seara, Brazil

## SHKRIMI IM I SHENJTË I PARAPËLQYER DOKTRINA E BESËLIDHJE 24:8

Ky shkrim i shenjtë më bën të ndihem mirë, kur jam duke kaluar përmes një sprove, sepse thotë: "Unë jam me ty, madje deri në mbarim të ditëve të tua". Kjo do të thotë për mua se, në qoftë se unë e kërkoj Atë, Ati Qiellor gjithmonë do të jetë me mua deri në mbarim të jetës sime.

Aleks Ortiz, Nuevo Kasas Grandes, Meksikë



## FUQIA E SHLYERJES


**K**ur misionarët më dhanë mësim, temat kryesore të mësimëve të tyre ishin gjithmonë Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij. Ata shpjeguan se Shlyerja është një dhuratë nga Jezu Krishti për secilin prej nesh. Ajo është një dhuratë që mund ta përdorim në jetën tonë të përditshme, kur ne përballemi me sfida ose kur mëkatojmë. Fuqia e Shlyerjes na ngre shpirtërisht, na shëron dhe na ndihmon të kthehemi në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar, që çon drejt jetës së përvetshme.

Kur misionarët e treguan këtë, pata një ndjenjë të fortë që më dëshmoi se ishte e vërtetë dhe vendosa të bashkohem me Kishën.

Më vonë vendosa të shërbej në një mision, sepse unë doja t'i ndihmoja të tjerët të dinin rreth kësaj dhurate të mrekullueshme. Duke i mësuar dhe duke folur rreth Shlyerjes, unë kam parë të tjerë të ndryshojnë në një mënyrë të re jete. Një ndryshim tërësor erdhi, jo thjesht duke dëgjuar rreth Shlyerjes, por duke e zbatuar atë në jetën time gjithashtu.

Unë e di se Shlyerja është e vërtetë. Kur e ftojme ndikimin e saj në jetën tonë, pavarësisht nga rrethanat që hasim, gjithçka mund të rregullohet dhe ne do të ndiejmë vërtetë gëzim.

loriti Taburuea, Kiribati





Bibla e Shenjtë



Libri i Mormomit

PËRSE NA NEVOJITET

# LIBRI I MORMONIT

**D**isa njerëz mund t'ju pyesin përse na nevojitet Libri i Mormomit, kur ne tashmë e kemi Biblën. Në fakt, Jezu Krishti dëshmoi se kjo do të ndodhte (shih 2 Nefi 29:3). Ka shumë arsye përse Libri i Mormomit është i rëndësishëm në jetën tonë (për shembull, shih 2 Nefi 29:7–11). Këto janë vetëm pak arsye përse ai është thelbësor.

## Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit

Shkrimet e shenjta na tregojnë një model të përdorimit të dëshmitarëve të shumtë për të themeluar të vërtetën në Kishën e Krishtit. Libri i Mormomit i shton një dëshmitar të dytë Biblës si një dëshmi për Krishtin. Plaku Mark E. Petersen (1900–1984), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dikur tha:



### DY DËSHMITARË

“Bibla është njëri dëshmitar i Jezu Krishtit; Libri i Mormomit është tjetri. Përse ky dëshmitar i dytë është kaq vendimtar?”

Shembulli i mëposhtëm pamor mund të ndihmojë: Sa vija të drejta mund të vizatoni duke u nisur nga një pikë e vetme në një letër? Përgjigjja është një numër të pafund. Mendoni për një çast se pika e vetme përfaqëson Biblën dhe ato qindra vija të drejta të vizatuara nga ajo pikë përfaqësojnë interpretimet e ndryshme të Biblës dhe se secili nga ato interpretime përfaqëson një kishë të ndryshme.

Mirëpo çfarë ndodh, nëse në atë letër, ka një pikë të dytë që përfaqëson Librin e Mormomit? Sa vija të drejta mund të vizatoni midis këtyre pikave të referimit: Biblës dhe Librit të Mormomit? Vetëm një. Vetëm një interpretim i doktrinave të Krishtit mund të ekzistojë me dëshminë e këtyre dy dëshmitarëve.


Libri i Mormomit vepron vazhdimisht si një dëshmitar vërtetues, qartësues e bashkues i doktrinave që mësohen në Bibël.”

**Plaku Ted R. Kelister, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, “Libri i Mormomit – një Libër nga Perëndia”, Liahona, nëntor 2011, f. 75.**





## LIDHJA NË BASHKËBISEDIM



**G**jatë prillit ju do të studioni rreth Braktisjes dhe Rivendosjes në klasat tuaja në kuorimet e priftërisë, në Të Rejat dhe në Shkollën e së Dieles (nëse lagjja ose dega juaj i ka mësimet e reja në gjuhën tuaj). Dalja në dritë e Librit të Mormorit ishte një pjesë e rëndësishme e Rivendosjes. Pasi ta lexoni këtë artikull, mendoni se si ka ndryshuar jeta juaj ngaqë ju e keni Librin e Mormorit. Ju mund t'i shkruani ndjenjat tuaja në ditar dhe mbani parasysh që t'i ndani ato me të tjerët duke dëshmuar në shtëpi, në kishë ose në mediat shoqërore.

“Arsyeja kryesore që e kemi Librin e Mormorit, është që në gojën e dy ose tre dëshmitarëve do të qëndrojnë të gjitha gjërat. (Shih 2 Korintasve 13:1.) Ne kemi Biblën; ne gjithashtu kemi Librin e Mormorit. Ata përbëjnë dy zëra – dy vëllime shkrimesh të shenjtë – nga dy popuj të lashtë gjerësisht të veçuar, që të dy duke dhënë dëshmi për hyjninë e Zotit Jezu Krisht.”<sup>1</sup> Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) ka shtuar: “Nuk duhet të harrojmë se Zoti Vetë e dha Librin e Mormorit si dëshmitarin e Tij kryesor”<sup>2</sup>.

### Plotësia e Ungjillit

Ne e dimë se “gjërat e qarta dhe të çmueshme . . . janë hequr prej” Biblës gjatë historisë (1 Nefi 13:40). Libri i Mormorit e qartëson doktrinën e Krishtit dhe sjell plotësinë e ungjillit në tokë përsëri (shih 1 Nefi 13:38–41). Për shembull, Libri i Mormorit na ndihmon të dimë se pagëzimi duhet të kryhet me anë të zhytjes (shih 3 Nefi 11:26) dhe se fëmijët e vegjël nuk kanë nevojë të pagëzohen (shih Moroni 8:4–26).

### Qendror për Kishën e Rivendosur

Jozef Smithi dëshmoi se Libri i Mormorit është “gurthemeli i besimit tonë”<sup>3</sup>. Ngaqë e dimë këtë, nuk duket rastësi që Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u krijua më 6 prill 1830, vetëm 11 ditë pasi Libri i Mormorit u vu në dispozicion për herë të parë për shitje në

publik më 26 mars 1830. Kisha nuk u organizua derisa shkrimi gurthemel i shenjtë ishte në dispozicion të anëtarëve të saj.

### Një Bekim në Jetën Tonë

Lidhur me Librin e Mormorit, Jozef Smithi tha se “një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër”<sup>4</sup>. Ka fuqinë për të ndryshuar jetë – përfshirë tuajën dhe jetën e atyre me të cilët e ndani Librin e Mormorit. Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë i Presidencës së Parë, ka dëshmuar: “Efekti i Librit të Mormorit në karakterin, fuqinë dhe guximin tuaj për të qenë dëshmitar i Perëndisë është i sigurt. Doktrina dhe shembujt e guximshëm në atë libër do t’ju lartësojnë, udhëzojnë dhe do t’ju japin guxim. . . . Studimi me lutje i Librit të Mormorit do të ndërtojë besim në Perëndinë, Atin, në Birin e Tij të Dashur dhe në ungjillin e Tij. Ai do të ndërtojë besimin tuaj te profetët e Perëndisë, të lashtët dhe të kohës sonë. . . . Ai mund t’ju afrojë më shumë me Perëndinë se çdo libër tjetër. Ai mund ta ndryshojë jetën për më mirë.”<sup>5</sup>

#### SHËNIME

1. Mark E. Petersen, “Evidence of Things Not Seen”, *Ensign*, maj 1978, f. 63.
2. *The Teachings of Ezra Taft Benson* (1988), f. 204.
3. Jozef Smith, në parathënien e Librit të Mormorit.
4. Jozef Smith, në parathënien e Librit të Mormorit.
5. Henri B. Ajring, “Një Dëshmi”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 69–71.



**RRITJE NË  
TOKË PJELLORE:  
TË RINJTË BESNIKË NË**

Nga Sindi Smith

# UGANDË



Ndërsa pranojnë dhe jetojnë ungjillin e Jezu Krishtit, të rinjtë në Ugandë po i shohin besimin dhe shpresën të rriten kudo përreth tyre.

**N**ë zemër të Afrikës Lindore, vendi i bukur i Ugandës është bekuar me kodra të valëzuara me kallamë sheqeri dhe pemë bananesh – dhe me të rinj gati për të pranuar dhe jetuar ungjillin e Jezu Krishtit.

Kunji i parë në Ugandë u organizua në 2010. Kisha po rritet me shpejtësi, me shumë të rinj dhe të reja në secilën lagje dhe degë.

### **Ngritja e një Flamuri, të Qenit një Shembull**

Të rejat në një lagje u frymëzuan nga mësimet e motrës Elen S. Dalton, presidente e përgjithshme e Të Rejave, lidhur me virtytin: “Tani është koha që secila prej nesh të ngrihet e t’i shpallësh botës një flamur, duke bërë thirrje për kthim tek virtyti”<sup>1</sup>. Të rejat iu ngjitën një kodre që shihte mbi qytet dhe ngritën flamuj ngjyrë ari, duke simbolizuar betimin e tyre që të ishin shembuj të virtytit. Së bashku ato kënduan “Lart në Majën e Malit” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30).

Këto të reja kanë ngritur standardet e tyre personale të drejtësisë. Bindja e tyre i ka forcuar dëshmitë e tyre dhe ka ndikuar tek të tjerët. Motra Dalton ka thënë: “Kurrë mos e nënvleftësoni fuqinë e ndikimit tuaj të drejtë”<sup>2</sup>. Dhe si një flamur, shembulli i këtyre të rejave ngjatjeton gjithë botën.

Si shumë të reja në Ugandë, Sandra ecën më shumë se 1,6 km për në

kishë, ndihmon në pastrimin e shtëpisë së mbledhjes të premtëve dhe ndjek seminarin të shtunave. Gjatë javës, ajo ngrihet para orës 5:00 të mëngjesit për të lexuar librat e shkollës dhe më pas ecën për në shkollë, duke u kthyer në shtëpi pas orës 6:00 të pasdites. Ajo humbi një vit shkollor për shkak të vështirësive financiare, por i përballon sfidat e saj me një qëndrim pozitiv: “Ungjilli më ka ndihmuar vërtet të qëndroj e patundur dhe e palëvizur”.

Sandra është e vetmja anëtare e Kishës në shtëpinë e saj, por prindërit e saj e mbështesin shërbimin e saj në Kishë, në mënyrë të tillë si duke

Sandra

FOTOGRAFI NGA CHRISTINA SMITH





**Në krye:** Të rinjtë ndjekin së bashku një mbledhje rreth vatrës së kishës.

**Lart:** Suzana (qendër), një refugjate në Ugandë, gjeti paqe në ungjill dhe solli vëllezërit, motrat e saj dhe fëmijë të tjerë në kishë.

**Qendër:** Të reja të kësaj lagjeje gëzohen duke punuar për Përparimin Personal.

**Djathtas:** Denisi hoqi dorë nga një vend në skuadrën profesionale të futbollit për të predikuar ungjillin. Ai dhe të rinjtë të tjerë në kuorumin e tij të priftërinjve sakrifkuan dhe kapërcyen sfida për të shërbyer misionet.

ndihmuar kur lagjja pastroi vendin përreth një jetimoreje lokale. Familja e saj e kupton se si ungjilli e ka ndihmuar atë të jetë e fortë, edhe kur përballet me probleme të pazgjdhura. Duke reflektuar rreth burimit të asaj force, Sandra thotë: “Kur shkoj në kishë, ndihem sikur kam veshur armatimin e Perëndisë” (shih Efesianëve 6:11–17).

Një e kthyer në besim më e fundit, Suzana, e do Kishën. Me origjinë nga Sudani Jugor, familja e saj u

largua nga vështirësitë dhe u bekua t’i takonte misionarët në Ugandë. Si refugjate, ajo gjeti paqe dhe mbrojtje në ungjillin. Të dielave ajo do t’i sillte motrat dhe vëllezërit e saj më të vegjël në kishë, së bashku me deri në 10 fëmijë të tjerë që nuk ishin anëtarë të Kishës. Pas vdekjes së papritur të një anëtari të familjes, ajo u kthye në Sudanin Jugor, ku pret për Kishën që të ngrihet në zonën e saj. Suzana dhe Sandra, që të dyja, përballeshin me sfida, por ato mbështeteshin te Perëndia dhe gëzojnë frytet e të jetuarit të ungjillit të Jezu Krishtit (shih Alma 32:6–8, 43).

### **Sakrifkimi për të Shërbyer një Mision**

Të rinjtë në Ugandë fillojnë të luajnë futboll kur janë djem të vegjël, duke përdorur si top degë të lidhura fort. Që kur ishte shumë i vogël, Denisi pati dhunti për sportin dhe shkolla e mesme i dha bursë për të luajtur me skuadrën e tyre. Pasi mbaroi shkollën e mesme, një skuadër profesionale i ofroi atij





pagesë, vend për të ndenjur dhe ushqim. Ishte realizimi i një ëndrre, por Denisi e dinte se kjo do të binte ndesh me planet e tij për të shkuar në mision më vonë atë vit.

Dëshira e Denisit që të bënte atë që Ati i tij Qiellor donte që ai të bënte,



ishite kaq e fortë sa ai as nuk donte të tundohej që të qëndronte në skuadër, kur koha do të vinte për të për të shërbyer në mision. Shumë njerëz e vunë në dyshim zgjedhjen e tij, por Denisi është i sigurt që ai mori vendimin e drejtë – për vete dhe për të tjerët. “Dy vëllezërit e mi të vegjël dhe motra ime e vogël sapo u pagëzuan”, thotë ai. “Nuk mendoja kurrë se motra ime do ta dëgjonte ungjillin. Kur e shoh Perëndinë duke bërë mrekulli për familjen time, më jepet shpresë e shkëlqyeshme për të ardhmen time.”

Në lagjen e Denisit të rinjtë studiojnë *Predikoni Ungjillin Tim* çdo javë. Ata janë bërë si një skuadër, duke punuar ngushtë me misionarët me kohë të plotë dhe duke sjellë shokë në mbledhjet e së dielës dhe aktivitete të tjera, duke përfshirë ndeshjet e basketbollit dhe futbollin gjatë

javës. Priftërinjtë kanë pagëzuar miq dhe të tjerë, për të cilët ndihmuan t'i mësonin së bashku me misionarët. Për një periudhë disa vjeçare, kjo skuadër të rinjsh e ka forcuar të gjithë lagjen dhe katër prej tyre, përfshirë Denisin, morën thirrje në misionin e Nairobi në Kenia.

Ata kanë ndjekur këshillën e Plakut Dejvid A. Bednar, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, për t'u “bërë misionarë kohë përpara se të dorëzoni letrat tuaja të misionit”.<sup>3</sup> Ata e bënë këtë duke punuar së bashku si kuorum, një skuadër më e mirë se ndonjë skuadër tjetër.

Që të katër misionarët kapërcyen sfida me qëllim që të shërbenin. Uilberfors shpjegon: “Po e humbja shpresën e të shkuarit në mision [për shkak të kostos], por më pas lexova Mateu 6:19–20: ‘Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë . . . përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell’. Kështu me zell dhe zotim, isha në gjendje ta plotësoj qëllimin tim për të shërbyer një mision me kohë të plotë. E dua shërbimin misionar. Asgjë nuk është më e mirë sesa kërkimi së pari i mbretërisë së qiellit.”

### Shpresë për të Ardhmen

Të rinjtë e Ugandës po ndihmojnë për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë këtu, me shpresë të madhe për të ardhmen. Edhe pse nuk ka tempull në Afrikën Lindore, të rinjtë mezi presin kohën kur ata do të martohen në një tempull të largët. Një aktivitet kunji u përqendrua në përgatitjen për të hyrë në tempull dhe në përfundim, një anëtar i presidencës së kunjit dha

dëshminë e tij: “Perëndia ju do. Ju jeni e ardhmja e Kishës në Ugandë.” Këta të rinj të drejtë janë tashmë duke pasur një ndikim të madh.


Të rinjtë dhe të rejtat e Ugandës po sakrifkohen gjërat e botës për bekime që do të zgjasin përgjithmonë. Ata e kanë mbjellë farën e besimit dhe po e ushqejnë atë me kujdes (shih Alma 32:33–37). Si një pemë e mbushur me fruta (shih Alma 32:42), rinia ndan gëzimin e ungjillit në këtë tokë pjellore. ■

*Sindi Smith jetoi në Ugandë, ndërkohë që bashkëshorti i saj punonte atje dhe tani jeton në Jutá, SHBA.*

### SHËNIME

1. Elen S. Dalton, “A Return to Virtue,” *Liahona*, nëntor 2008, f. 80.
2. Elen S. Dalton, “A Return to Virtue,” *Liahona*, nëntor 2008, f. 80.
3. Plaku David A. Bednar, “Becoming a Missionary,” *Liahona*, nëntor 2005, f. 45.





# Çfarë Është një MIK I VËRTETË?

Nga Elen S. Dalton,

Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

**P**ërkufizimi i një miku ka ndryshuar në botën e sotme me lidhje teknologjike. Sot ne mund të mendojmë se kemi shumë “miq”. Është e vërtetë: ne vërtet kënaqemi me aftësinë që të informohemi dhe të dimë në çdo kohë se çfarë po ndodh në jetën e shumë të njohurve tanë, si edhe të miqve të tanishëm e të mëparshëm, dhe madje edhe të njerëzve që nuk i kemi takuar personalisht, të cilët i quajmë miq.

Në lidhje me median shoqërore, termi “mik” shpesh përdoret për të përshkruar *kontakte* më tepër se sa

*marrëdhënie*. Ju keni aftësinë për t’iu dërguar “miqve” tuaj një lajm, por kjo nuk është e njëjtë me të pasurin e një marrëdhënieje me një njeri ballë për ballë.

Nganjëherë shqetësimi ynë është të *kemi* miq. Ndoshta duhet të përqendrohemi te të *qenit* mik.

Ka shumë përkufizime se çfarë do të thotë të jesh një mik. Kurrë nuk do ta harroj kur dëgjova Plakun Robert D. Hejls, të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve, të fliste rreth asaj se çfarë do të thotë të jesh një mik dhe ndikimit të fuqishëm të miqve në jetën

tonë. Përkufizimi i tij ka pasur ndikim të përhershëm në jetën time. Ai tha: “Miqtë janë njerëz që ta bëjnë më të lehtë të jetosh ungjillin e Jezu Krishtit”<sup>1</sup>. Në këtë kuptim, të kërkuarit e së mirës më të madhe për një njeri tjetër, është thelbi i miqësisë së vërtetë. Është të vënit e dikujt tjetër para vetes. Është të qenit tërësisht i ndershëm, besnik dhe i dëlirë në çdo veprim. Ndoshta është fjala *zotim* që zbulon kuptimin e vërtetë të miqësisë.

Kur bija ime, Emi, ishte 15 vjeçe, ajo mori vendim se çfarë lloj miqsh do të kërkonte. Një mëngjes ajo vuri re që kopja e saj e Librit të Mormonit ishte hapur tek Alma 48. Ajo kishte shënuar vargjet që përshkruajnë kapiten Moronin: “Moroni ishte njeri i fortë dhe i fuqishëm; ai ishte njeri me kuptim të përsosur. . . . Po, dhe ai ishte një njeri i vendosur në besimin e Krishtit” (vargjet 11, 13). Në anë ajo kishte shkruar: “Unë dua të shoqërohem dhe të marrohem me një burrë si Moroni”. Ndërsa shihja Emin dhe llojin e të rinjve me të cilët u shoqërua dhe më vonë doli në takime kur mbushi 16 vjeç, mund të shihja se ajo vetë po shërbente si shembull i atyre cilësive dhe po i ndihmonte të tjerët të jetonin në lartësinë e identitetit të tyre si bij të Perëndisë, mbajtës të priftërisë dhe etër e udhëheqës të ardhshëm.



Miqtë e vërtetë i ndikojnë ata me të cilët shoqërohen, për t'u "ngritur pak më lart [dhe] pak më mirë"<sup>2</sup>. Ju mund ta ndihmoni njëri-tjetrin, veçanërisht të rinjtë, për t'u përgatitur dhe për të shërbyer misione të nderuara. Ju mund ta ndihmoni njëri-tjetrin që të qëndroni të pastër moralisht. Ndikimi dhe shoqëria juaj e drejtë mund të kenë një pasojë të përjetshme, jo vetëm në jetën e atyre me të cilët shoqëroheni, por edhe për brezat që do të vijnë.

Shpëtimtari i quajti dishepujt e Tij miqtë e Tij. Ai tha:

"Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve.

Askush s'ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij.

Ju jeni miqtë e mi, nëse bëni gjërat që unë ju urdhëroj.

Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk e di ç'bën i zoti; por unë ju kam quajtur *miq*; sepse ju bëra të njihni të gjitha gjëra që kam dëgjuar nga Ati im" (Gjoni 15:12-15; theksimet të shtuara).

Ndërsa jetoni dhe ndani ungjillin e Jezu Krishtit, ju do të tërhiqni te vetja njerëz që do të duan të jenë miku i juaj – jo thjesht një kontakt në një faqe të medias shoqërore, por ai lloj miku që siç qe Shpëtimtari me fjalët e Tij dhe shembullin e Tij. Ndërsa përpiqeni fort të jeni mik me të tjerët dhe e lejoni dritën tuaj të shkëlqejë, ndikimi juaj do të bekojë jetën e

shumë vetëve me të cilët shoqëroheni. E di se, ndërsa përqendroheni për të qenë mik për të tjerët, siç përcaktohet nga profetët dhe nga shembujt e shkrimeve të shenjta, ju do të jeni të lumtur dhe do të jeni një ndikim për mirë në botë dhe, një ditë, do të merrni premtimin e lavdishëm, të përmendur në shkrimet e shenjta rreth miqësisë së vërtetë: "Po ai shoqërim që ekziston mes nesh këtu, do të ekzistojë mes nesh atje, veçse do të jetë me lavdi të përjetshme" (DeB 130:2). ■

#### SHËNIME

1. Robert D. Hales, "This Is the Way; and There Is None Other Way", në *Brigham Young University 1981-1982 Speeches* (1982), f. 67.
2. Gordon B. Hinckley, "The Quest for Excellence", *Liahona*, shtator 1999, f. 8.


#### IDE KYÇE RRETH MIQËSISË

"Zgjidhni miq me të cilët keni vlera të përbashkëta, në mënyrë që ju të mund ta forconi dhe nxisni njëri-tjetrin për të jetuar standarde të larta.

Që të keni miq të mirë, jini një mik i mirë. . . .

Ndërsa kërkoni që të jeni mik me të tjerët, mos bëni kompromis me standartet tuaja."

*Për Forcën e Rinisë (broshurë, 2011), f. 16.*



# FTESA Ime drejt SHPËTIMIT

Nga Emerson Hoze de Silva

**K**ur isha i ri, unë vizitova shumë grupe fetare dhe u hutova, sepse secili prej tyre jepte mësim interpretime të ndryshme të shkrimeve të shenjta. Nuk ndihesha mirë prej mungesës së nderimit që gjeta te disa prej tyre, kështu që hoqa dorë nga përpjekja për të gjetur një kishë ku të merrja pjesë.

Disa vite më vonë, një miku im, Kleiton Lima, u pagëzua në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ai nuk ma përmendi këtë, edhe pse ishim miq të mirë, por ndërsa koha kalonte, fillova të shoh ndryshime tek ai. Të dielave, zakonisht shkoja te shtëpia e tij në mëngjes, që të mund të luanim futboll, por kurrë nuk munda ta gjej në shtëpi. Kjo ndodhi dy ose tri të diela me radhë. Më së fundi, Kleitoni më tha se nuk mund të





luante më futboll të dielave, sepse po nderonte ditën e Zotit. Unë i thashë: “Kjo kishë po të luan nga mendtë”.

Atëherë Kleitoni më ftoi të shkoja në kishë. I thashë një shfajësim, sepse akoma s’kisha dëshirë për fenë. Për 10 muaj, Kleitoni i solli misionarët për të më mësuar, por unë gjithmonë gjeja ndonjë shfajësim ose u thoja se isha shumë i zënë. Por ai nuk hoqi dorë kurrë.

Një ditë në qershor, ai më ftoi të shkoja në një mbrëmje vallëzimi të Kishës. E ngacmova: “A do të ketë ushqim falas dhe shumë vajza?” Duke qeshur, ai tha po!

Duhet të pohoj se u mposhta nga stomaku im. E vizitova kishën dhe më pëlqeu shumë. Më mirëpritën të gjithë, hëngra shumë dhe pata interesim për të ndjekur një mbledhje. Kur arrita në kishë të dielën, takova shumë njerëz dhe dëgjova dëshmitë e tyre. Nuk dija

gjë për Librin e Mormonit, por e ndieva Shpirtin e Zotit kur anëtarë të ndryshëm të Kishës dëshmuan: “E di se Libri i Mormonit është i vërtetë, se kjo është Kisha e Jezu Krishtit dhe se Jozef Smithi ishte një profet i thirrur nga Perëndia”. Nuk isha ndier kurrë kaq mirë. Ende nuk doja të takohesha me misionarët, por ajo mbledhje dëshmish më preku.

Javën më pas, Kleitoni përsëri më ftoi të shkoja në kishë. Nuk munda, sepse kisha një detyrim tjetër. Munda ta shihja trishtimin në fytyrën e tij, kur i thashë se nuk e dija nëse mund të shkoja.

Megjithatë, të dielën në mëngjes u zgjova me dëshirën që të shkoja në kishë. U ngrita nga shtrati në 6:50, gjë që ishte e vështirë për mua, dhe u bëra gati e prita të vinte Kleitoni. Ai u habit kur më pa të veshur dhe duke pritur. Atë të diel, peshkopi dha një mesim rreth priftërisë. E ndieva fuqishëm Shpirtin dhe pata përshtypjen se duhej t’i merrja mësimet e misionarëve. Në fund të mbledhjes së Të Rinjve, e dija se do të pagëzohesha.

Kur mbaroi kisha, i thashë Kleitoni: “Unë dua të pagëzohem!”

Ai mendoi se po bëja shaka. Por më

pas tha: “Nëse i marr në telefon pleqtë [elderat], a do të takohesh me ta?” Iu përgjigja po.

Më dhanë mesim pleq [eldera] të shkëlqyeshëm. Kur e dëgjova mesazhin e Rivendosjes, pata një pohim akoma më të madh se duhej të pagëzohesha. Por doja të dija vetë për vërtetësinë e Librit të Mormonit. Pleqtë [elderat] e shënuan Moroni 10:3–5 në Librin tim të Mormonit dhe më ftuan të lutem dhe t’i kërkoj Perëndisë, në se ai është i vërtetë.

Mbrëmjen që pasoi, më kujtohet se ende nuk e kisha lexuar Librin e Mormonit. Kur fillova të lexoja, ndieva një shpirt shumë të fortë. U luta dhe, para se të mbaroja, e dija se Libri i Mormonit është i vërtetë. I jam mirënjohës Perëndisë që iu përgjigj lutjes sime. Unë u pagëzova në korrik 2006.

Më vonë shërbeva si misionar në misionin e Brazilit, Kuiuabá dhe miku im Kleitoni shërbeu në misionin e Brazilit, Santa-Maria. Ne bëjmë atë që Kleitoni bëri për mua: i ftuam njerëzit të vijnë te Krishti dhe i ndihmuam të merrnin ungjillin e rivendosur, përmes ushtrimit të besimit te Jezu Krishti, pendimit, të qenit të pagëzuar dhe marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë.

Le t’i ftojme gjithmonë miqtë dhe të afërmit tanë që të mësojnë për këtë ungjill, pasi Shpëtimtari ftoi çdo njeri kur tha: “Ejani tek unë” (Mateu 11:28). E di se kjo është Kisha e Jezu Krishtit dhe se tani është koha për ta ftuar çdo njeri që të vijë tek Ai. ■



# DHJETË MËNYRA PËR TA DITUR SE JENI KTHYER NË BESIM

Nga Tajlër Orton

**U**në mësova në mbledhjen e priftërisë se një nga qëllimet e Priftërisë Aarone është të na ndihmojë të “bëhemi të kthyer në besimin tek ungjilli i Jezu Krishtit dhe të jetojmë sipas mësimëve të tij”<sup>1</sup>. Nuk isha i sigurt se çfarë do të thoshte të “bëhe[sha] i kthyer në besimin tek ungjilli i Jezu Krishtit”. I pyeta prindërit dhe motrat e vëllezërit më të mëdhenj se çfarë do të thoshte dhe së bashku diskutuam një numër mënyrash se si mund të shihni nëse po bëheni i kthyer në besim.

Mund të ketë edhe të tjera, por këto janë 10 mënyrat që ne përmendëm. Përderisa kthimi në besim është një proces që vazhdon gjatë gjithë jetës, nuk na nevojitet të jemi të përsosur në secilën nga këto fusha tani, por ato mund të na ndihmojnë të dimë nëse po përparojmë.

**1.** Kur je i kthyer në besim, jo vetëm e *di* se çfarë duhet të bësh, por gjithashtu *dëshiron* të bësh gjërat e drejta. Nuk mjafton thjesht t’i shmangesh bërjes gabim, ngaqë ke frikë se mos të kapin ose të ndëshkojnë. Kur je i kthyer me të vërtetë në besim, dëshiron vërtet të zgjedhësh të drejtën.

**2.** Një shenjë tjetër e bërjes i kthyer në besim, është që të mos kesh më dëshirë të bësh gabim. Anti-nefi-lehitët janë një shembull i shkëlqyer i kësaj. Kur u kthyen në besim tek ungjilli i Krishtit, ata “kishin hyrë në një besëlidhje me Perëndinë për t’i shërbyer atij dhe për të zbatuar urdhërimet e tij” (Mosia 21:31). Si nefitët që morën mësim nga mbreti Beniamin, ata nuk kishin “më prirje të bë[nin] keq” (Mosia 5:2). Ata u kthyen me të vërtetë në besimin tek ungjilli i Krishtit dhe tundimet e Satanit nuk patën fuqi mbi ta.

**3.** Kur je i kthyer në besim, shqetësohesh më shumë rreth asaj që mendon Perëndia, sesa asaj që mendojnë të tjerët për ty. Në shkollën time në Indonezi, nxënësit kanë prirje të pijnë shumë. Nganjëherë mund të jetë tunduese të shkosh në mbrëmje argëtimi, kur të gjithë të tjerët janë duke e bërë atë dhe duke u tallur me ty ngaqë nuk shkon. Vëllai im u ftua të pinte dhe të shkonte në mbrëmje disa herë, por ai s’e bëri kurrë – ai mbrojti atë çka besonte. Ishte e vështirë dhe ai kaloi shumë net i vetëm në shtëpi. Kur nxënësit po i thonin njëri-tjetrit lamtumirë në ceremoninë e diplomimit, disa

vetë i thanë atij se sa të habitur ishin, që ai kishte mundur t’i bënte ballë presionit të shoqërisë dhe t’u qëndronte i vërtetë standardeve të tij. I thanë se sa shumë e vlerësonin atë për shkak të kësaj. Ai tregoi se ishte kthyer në besim nëpërmjet bërjes ballë presionit të shoqërisë.

**4.** Kur je i kthyer në besim, përpiqesh ta jetosh ungjillin gjithmonë – jo vetëm të dielave ose kur të duket e përshtatshme, por gjatë gjithë kohës. Veprimet e tua nuk ndryshojnë në varësi se me kë je apo se kush po të sheh. Kur shokët e tu tregojnë shaka të pahijshme

ose duan të shohin një film të fëlliqur, nuk e bën atë thjesht ngaqë nuk po të sheh njeri. Përkundrazi, ti mbron atë që beson.

**5.** Kur je i kthyer në besim, je më i mirë dhe më i dhembshur në të gjitha marrëdhëniet me të tjerët. Nuk gjykon ose kritikon, apo bën thasetheme. Bëhesh më i vëmendshëm për ndjenjat e të tjerëve dhe të bëhet e natyrshme të kërkosh mënyra se si të shërbesh dhe të ndihmosh. Nëse po ecën në korridorin e shkollës dhe dikujt i bien librat, s’ke pse të mendoresh se çfarë të bësh. Vetvetiu ndalesh për të ndihmuar.




5.



**NJË MËNYRË E SIGURT DREJT LUMTURISË**

“Zoti dëshiron që anëtarët e Kishës së Tij të kthehen në besim plotësisht në ungjillin e Tij. Kjo është e vetmja mënyrë e sigurt për të pasur siguri shpirtërore tani dhe lumturi përgjithmonë.”

Plaku Donald L. Hallstrom, i Presidentës së Të Shtatëdhjetëve, “Të Kthyer në Besim tek Ungjilli i tij përmes Kishës së Tij”, *Liahona*, maj 2012, f. 15.



6.



2.

*Për të treguar se do të ishin të vërtetë ndaj besëlidhjes së tyre për të jetuar ungjillin, lamanitët e kthyer në besim i varrosën armët e tyre (shih Alma 24).*

7.



**6.** Kur je i kthyer në besim, dëshira jote për t'u lutur rritet dhe e ndien se vërtet po komunikon me Perëndinë kur lutesh. Gjithmonë do të gjesh kohë të lutesh, pavarësisht se si ndihesh apo çfarë po ndodh në jetën tënde. Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) na tha: “Nëse ndiejmë se nuk na pëlqen të lutemi, atëherë duhet të lutemi derisa ta ndiejmë se na pëlqen të lutemi”<sup>2</sup>.

**7.** Kur je i kthyer në besim, e pret të dielën me padurim, sepse është Shabati. Kur vjen e diela, në vend që të mendosh: “O, është dita që nuk mund të dal me shokët ose të shkoj në kinema”, mendon: “Sa mirë, një ditë që mund të ndjek kishën dhe të përqendrohem në gjëra



shpirtërore e të kaloj kohë me familjen time!”

**8.** Kur je i kthyer në besim, i mban urdhërimet dhe nuk kërkon justifikime, nuk e arsyeton sjelljen apo përpiqesh të gjesh fusha të paqarta. Nuk përpiqesh t'i largosh kufizimet; thjesht i mban urdhërimet, sepse e di se është udha më e mirë.

**9.** Kur je i kthyer në besim, pret me padurim të paguash të dhjetën. E shikon atë si privilegj dhe e ndien se 10 përqind nuk është aq shumë, veçanërisht po të krahasohet me bekimet dhe kënaqësinë që fiton. Këto bekime kanë më shumë vlerë se sa paratë që pagove.

**10.** Kur bëhesh i kthyer në besim, ke dëshirë të fortë

të ndihmosh të tjerët, që ta njohin të vërtetën dhe lumturinë që ke gjetur vetë. Një shembull i mirë nga shkriimet e shenjta është ëndrra e Lehit, në të cilën ai pati dëshirë të fortë për ta ndarë frutin e shijshëm të pemës së jetës me familjen e tij. Kur mori nga fruti, mendimi i tij i parë nuk ishte të merrte më shumë për vete, por të kërkonte familjen e tij, me qëllim që edhe ata të mund të merrnin nga fruti dhe të kishin të njëjtën lumturi (shih 1 Nefi 8:12).

Si përmbledhje, e di se po bëhesh i kthyer në besim, kur fillon të jetosh një ligj më të lartë, ungjillin e Jezu Krishtit. E jeton ligjin jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra. E jeton ungjillin në të gjitha fushat e jetës tënde. E jeton ungjillin plotësisht, jo sepse të duhet ta jetosh, por sepse dëshiron ta jetosh. Je njeri më i lumtur e më i mirë dhe dëshiron të bëhesh njeriu që Ati Qiellor të do të jesh. Dëshiron të jesh si Jezu Krishti dhe ta ndjekësh shembullin e Tij. Kur bëhesh ai njeri, me të vërtetë je bërë i kthyer në besim. ■

*Tajlër Orton jeton në Xhava, Indonezi.*

#### SHËNIME

1. *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 8.1.3.
2. Ezra Taft Benson, “Pray Always”, *Liahona*, qershor 1990, f. 4.

# IA VLEN TË

## PUNOSH FORT

Do të mahniteni nga ajo që do të arrini  
nëse vazhdoni të përpiqeni.

(Shih *Për Forcën e Rinisë* [broshurë, 2011], f. 40-41.)



# Misionari

## i Vogël i Gjyshe Denit

Nga Emilia Maria Guimaraes Korrea

*“Kur një njeri flet nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, fuqia e Frymës së Shenjtë e çon atë në zemrat e fëmijëve të njerëzve” (2 Nefi 33:1).*

**V**itori jetonte me nënën dhe motrën e tij në shtëpinë e gjyshe Denit. Gjyshja e Vitorit u sëmur dhe nuk mundi ta linte shtratin për shumë javë. Ajo ishte e vetmuar në dhomën e saj.

Vitori vendosi se ai mund t'i bënte shoqëri gjyshes Deni. Çdo ditë, kur kthehej nga shkolla, çonte një kopje të *Liahonës* në dhomën e gjyshes dhe i lexonte asaj histori nga faqet e fëmijëve.

Pasi i lexoi të gjitha kopjet e *Liahonës* që kishte familja e tij, ai filloi t'i lexonte asaj Librin e Mormonit dhe Biblën. Gjyshja Deni nuk ishte anëtare e Kishës, por kishte shumë dëshirë ta dëgjonte Vitorin t'i lexonte. Ajo ishte e gëzuar të mësonte rreth ungjillit.

Gjyshja bëri shumë pyetje. Nëse Vitori nuk i dinte përgjigjet, pyeste mësuesen e tij të Fillores ose shihnte në shkrimet e shenjtja. Gjyshja

e thërriste Vitorin ‘misionari i saj i vogël’.

Gjyshja Deni i tha Vitorit se kishte mësuar shumë prej tij. Ajo premtoi se do të vinte me të në kishë kur të bëhej mirë. Çfarë kishte mësuar, e bëri atë të dëshironte të bëhej më mirë dhe të studionte më shumë rreth ungjillit.

Kur gjyshja u bë mirë, ajo e mbajti premtimin. Shkoi në kishë me Vitorin për të mësuar më shumë rreth asaj që i kishte mësuar ai. Nuk kaloi shumë kohë para se gjyshja të pagëzohet dhe të konfirmohet. Vitori e kishte ndihmuar atë të mësonte se ungjilli është i vërtetë.

Kur Vitori u rrit, ai u bë një misionar me kohë të plotë në Misionin e Masaçusetsit, Boston. Përpara se të largohej, ai shkoi në tempull – me gjyshe Denin. ■

*Emilia Maria Guimaraes Korrea jeton në Distriktin Federal në Brazil.*





**Nga Plaku M. Rasëll Ballard**

i Kuorumit të Dymbëdhjetë  
Apostujve

*Anëtarët e Kuorumit të  
Dymbëdhjetë Apostujve  
janë dëshmitarë të  
veçantë të Jezu Krishtit.*

# Pse Kisha ka një emër kaq të gjatë?

**J**ezu Krishti Vetë ia vuri emrin  
Kishës (shih Doktrina e  
Besëlidhje 115:4).

Fjalët *Kisha e Jezu Krishtit* shpallin  
që është Kisha e Tij.

*Të Ditëve të Mëvonshme* shpjegon  
se është e njëjta Kishë, me Kishën që

Jezu Krishti krijoi kur jetoi në tokë,  
por e rivendosur në këto ditë të  
mëvonshme.

*Shenjtoreve* do të thotë që ne e  
ndjekim Atë dhe përpiqemi të bëjmë  
vullnetin e Tij.

Anëtarët tanë janë quajtur *mormonë*,  
sepse besojmë në Librin e Mormonit,  
por ne duhet ta përdorim emrin e  
plotë të Kishës kurdoherë që është  
e mundur. ■

*Nga "Rëndësia e një Emri", Liahona, nëntor 2011,  
f. 79–82.*




Nga Darsi Jensen

**K**ur Tempulli i Solt-Lejkut u përfundua në 1893, shenjtoret e ditëve të mëvonshme u gëzuan. U ishin dashur 40 vjet për ta ndërtuar tempullin. Ngaqë fëmijët kishin dhuruar para për ta ndërtuar tempullin, Presidenti Uillford Udrاف vendosi që të mbante pesë sesione të veçanta përkushtimi, që të merrnin pjesë fëmijët.

Sot tempujt kanë mbushur tokën dhe fëmijët ende ndihmojnë për të festuar përfundimin e tempujve. Shihni se si fëmijët morën pjesë në të kaluarën dhe tani. ■

*Darsi Jensen jeton në Kaliforni, SHBA.*

*Më shumë se 12.000 fëmijë erdhën te **Tempulli i Solt-Lejkut** për përkushtimin. Këta fëmijë nga lagjja e Shugër-Hauzit erdhën me tren.*



*Kjo biletë i lejoi fëmijët deri në moshën 16-vjeçare të merrnin pjesë në shërbime të veçanta përkushtimi për **Tempullin e Solt-Lejkut**. Apostuj dhe anëtarë të Presidencës së Parë u folën fëmijëve brenda në tempull.*



*Nganjëherë tempujt ripërkushtohen pasi rimodelohen. Fëmijë të Fillores kënduan dhe mbajtën drita në shfaqjen që festoi ripërkushtimin e **Tempullit të Ankorixhit në Alaskë**.*



*Çdo javë, ndërkohë që **Tempulli i Gilbertit në Arizona** po ndërtohet, fëmijët e Fillores nga Kunji Hajlënd në Gilbert, Arizona, kanë vënë si qëllim t'i shërbejnë dikujt në lagjet e tyre.*

# Festimi për Tempujt!

*Kur po ndërtohej **Tempulli i San-Diegos në Kaliforni**, fëmijët e Fillores nga Meksika bënë një qilim plot ngjyra për tempullin. Autoritetet e Përgjithshme qëndruan mbi atë qilim gjatë shërbesës së vendosjes së gurit të qoshes në përkushtim.*







Fëmijët e Fillores në Manitoba, Kanada, bënë tri orë me makinë për te **Tempulli i Rexhinës në Saskaçuan**, për të prekur muret dhe për t'u zotuar se do të hynin brenda një ditë.

Fëmijët e Fillores në shtëpinë e hapur të **Tempullit të Kievit në Ukrainë** mirëpritën vizitorët duke kënduar "I Love to See the Temple" ["Unë Dua ta Shoh Tempullin"].



Më shumë se 800 fëmijë të Fillores nga **Afrika Perëndimore** kënduan "Fëmi i Per'ndis' Jam" në festimin kulturor përpara se të përkushtohet **Tempulli i Akras në Gana**.



Fëmijë të Fillores kënduan për **Presidentin Gordon B. Hinkli**, kur ai arriti për të përkushtuar **Tempullin e Abas në Nigeri**.



Çdo tempull ka një gur të qoshes që tregon vitin kur u përkushtua. Gjatë përkushtimit, Autoritetet e Përgjithshme e vulosin gurin e qoshes me llaç. **Isak B., 9 vjeç**, ndihmoi në vendosjen e llaçit në gurin e qoshes të **Tempullit të Kansas-Sitit në Mizuri**.

# Pyetje dhe Përgjigje për Tempullin

## Përse i kemi tempujt?

Tempujt e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë vende të shenja ku ne mësojmë të vërteta të përjetshme dhe marrim pjesë në ordianca të shenja.

## Si është brenda tempullit?

Tempulli është një vend paqësor, plot nderim dhe i bukur. Gjithçka brenda tempullit është e pastër dhe e rregullt. Të gjithë vishen në të bardha dhe flasin me zë të ulët.

## Çfarë ndodh në tempujt?

Një bashkëshorte mund të vulozet me bashkëshortin e saj dhe fëmijët mund të vulozen me prindërit e tyre. Vulosja bën të mundur që familjet të

jenë së bashku për përjetësinë. Në tempull, burra dhe gra marrin gjithashtu një dhuratë bekimesh shpirtërore të quajtur indaument. Ata mund të marrin indaumentin dhe të vulozen edhe për ata që vdiqën pa i bërë besëlidhjet e tempullit.

## Ç'gjë tjetër ndodh në tempujt?

Përveç vulosjes dhe indaumentit, ordianca të tjera kryhen në tempuj. Njerëzit mund të pagëzohen dhe konfirmohen për ata që nuk ishin në gjendje të bashkoheshin me Kishën kur ishin gjallë. Kur bëheni 12 vjeç dhe jeni të denjë të hyni në tempull, mund të keni mundësinë për t'u pagëzuar dhe konfirmuar për ata që vdiqën pa ungjillin.

## Çfarë ndodh nëse familja ime nuk ka qenë në tempull?

Ati Qiellor të njeh dhe të do ty dhe familjen tënde. Ai do që çdo njeri të ketë bekimet e ordinancave të tempullit. Jeto i denjë për të hyrë në tempull. Cakto një objektivi tani, që ti do të marrësh indaumentin dhe do të martohesh në tempull një ditë. Ati yt Qiellor do të të bekojë ty dhe familjen tënde. ■



“Miqte e mi të rinj . . . gjithmonë mbajeni tempullin parasys. Mos bëni asgjë që ju pengon të hyni në dyert e tij dhe të merrni bekimet e shenja e të përjetshme që janë atje.”

Presidenti Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 93.

# Familjet Mund të Jen' Bashk' Përgjithmon'

(E thjeshtuar)

Fjalët nga Ruth Muir Gardner  
Muzika nga Vanja Y. Watkins

*Me shkëlqim* ♩ = 80-96

1. Kam një fa-mil - je k'tu në tok'. Me mua jan' kaq të mir'.  
2. Ndër-sa un'jam en - de fë - mij', Ga-ti-tem me ma - tu - ri,

Me fa - mil-jen ti - me dua t'rroj në gjith' për - je - të - sin'.  
Që t'mund të mar - to - hem në tem - pull për për - je - të - sin'.

*Kori*

Fa - mil-jet mund të jen' bashk'për-gjith - mon' Për-mes pla - nit t'A-tit. Du -  
a të jem me fa - mil - jen në për-je-t'si, Dhe Zo - ti më ka tre-gu-ar si. Zo -  
ti më ka tre - gu - ar si.

Fjalët dhe muzika © 1980 IRI. Arranzhimi © 2012 IRI. I rezervohen të gjitha të drejtat.  
Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti.

# Jezu Krishti e Rivendosi Kishën e Tij në Ditët e Mëvonshme



Këtë mësim dhe veprimtari mund ta përdorni për të mësuar më shumë mbi temën e Fillores të këtij muaji.

**P**ërfytyroni se po shkoni në një gjueti thesari. Ku do ta kërkonit thesarin? Si do ta gjenit? A do të ketë një kuti thesari? Çfarë do të ketë brenda?

Disa kuti thesaresh përmbajnë bizhuteri të bukura dhe monedha të çmuara. Por si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne kemi një thesar që është edhe më i vlefshëm: ungjillin e Jezu Krishtit.

Shumë njerëz nuk dinë për këtë thesar, kështu që një nga detyrat tona është ta ndajmë atë me sa më shumë njerëz që mundemi.

Pasi Jezusi dhe apostujt e Tij vdiqën, disa mësim dhe ordianca të rëndësishme të ungjillit u humbën ose u

ndryshuan, përfshirë pagëzimin, autoritetin e priftërisë, tempujt, profetët e gjallë dhe sakramentin.

Të gjitha këto thesare të ungjillit u rivendosën nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Ati Qiellor dhe Jezu Krishti iu shfaqën Jozef Smithit në Korijen e Shenjtë, kur ai u lut për të ditur të vërtetën.

Më vonë, Jozefi mori fletët e arta dhe i përktheu ato në Librin e Mormonit. Libri i Mormonit përmban mësim që ne i çmojmë si thesare, sepse ai shpjegon të vërteta që humbën dikur. Ne marrim shumë bekime, sepse i kemi këto të vërteta të ungjillit.

Ç'thesare të çmuara janë ato! ■

## SHKRIMI I SHENJTË DHE KËNGA


- Doktrina e Besëlidhje 35:17
- "The Sacred Grove", *Children's Songbook*, f. 87 (ose ndonjë këngë tjetër rreth Rivendosjes së ungjillit)

## LE TË BISEDOJMË

Tregoni se si thesaret e ungjillit të Jezu Krishtit e bekojnë familjen tuaj.

# BËNI NJË KUTI THESARI TË UNGJILLIT

Priteni dhe paloseni këtë kuti thesari si skica në fund. Prisni monedhat që rendisin disa nga thesaret që ju ka dhënë ungjilli, dhe i vendosni ato brenda kutisë. I shikoni thesaret në kuti shpesh, për t'u kujtuar për bekimet e ungjillit.



# Ku u Organizua Kisha



**Nga Jan Pinboru**

Revistat e Kishës

*Ejani me ne që të bëjmë kërkime në një vend të rëndësishëm në historinë e Kishës!*

**N**ëse Megi dhe Lili E. duan të shohin se ku u organizua fillimisht Kisha, ato nuk duhet të shohin shumë larg. Është tamam ngjitur me godinën e kishës në Fajet, Nju-Jork, ku ato shkojnë në kishë çdo të diel!

Kisha nuk u organizua në një ndërtesë kishe, por në një shtëpi

druri. Profeti Jozef Smith erdhi të qëndronte atje me familjen Uitmer në 1829-ën. Shtëpia origjinale nuk ndodhet më, por kjo kabinë druri është në të njëjtin vend.

Godina e kishës ku Megi dhe Lili shkojnë në kishë, ka një qendër vizitorësh me paraqitje rreth shtëpisë Uitmer dhe gjërave të veçanta që ndodhën atje. ■




**1. Jozef Smithi mbaroi përkthimin e Librit të Mormonit këtu.**





**2. Jashtë, jo larg nga shtëpia, tre burra panë engjëllin Moroni dhe fletët e arta. Ata quhen Tre Dëshmitarët, sepse i dëshmuuan, ose i panë, fletët. Ju mund t'i gjeni dëshmitë e tyre në fillim të Librit të Mormonit.**



**3. Më 6 prill 1830, rreth 60 vetë erdhën në një mbledhje të veçantë. Jozef Smithi organizoi zyrtarisht Kishën dhe sakramenti u bekua dhe u shpërnda. Kjo ishte mbledhja e parë e sakramentit!**

## PAGËZIMI DIKUR DHE TANI

Megi, 11 vjeç, dhe Lili, 9, u pagëzuan në një burim pranë vendit ku u pagëzuan anëtarët e parë të Kishës.

Të dy vajzat ishin shumë të gëzuara se do të pagëzoheshin. Kur ishte radha e Lilit për t'u pagëzuar, ajo pati një intervistë me peshkopin e saj. "Më pyeti nëse kisha dëshmi për profetin dhe nëse e pagova të dhjetën time", tha Lili.

Vajzat, që të dyja, kanë kujtime të mira nga ditët e tyre të pagëzimit. "Kur dola nga uji, pata një ndjenjë se mund të bëja gjithçka", tha Megi.


Të dy vajzat morën ditare, që të mund të shënonin ndjenjat e tyre rreth ditëve të tyre të veçanta.



**4. Menjëherë pas mbledhjes, prindërit e Jozef Smithit dhe disa njerëz të tjerë u pagëzuan jashtë.**

# Maksi dhe Mia Shpëtuan Ditën

Nga Chris Deaver, Teksas, SHBA



Maksi u bë gati të luante superheroin. Veshi bluzën e tij të kuqe. Veshi pelerinën e tij të superheroit. Më pas shkoi në dhomën e motrës së tij të vogël.

“Eja, Mia”, tha Maksi. “Le të shkojmë të shpëtojmë ditën!”





Maksi dhe Mia shkuan në dhomën e ndenjjes. Ata panë një shportë plot me rroba.

“A do të më ndihmoni?” pyeti nëna.

“Në rregull”, tha Maksi. “Atëherë ne mund të shkojmë të shpëtojmë ditën.”



Maksi dhe Mia e ndihmuan nënën t'i paloste të gjitha rrobat dhe t'i vendoste ku duhej.

Më pas Maksi pa disa plehra në dysheme. “Le t'i mbledhim gjithë plehrat”, tha Maksi. “Atëherë ne mund të shkojmë të shpëtojmë ditën.”



Maksi dhe Mia vrapuan nëpër shtëpi. Ata larguan të gjitha plehrat që mundën të gjenin.

Panë nënën duke fshirë dyshtemenë e kuzhinës. “Mund të të ndihmojmë”, tha Maksi.

Mia ndihmoi me kacinë, ndërsa Maksi fshiu dyshtemenë.



“Tani le të shkojmë dhe të shpëtojmë ditën”, tha Maksi.

Nëna hodhi sytë përreth shtëpisë së pastër. Pastaj ajo i përqafoi Maksin dhe Mian. “Mendoj se vërtet e shpëtuat!” ■



### JEZUSI ECËN MBI UJË

“Dishepujt duke parë atë që po ecte mbi det, u trembën dhe thanë: ‘Është një fantazmë!’ Dhe filluan të bërtasin nga frika; por menjëherë Jezusi u foli atyre duke thënë: ‘Qetësohuni; jam unë, mos kini frikë!’” (Mateu 14:26–27).

# LAJME TË KISHËS

Vizitoni [news.lds.org](http://news.lds.org) për më shumë informacion mbi lajmet dhe ngjarjet e Kishës.

## Trajnimi Mbarëbotëror i Udhëheqjes – një Përqasje e Re



**Plaku L. Tom Peri, Plaku Donald L. Hallstrom dhe Peshkopi Din M. Dejvis, drejtuan një panel diskutimi mbi rëndësinë e përdorimit të çelësave të priftërisë.**

**N**ë muajt në vijim, anëtarët e Kishës përqark botës do të marrin pjesë në një përqasje të re frymëzuese të Trajnimit Mbarëbotëror të Udhëheqjes.

Ndryshe nga mbledhjet e mëparshme të trajnimit, Trajnimi Mbarëbotëror i Udhëheqjes për këtë vit nuk do të transmetohet si një ngjarje e vetme për udhëheqësit e lagjeve dhe kunjeve. Përkundrazi, është ndarë në nëntë fragmente të shkurtra – në një DVD dhe te [LDS.org](http://LDS.org) – që nxit diskutimin tek të gjithë udhëheqësit, anëtarët dhe familjet gjatë gjithë këtij viti e më tej.

Pika ku do të përqendrohet trajnimi është “Forcimi i Familjes dhe i Kishës nëpërmjet Priftërisë”. Në trajnim, anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, bashkë me Autoritetet e tjera të Përgjithshme dhe drejtuesit e përgjithshëm, japin udhëzim të frymëzuar mbi:

- Mënyrën si familjet mund të gjejnë forcë dhe paqe nëpërmjet fuqisë së priftërisë.
- Mënyrën si të ndihmohet çdo familje që të përjetojë bekimet e priftërisë.
- Mënyrën si t’i forcojnë shtëpitë dhe familjet ata që mbajnë çelësat e priftërisë.
- Mënyrën si të kryejmë shërbesë sipas mënyrave të Krishtit.
- Mënyrën si t’i rrisim fëmijët në dritë e të vërtetë.

Të gjitha njësitë e Kishës do të marrin kopje të DVD-së dhe këshillave të lagjeve e kunjeve u kërkohet ta shohin të plotë. Ata më pas duhet të këshillohen së bashku rreth mënyrës si t’i ndihmojnë anëtarët e lagjes e të kunjit që të kenë dobi nga udhëzimi.

Anëtarët mund t’i shohin dhe të diskutojnë për fragmentet e ndara të DVD-së në mbledhje dhe orë mësimore. Familjet dhe individët mund t’i shohin fragmentet, së bashku me burimet shtesë për të zgjeruar studimin e tyre, te [www.lds.org](http://www.lds.org).

Në çdo mjedis, pjesa më e fuqishme e trajnimit do të ndodhë pasi një fragment të përfundojë dhe të nisë diskutimi. Teksa udhëheqësit, anëtarët dhe familjet meditojnë, tregojnë dhe dëshmojnë rreth asaj që panë e dëgjuan, Fryma e Shenjtë do t’i frymëzojë e do t’u mësojë atyre si ta vënë në zbatim udhëzimin në rrethanat e tyre vetjake. Nëpërmjet këtyre përvojave, ky Trajnim Mbarëbotëror i Udhëheqjes do të ndihmojë që të forcohen familjet dhe Kisha anekënd botës. ■

**Duke qëndruar jashtë shtëpisë së Meri Filding Smithit në Parkun e Trashëgimisë: Ky është Vendi, Plaku M. Rasëll Ballard, Linda K. Barton, Plaku Ronald A. Rasband, Elen S. Dalton, Rozmari M. Uiksom dhe Peshkopi Geri E. Stivenson diskutojnë për bekimet e të pasurit të priftërisë në çdo shtëpi.**



## PËRGJIGJJA NDAJ THIRRJES PËR MË SHUMË MISIONARË:

# Krijimi i një Mendësie Misionare në Shtëpi dhe në Kishë

**Nga Hithër Uaitëll Rigli**

Lajme dhe Ngjarje të Kishës

**P**eshkopi Viktor Nogales i Lagjes Parke Çakabuko, në Kunjin Kongreso në Buenos-Ajres, Argentinë, ulet përpara një stende buletinësh të mbuluar me fotografitë e 37 të rinjve e të rejave në lagjen e tij. Kur njëri prej tyre nisët për një mision, ai vendos një shënim pranë fotografisë.

“Të rinjtë e mi emocionohen shumë kur vijë në zyrën time dhe shohin fotografitë e shënimet”, tha ai. “Kjo i nxit ata të përgatiten për misionet e tyre vetjake.”

Kjo lagje në Buenos-Ajres është shembull për shpirtin e punës misionare. Në gjashtë muajt e parë të 2012-ës, 19 të rinj – 14 prej tyre të kthyer në besim – lanë shtëpitë e tyre për të shërbyer në misione kohëplota në tetë shtete. Më shumë se 80 përqind e të rinjve të përshtatshëm për misione janë zotuar që të shërbejnë.

Në vitet e fundit, udhëheqësit e Kishës kanë bërë disa kërkesa që në misione të shërbejnë më shumë të rinj.

Gjatë konferencës së përgjithshme të prillit 2005, pak pasi u botua manuali *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar*, Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë

Apostujve, i këshilloi familjet dhe udhëheqësit që të krijojnë një shpirt misionari dhe të përgatisin më shumë të rinj e të reja që të shërbejnë me nder duke i ndihmuar ata të kuptojnë cilët janë dhe duke u mësuar doktrinën (shih “One More”, *Liahona*, maj 2005, f. 69).

Njoftimi i Presidentit Tomas S. Monson gjatë konferencës së përgjithshme të tetorit 2012 që kufijtë e moshës misionare do të ulëshin, shërbeu si një kujtues tjetër që Zoti po e shpejton punën e Tij.

Sot, shumë familje dhe udhëheqës të Kishës po i marrin seriozisht këto mesazhe dhe po ndërtojnë një traditë të pasur të shërbimit misionar në zonat e tyre.

### **Të Ndhimuarit e Rinjve që të Kuptojnë Cilët Janë**

Në përgjigje të pyetjes: “Si keni mundur të përgatisni kaq shumë prej të rinjve tuaj që të jenë të gatshëm të shërbejnë?” Peshkopi Nogales tha: “Kur u thirra si peshkop, shqetësimi im kryesor qe rinia e lagjes sime dhe ua bëra të qartë udhëheqësve të tjerë të lagjes që duhej të ishim pjesë e jetës së tyre”.

Për shembull, të gjithë misionarët e Çakabukos kishin thirrje në lagje para largimit të tyre. Shpesh

të sapokthyerit në besim dhe anëtarët më pak aktivë ftoheshin të shërbenin si mësues, gjë që i ndihmoi ata të përgatiteshin për të dhënë mësim ungjillin.

Peshkopi Nogales gjithashtu bëri të mundur që rinia të përgatitet shpirtërisht për një mision duke punuar me misionarët kohëplotë vendorë.

Teksa udhëheqësit dhe anëtarët vendorë të Kishës ia kanë përkushtuar veten rinisë së lagjes, ata janë shpërblyer duke e parë shpirtin misionar të rritet pa masë.

### **Një Familje me Shpirt Misionar**

Garth dhe Eloiza Endrjus nga Drejpëri në Juta, SHBA, e dinë ç’do të thotë të kesh një familje me shpirt misionari. Ata kanë 17 nipër e mbesa që kanë shërbyer në misione dhe kanë shërbyer në gjashtë misione vetë.

Krijimi i shpirtit të shërbimit misionar në familje është diçka që fillon që nga koha kur fëmijët janë të vegjël, tha vëllai Endrjus.

Motra Endrjus qe në një mendje. “Ju nuk e lini shërbimin në një mision si një pritshmëri të heshtur, por flisni me fëmijët dhe nipërit e mbesat tuaja rreth saj si të mos jetë një gjë e pasigurt [thoni] – *kur* të shkosh në mision, jo *sikur*”, tha ajo.

T’u mësosh të rinjve se cilët janë duke dhënë shembull të shërbimit misionar është gjithashtu e rëndësishme. Vëllai dhe Motra Endrjus e pranuan thirrjen e tyre të parë në 1980-ën, pikërisht kur djali i tyre më i vogël po largohej për në misionin e tij.

Një nip u shkroi atyre pasi mori një dhuratë që ata i dërguan për ta



**Peshkopi Viktor Nogales qëndron te stenda e buletinëve që paraqet të gjithë rininë e lagjes së tij, përfshirë ata që po shërbejnë tani në misione.**

ndihmuar atë të përgatitej për mision. “Ai na falënderoi [për dhuratën], por tha: ‘Shumë më e rëndësishme është t’ju falënderoj për shembullin që më keni dhënë’”, tha Motra Endrjus.

### Mësimdhënia e Doktrinës

“Të rinjtë tanë kanë të drejtën të presin që prindërit dhe udhëheqësit e Kishës dhe mësuesit do të sigurohen se ata e dinë dhe e kuptojnë ungjillin e Jezu Krishtit”, tha Plaku Ballard. “Fryma e Shenjtë do të pohojë të vërtetën në zemrat e tyre dhe do të nderë Dritën e Krishtit në shpirtrat e tyre. Dhe atëherë ju do të keni *një tjetër* misionar të përgatitur tërësisht” (M. Russell Ballard, “One More”, f. 71).

Rreth 6.000 milje (9.600 km) larg Buenos-Ajresit, Dega Horsshu Bend

pranë Boizit në Ajdaho, SHBA, ka parë gjithashtu një rritje të ndjeshme në shërbimin misionar teksa familjet dhe udhëheqësit i kanë përforcuar përpjekjet për t’ua mësuar ungjillin të rinjve të tyre.

Nga një degë e vogël me 75 anëtarë, nëntë të rinj po shërbejnë në misione.

Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, theksoi arsyet dhe dobitë e shërbimit. “Të gjithë misionarët . . . shërbejnë me të vetmen shpresë për t’ua bërë jetën më të mirë njerëzve të tjerë”, tha ai. “Vendimi për të shërbyer në një mision do t’i japë formë fatit shpirtëror të misionarit/es, bashkëshortes së tij apo bashkëshortit të saj dhe pasardhësve të tyre për brezat që do të vijnë. Dëshira për të shërbyer është

një pasojë e natyrshme e kthimit në besim, denjësisë dhe e përgatitjes së dikujt” (“Pyetni Misionarët! Ata Mund t’Ju Ndhimojnë!” *Liahona*, nëntor 2012, f. 18).

Martin Uolker, presidenti i Kunjtit Emet në Ajdaho, që dakord me këtë. “Shërbimi në mision e vendos një të ri në një shteg që do të prekë breza të tërë”, tha ai. “Si kunj, ne bëjmë gjithçka që mundemi për t’i përgatitur të rinjtë për shërbim misionar.”

Një pjesë e asaj përgatitjeje është t’u jepet mësim ungjilli të rinjve. Rinia në Degën Horsshu Bend ka të drejtë të ndjekë një orë mësimore javore mbi përgatitjen për mision të dhënë mësim nga një president i mëparshëm misioni – trajnim që e plotëson trajnimin për misionarët të siguruar nga mbledhja mujore e kunjtit mbi përgatitjen për mision për rininë dhe Kampin vjetor të Priftërisë Aarone.

LaRen Adam – një nga gjashtë fëmijët e Vëllait dhe Motrës Endrjus – shërbeu krah të shoqit, Xhimit, në Misionin e Danimarkës, në Kopenhagë nga viti 2007 deri në 2009. Ajo dëshmoi për rëndësinë që ka t’u mësosh fëmijëve ungjillin në shtëpi.

“Një nga gjërat më të mira që mund të bëni për t’i ndihmuar fëmijët tuaj të ndërtojnë një dëshmi për punën misionare, është të mbani mbrëmjet tuaja familjare dhe studimin e shkrimeve të shenjta si familje”, tha ajo. “Nëse u jepni atë bazë të fortë të studimit të ungjillit dhe dijes rreth ungjillit, ata janë shumë më të përgatitur dhe dinë shumë më tepër rreth ungjillit.” ■

# Misionarët e Rinj me Shërbim në Kishë Gjejnë Gëzim kur Shërbejnë

**Nga Karolin Karter**

Lajme dhe Ngjarje të Kishës

**P**laku [Eldër] Ernesto Sarabia mbajti një etiketë të zezë misionari çdo ditë të misionit të tij. Por detyra e tij e misionit qe e veçantë nga shumë të tjera – Plaku [Eldër] Sarabia shërbeu si misionar i ri me shërbim në Kishë (MRSHK) në zyrën e Misionit Hermozilo të Meksikës.

“Ne e pranojmë se mund të mos jetë e udhës që disa të rinj e të reja të përballojnë stresin fizik e emocional dhe sfidat e një misioni kohëplotë”,

ka thënë Plaku

M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Por kjo, tha ai, nuk do të thotë që ata nuk mund të marrin pjesë në bekimet e shërbimit misionar (“One More”, *Liahona*, maj 2005, f. 69).

Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “Një mision është një gjest

vullnetar shërbimi ndaj Perëndisë dhe njerëzimit” (“Pyetni Misionarët! Ata Mund t’Ju Ndhimjojnë!” *Liahona*, nëntor 2012, f. 18), dhe ka shumë mënyra për ta dhënë atë shërbim.

Për ata që janë liruar me nder nga shërbimi në misione predikuese kohëplota, ose për ata që duhet të kthehen në shtëpi herët, programi i MRSHK-së mund të sigurojë përvoja domethënëse misioni.

## Kushtet për të Shërbyer

MRSHK-të duhet të jenë fizikisht, mendërisht, shpirtërisht dhe emocionalisht në gjendje për të kryer detyrat e thirrjeve të tyre, të cilat u caktohen me kujdes.

Detyrat e MRSHK-ve zgjasin nga 6 deri në 24 muaj dhe mund të përfshijnë shërbimin rreth dy ditë në javë deri në shërbimin me kohë të plotë. Ka mundësi për të shërbyer si në komunitet ashtu edhe nga shtëpia. Detyrat e mundshme të MRSHK-ve përfshijnë kërkimet për historinë familjare, teknologjinë e informacionit, ndihmën në zyrën e misionit, në depot e peshkopit e të tjera.

## Mbështetja nga Familja dhe Priftëria

Prindërit, udhëheqësit e priftërisë dhe anëtarët e Kishës mund t’i ndihmojnë MRSHK-të e mundshëm që të shërbejnë në misione.

Familja e motrës Eliza Xhoi Jang ka qenë një mbështetje e fortë për të, duke e çuar dhe duke e marrë atë me makinë nga zyrat e Kishës në Sidni, Australi.

Plaku [Eldër] Majkëll Hillam, i cili punon në Qendrën e Shpërndarjes së Hong-Kongut, tha: “Mësuesit e mi të seminarit herët në mëngjes dhe udhëheqësit e Të Rinjve më ndihmuan të përgatitem”.

## Sakrifica Sjell Bekime

Motra Jang sakrifkoi ditët e saj të pushimit nga puna me kohë të pjeshme për të shërbyer një mision shërbimi në Kishë. Ajo tha: “Ndhem më pranë Atit tim Qiellor duke e ditur se po e ndihmoj”.

Përveç bekimeve shpirtërore, kryerja e një misioni me shërbim në Kishë u jep misionarëve të rinj mundësi sociale dhe profesionale me vlerë. “Misioni im më ka treguar se jam e aftë të punoj në një punë të pavarur”, tha Motra Jang. (Më parë ajo kishte punuar vetëm në punë me ndihmues.)

Ndonëse jo të gjithë të rinjtë në moshë madhore që do të dëshirojnë të shërbenin, mund të jenë në gjendje ta bëjnë këtë, është bërë një përpjekje e madhe për të mirëpritur çdo të ri në moshë madhore të denjë. Të rinjve dhe të rejave që do t’u pëlqente të shërbenin në këtë mënyrë, mund të flasin me peshkopin ose presidentin e degës së tyre, i cili mund të gjejë mundësi të përshtatshme për ta.

Lexoni më shumë te [news.lds.org](http://news.lds.org) duke kërkuar me fjalët “young church-service missionaries” [“misionarë të rinj me shërbim në kishë”]. ■



# Udhëheqëset e Të Rejave dhe të Shoqatës së Ndihmës Vizituan Zonën e Azisë

**Nga Brenda Frandsen, specialiste e medias për Zonën e Azisë**

Me ndihmën e Dejvid O. Hipsit, Pol Stivensit dhe Linda Re Pond Smithit

**P**ër nëntë ditë në nëntor të 2012-ës, Meri N. Kuk, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Të Rejave, dhe Linda S. Rivs, këshilltare e dytë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, i udhëzuan dhe i frymëzuan motrat e reja e ato në moshë përçark Zonës së Azisë.

Udhëtimi përkoi me njoftimin e programit të rishikuar mësimor për rininë, *Ejani, Më Ndiqni*, të cilin Të Rinjtë, Të Rejat dhe klasat e Shkollës të së Dielës për të rinjtë do të fillojnë ta përdorin në janar 2013. Programi i ri mësimor është hartuar për t'i ndihmuar mësuesit ta japin mësimin më shumë siç e dha Shpëtimtari dhe të zhvillojnë marrëdhënie më të forta me pjesëtarët e klasës.

Pas vizitës së Motrës Kuk dhe Motrës Rivs në Zonën e Azisë, shumë të rinj aziatikë dhe prindërit menduan se tani kanë më shumë shtysë për ta

**Në Tajvan, Meri N. Kuk dhe Linda S. Rivs, u takuan me autoritetet zonale dhe udhëheqësit e priftërisë si dhe anëtarët e Tajvanit.**

pastruar dhe ripërqendruar jetën e tyre dhe për t'u bërë shembull për komunitetet e tyre vendore.

Në Hong-Kong, Motra Rivs u premtoi të rinjve: "Nëse do të qëndroni të pastër në jetën tuaj, ju mund t'i dilni përpara çdokujt me besim në vetvete!"

E frymëzuar nga fjalët e saj, 12-vjeçarja Tang Kak Kei u shpreh pas takimit: "E di se duhet ta lexoj Librin e Mormonit çdo ditë. Mënyra si të pendohem dhe të jetoj drejtësisht është ajo që më ka mësuar të bëj broshura *Për Forcën e Rinisë*, që Drita e Krishtit dhe lumturia e vërtetë të mund të rrezatojnë përmes meje."

Në Indi, Motra Kuk u takua me anëtarët në shtëpinë e re të mbledhjes në Distriktin Çenai të Indisë dhe me anëtarët e Kunjit të ri të Hiderabadit në Indi dhe i paralajmëroi të rinjtë në moshë madhore që të përgatiteshin për të ardhmen. "Kualifikojeni veten nga ana arsimore", bëri thirrje ajo, "me aftësi që do t'ju ndihmojnë të ndërtoni mbretërinë. Përqendrohuni te familja juaj dhe tek ajo që mund të bëni për t'i bekuar pjesëtarët e familjes suaj, dhe te përgatitja juaj shpirtërore që të jeni të denjë për ato nxitje shpirtërore, dhe kështu do ta dini ku të shkoni e çfarë të bëni."

Në Indonezi, Motra Rivs mori pjesë në konferencën e parë të kunjit në Kunjin e ri Surakarta të Indonezisë. "Ne i ndiem shpirtat e tyre të përulur e të dashur. Çfarë anëtarësh besnikë!" tha ajo.

Motra Rivs më pas vizitoi Malajzinë, ku diskutoi me një grup motrash të Shoqatës së Ndihmës për problemet më të ngutshme të Shoqatës së Ndihmës si organizatë në Malajzi dhe për mënyrën se si Kisha mund të sigurojë udhëzim e frymëzim.

Në Tajvan, Motra Rivs foli rreth forcës dhe përkushtimit të anëtarëve vendorë. "Jemi kaq të lumtura që të dimë rreth jetës së tyre besnike dhe frekuentimit të vazhdueshëm të tempullit. . . . Anëtarët janë shembuj dashamirës për miqtë dhe fqinjët e tyre", tha ajo. ■



FOTOGRAFIA YANG CHEH-WEN





**Rinia përçark botës  
tregon se si po qëndron  
në vende të shenjta.**

### Kërkesë për Fotografi të Rinisë

Tema e Aktiviteteve të Përbashkëta për këtë vit është “Qëndroni në vende të shenjta dhe mos lëvizni” (DeB 87:8). Të rinj e të reja, *Liahona* po kërkon fotografi në të cilat ju po qëndroni në vende të shenjta. Fotografitë mund t’ju tregojnë ju duke kaluar kohë me familjen tuaj, duke shërbyer, duke bërë punë misionare, duke bërë vepra arti, duke studiuar ungjillin, duke bërë kërkime në natyrë dhe të tjera! Ja si ta dorëzoni fotografinë tuaj:

- Merrni dikë që t’ju bëjë një fotografi tuajën duke qëndruar në një vend të shenjtë.
- Dërgojeni fotografinë tuaj me rezolucion të lartë nëpërmjet postës elektronike në adresën [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org).
- Shtoni një mesazh rreth arsyes përse ky është një vend i shenjtë për ju.
- Në mesazhin tuaj elektronik, ju lutemi të përfshini emrin tuaj të plotë, datën e lindjes, emrin e lagjes apo të kunjtit (ose të degës apo të distriktit) dhe një adresë elektronike të prindërve tuaj.

Fotografitë e të rinjve nga e gjithë bota do të vendosen në numrin e ardhshëm.

### Apostulli Viziton Marokun

Në dhjetor të 2012-ës, pasi krijoi kunjin e 3.000-të të Kishës në Sierra-Leone të Afrikës

Perëndimore, Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, i bëri një vizitë të veçantë një dege të vogël e të largët të Kishës në Rabat të Marokut.

Te një takim shpirtëror i një mbrëmjeje të veçantë të diele, Plaku Holland shprehu dashurinë që udhëheqësit e Kishës kanë për çdo anëtar të Kishës anembanë botës, pavarësisht sa të paktë në numër apo të largët në vendndodhje mund të jenë ata.

“Juve nuk ju kanë harruar dhe ju jeni pjesë e një pune të mrekullueshme tekta Zoti e shquan dhe e nxit mbledhjen e Izraelit në këtë periudhë të fundit e të madhe ungjillore”, tha ai.

### Përkushtohet Tempulli i Tegusigalpës në Honduras

Të dielën, më 17 mars 2013, pas një kremtimi kulturor dhe një shtëpie të hapur trijavore, Tempulli i Tegusigalpës në Honduras u përkushtua në tri sesione, që u transmetuan në të gjitha njësitë e Kishës në Honduras dhe Nikaragua.

Anëtarët e Hondurasit, që zakonisht kanë udhëtuar me orë të tëra për në Tempullin e Guatemalës, në qytetin e Guatemalës, u gëzuan kur panë të përkushtohej tempulli i parë në vendin e tyre. Tempulli u njoftua së pari në shkresën zyrtare nga Presidenca e Parë më 9 qershor 2006 dhe punimet nisën në vendndodhjen e caktuar më 12 shtator 2009.

### Presidenti Monson Viziton Gjermaninë

Në fund të 2012-ës Presidenti Tomas S. Monson udhëtoi për në Gjermani për t’u takuar me anëtarët e Kishës në Hamburg, Berlin, Mynih dhe Frankfurt në Gjermani dhe për t’i këshilluar ata të ndjekin Jezu Krishtin.

“Ai dha mësim për faljen duke falur”, u tha ai anëtarëve në Frankfurt. “Ai dha mësim për mëshirën duke qenë i mëshirshëm. Ai dha mësim për përkushtimin duke dhënë Vetën.”

### Fryma e Shenjtë më Mëson

Që kur familja ime u bashkua me Kishën, unë e kam parë fuqinë që vjen nga leximi i *Liahonës*. Është nëpërmjet këtyre fjalëve të thella që unë u frymëzova për të shërbyer në një mision. Në revistë diskutohet për shumë tema, por ajo që ka rëndësi për mua është ajo që më mëson Fryma e Shenjtë sa herë që e lexoj. Me të vërtetë, ne do të jemi të lirë – madje edhe në “territor armik” (shih Bojd K. Paker, “Si të Mbijetosh në Territor Armik”, *Liahona*, tetor 2012, f. 34) – teksta i studiojmë, i lexojmë dhe i zbatojmë parimet e mësuara. Shpëtimtari jeton, priftëria është në tokë dhe Perëndia është në qiej.

**Njuton T. Senianxh, Uganda**

### Korrigjime

*Liahona* e tetorit 2012 e jep gabim autorësinë për fotografitë e historisë “Organizohet Kunji i Parë në Indi” në faqet 76–77. Fotografitë janë realizuar nga Motra Gladys Wigg. Kërkojmë ndjesë për gabimin.

Te *Liahona* e dhjetorit të 2012-ës familja Vixhil, e përmendur në artikullin “Sacred Transformations” [“Shndërrime të Shenjta”] në faqen 36, është pagëzuar në korrik 2010, jo në qershor 2011. Gjithashtu Andrea Vixhil ka lindur në korrik, jo në gusht 2012.

Te *Mësime të Presidentëve të Kishës: Lorenzo Snou*, figura në faqen dy ka emërtim të gabuar. Ajo është një pamje e djalit të Presidentit Snou, Oliver Godard Snou. Gjithashtu, në diçiturën e faqes 28, emri Brigam Jang i Riu duhet të ndërrojë vendin me emrin Fransis M. Liman.

## PIRJA NGA BURIMI

**Nga Aaron L. Uest**

Redaktor, Shërbimet Botuese të Kishës

**K**ur flasim rreth bukurisë së tempujve, ne përmendim veçanërisht majat, dritaret dhe afresket. Ne flasim me nderim për vaskat pagëzimore, dhomat e indaumentit, dhomat e vulosjes dhe dhomat çelestiale.

Por kur një profet ia përkushton një tempull Zotit, ai e përkushton të gjithë godinën, jo vetëm pjesët e bukura që u bien në sy të gjithëve. Në lutjen përkushtuese për Tempullin e Kansas-Sitit në Mizuri, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Ne përkushtojmë tokën mbi të cilën qëndron ky tempull. Përkushtojmë çdo pjesë të kësaj strukture të bukur, nga pikëmbështetjet e papara deri te figura e madhërishtme e Moronit, që kurorëzon pikën e tij më të lartë.”<sup>1</sup> Kur Presidenti Jozef Fielding Smith shqiptoi lutjen përkushtuese për Tempullin e Ogdenit në Jutë, ai përkushtoi “themelet, muret, dyshemetë, tavanet, kullën dhe të gjitha pjesët e ndërtetës” dhe u lut për mbrojtjen e të “gjitha pjesëve mekanike, përcjellësve dhe instalimeve të ndriçimit, sistemit të ventilimit dhe ashensorëve, dhe të gjitha gjërat që i përkasin kësaj godine”<sup>2</sup>.

Jam mirënjohës që Zoti i frymëzon profetët e Tij për të përkushtuar çdo pjesë të çdo tempulli. Edhe pse një menteshë dere apo një



*Jezu Krishti është burimi i ujit të gjallë.*

instalim drite, qartazi, ka një qëllim më të vogël se sa një altar në një dhomë vulosjeje, pjesë të tilla më të vogla luajnë rol në qëllimin përfundimtar të tempullit për të ekzaltuar.

Një nga këto pjesët më të vogla më ka ndihmuar të mësoj një mësim të qëndrueshëm. Një ditë isha në Tempullin e Solt-Lejkut, duke u përgatitur që të largohesha nga dhoma e veshjes, pasi kisha marrë pjesë në një ordinancë për të vdekurit. Kur pashë një çezmë për të pirë ujë, e kuptova se isha i etur, kështu që u përkula për të pirë pak ujë. Një lajm më erdhi në mendje:

*E pi këtë ujë në tempull, por a e pi me të vërtetë ujin e gjallë që është i disponueshëm këtu?*


Nuk ishte një mallkim goditës – thjesht një qortim i butë dhe një pyetje që përshkonte shpirtin.

Përgjigjja ime ndaj asaj pyetjeje ishte jo. Nuk po e pija plotësisht ujin e gjallë të tempullit. Duhej ta pranoja, mendja ime ishte endur për të tjera gjëra disa minuta më parë, ndërsa merrja ordinancat për të vdekurit. Edhe pse kisha bërë një punë të mirë për njerëzit që kishin nevojë për ndihmën time, nuk e kisha lejuar veten që të merrja të gjithë ndihmën që më nevojitej.

Tani, sa herë që shkoj në tempull, kërkoj për një çezmë uji dhe ndaloj për të pirë. E pyes veten se sa thellësisht po pi nga çezma e ujit të gjallë. Përgjigjja ime: Ende jo aq thellë sa të mjaftojë. Por etja ime po rritet. ■

### SHËNIME

1. Thomas S. Monson, në “Kansas City Missouri Temple: ‘Beacon of Divine Light’—an Offering of Hands and Hearts”, *Church News*, 12 maj 2012, ldschurchnews.com.
2. Joseph Fielding Smith, në “Ogden Temple Dedicatory Prayer”, *Ensign*, mars 1972, f. 12.



## DEKLARATA ZYRTARE

ILUSTRIM NGA ROBERT T. BARRETT

## UILLFORD UDRAF

**Uillford Udraf** shërbeu një mision në Britaninë e Madhe në vitet 1840. Për shkak të shërbimit të tij, më shumë se 1.000 vetë u **pagëzuan**. Uillford Udraf më vonë shërbeu si president i **Tempullit të Seint-Xhorxhit në Juta**. Si President i Kishës, ai e përkrahu bërjen e **Jutës** një shtet. Ai gjithashtu mori zbuluesën dhe nxori **Deklaratën Zyrtare 1**, që i udhëzoi shenjtorët ta ndalnin praktikimin e poligamisë.



**D**isa aktorë interpretojnë skena nga jeta e Jezu Krishtit për materiale filmike në internet që gjenden te [biblevideos.lds.org](http://biblevideos.lds.org); disa skena nga java e fundit e jetës së Shpëtimtarit paraqiten tek artikulli në faqen 26. Në artikullin “Misioni dhe Shërbesa e Jezu Krishtit” (faqe 18), Plaku Rasëll M. Nelson jep mësim pesë aspekte të shërbesës së Shpëtimtarit që ne mund t’i imitojmë në vetë jetën tonë.



ALBANIAN

KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME